



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada – Government

Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve
Ministarstvo za Finansije, Rada i Transfera
Ministry of Finance, Labour and Transfers

Korniza Afatmesme e Shpenzimeve 2023-2025

Prill 2022

Lista e shkurtesave

AAP	Arsim dhe Aftësim Profesional
AKKVP	Agjencia Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronave
AKP	Agjencia Kosovare e Privatizimit
AKP	Agjencia Kosovare e Pronave
APRK	Agjencia për Punësim e Republikës së Kosovës
ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
ATK	Administrata Tatimore e Kosovës
BAKT	Bruto të Ardhurat Kombëtare të Disponueshme
BB	Banka Botërore
BE	Bashkimi Evropian
BERZH	Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim
BPV	Bruto Produkti Vendor
BQK	Banka Qendrore e Kosovës
BRE	Burimet e Ripërtëritshme të Energjisë
ERA	Agjenda për Reforma Evropiane
EUROPOL	Agjencia e Bashkimit Evropian për Bashkëpunimin në Zbatimin e Ligjit
FAK	Forcat e Armatosura të Kosovës
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar
FSK	Forca e Sigurisë së Kosovës
IAL	Institucionet e Arsimit të Lartë
IÇK	Indeksi i Çmimeve të Konsumit
IFACCA	Federata Ndërkombëtare e Këshillave të Artit dhe Agjencive të Kulturës
IFN	Institucionet Financiare Ndërkombëtare
IHD	Investimet e Huaja Direkte
INTERPOL	Organizata Ndërkombëtare e Policisë
IPA	Instrumenti për Asistencë Para-Anëtarësimi
IPSHESH	Institucionet Jo Përfutuese në Shërbim të Ekon. Shtëpiake
KASH	Korniza Afatmesme e Shpenzimeve
KfW	Kreditanstalt für Wiederaufbau
KTD	Korporatat Tjera Depozituese
LFPL	Ligji për Financat e Pushtetit Lokal
LMFPP	Ligji për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë
MASHT	Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë
MFPT	Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve
MFSK	Ministria e Forcës së Sigurisë së Kosovës
MPMS	Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
MSA	Marrëveshja e Stabilizim Asociimit
MSH	Ministria e Shëndetësisë
NATO	Organizata e Traktatit të Atlantikut Verior
NP	Ndërmarrjet Publike

NVM	Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme
PKRE	Programi Kombëtar për Reforma në Ekonomi
PKZMSA	Programi Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit
PRE	Programi i Reformave Ekonomike
RSSS	Rishikimi Strategjik i Sektorit të Sigurisë
RTK	Radio Televizioni i Kosovës
SISH	Sistemi Informativ Shëndetësor
SKZH	Strategjia Kombëtare Zhvillimore
SMIA	Sistemi i Menaxhimit të Informatave në Arsim
SMIL	Sistemi Informativ për Menaxhimin e Lëndëve
SHSKUK	Shërbimi Spitalor, Klinik Universitar i Kosovës
TI	Teknologjia Informative
TIK	Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit
TVSH	Tatimi mbi Vlerën e Shtuar
UNESCO	Organizata e Kombeve të Bashkuara për Arsim, Shkencë dhe Kulturë
USAID	United States Agency for International Development
WEO	World Economic Outlook

PËRMBAJTJA

Hyrje	5
PJESA E PARË	6
1. DEKLARATA E PRIORITETEVE AFATMESME TË QEVERISË 2023-2025	6
PJESA E DYTË	15
2. KORNIZA MAKRO-FISKALE	15
2.1. KORNIZA MAKROEKONOMIKE	15
2.1.1. Ambienti i Jashtëm Ekonomik	15
2.1.2. Zhvillimet e Fundit Ekonomike në Kosovë	17
2.1.3. Perspektiva Makroekonomike në vitin 2022 dhe periudhën afatmesme	22
2.2 KORNIZA FISKALE 2023-2025	24
2.2.1. Të Hyrat dhe Shpenzimet Qeveritare	24
2.2.2. Deficiti Buxhetor dhe Rregulla Fiskale.....	29
2.2.3. Niveli i borxhit shtetëror, zhvillimet dhe perspektive për vitet në vijim.....	29
2.3. RREZIQET AFATMESME 2023-2025	32
ANEKS 1	40
ANEKS 2	52
PJESA E TRETË	
3. KORNIZA E SHPENZIMEVE SEKTORIALE 2023-2025 – QEVERIA QENDRORE	58
PJESA E KATËRT	
4. NIVELI KOMUNAL	78
Lista e Grafikëve	
Grafiku 1: Rritja ekonomike sipas grupeve të vendeve të ndryshme.....	16
Grafiku 2: Bilanci i llogarisë rrjedhëse	17
Grafiku 3: Tregu i punës	18
Grafiku 4: Kreditë, depozitat dhe kreditë jo-performuese.....	19
Grafiku 5: BPV-ja sipas komponentëve.....	24
Grafiku 6: Struktura e të hyrave në të hyrat e të përgjithshme	26
Grafiku 7: Struktura e shpenzimeve buxhetore.....	28
Grafiku 8: Trendi i Borxhit të Përgjithshëm dhe si përqindje e BPV-së.....	31
Grafiku 9: Detyrimet e ndërmarrjeve publike si përqindje e BPV-së (2020) (Eurostat, 2021)	35
Grafiku 10: Pjesëmarrja e detyrimeve totale sipas NP-ve (përqindja e BPV-së).....	37
Lista e Tabelave	
Tabela 1: Parashikimi i ndryshmeve të çmimeve në tregjet ndërkombëtare.....	16
Tabela 2: Disa Indikatorë Ekonomikë	22
Tabela 3: Borxhi i Përgjithshëm	30
Tabela 4: Borxhi ndërkombëtar përfshirë borxhin e zotuar e të padisbursuar sipas 31.03.2022	31
Tabela 5: Pasqyrat financiare të përmbledhura për sektorin e NP-ve (miliona euro).....	36
Tabela 6: Detyrimet e papaguara	38
Tabela 7: PAGESAT bazuar në vendimet gjyqësore (milion Euro).....	39

Hyrje

Korniza Afatmesme e Shpenzimeve 2023-2025 paraqet dokumentin kryesor mbi bazën e të cilit do të hartohet Buxheti Vjetor për vitin 2023. Qëllimi kryesor i KASH-it është që të ofrojë një analizë të bazuar të mjedisit makroekonomik në vend, për të vendosur kështu bazën për planifikimet buxhetore për vitet që vijnë në përputhje me prioritetet strategjike të Qeverisë.

Qeveria vazhdon të ketë si objektiv kryesor forcimin e mëtutjeshëm të pozitës së saj fiskale dhe menaxhimin e përgjegjshëm të financave publike. Në këtë kontekst, planifikimi dhe ekzekutimi i buxhetit do të bëhet në linjë me rregullën fiskale të vendit në lidhje me deficitin buxhetor dhe bilancin bankar. Duke pasur parasysh se këto rregulla paraqesin kufizime kur konsiderojmë nevojat e Kosovës për projekte të mëdha zhvillimore, implementimi i ‘Klauzolës për Investime’ i mundëson Qeverisë të financojë projekte kapitale me interes të gjerë publik, mbi limitin e deficitit të lejuar, me kusht që këto projekte financohen nga Institucionet Financiare Ndërkombëtare dhe Agjencitë Zhvillimore.

Prioritetet e reformave ekonomike për periudhën afatmesme burojnë nga Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Programi për Reforma në Ekonomi 2023- 2025, i cili rrjedh nga procesi i dialogut për qeverisje ekonomike ndërmjet Kosovës dhe BE-së. Në të njëjtën kohë, situata e krijuar nga pandemia COVID-19, ka shtyrë që prioritetet e qeverisë të drejtohen drejt tejkalimit të krizës dhe rimëkëmbjes ekonomike.

KASH 2023-2025 përmbledh këto prioritetet kyçe të qeverisë në Deklaratën e Prioriteteve Afatmesme dhe pastaj në kapitujt përkatës, që mbulojnë të gjithë sektorët buxhetorë, duke përshkruar qasjen se si do të sigurohen fondet për zbatimin e tyre nga buxheti i Kosovës dhe asistencat financiare ose huatë nga partnerët zhvillimorë.

KASH 2023-2025 është e strukturuar në katër pjesë kryesore. Pjesa e parë përmban “Deklaratën Afatmesme të Prioriteteve”, e cila ofron një përmbledhje të gjerë të prioriteteve të Qeverisë në përputhje me Programin e Qeverisë, Strategjinë e Ardhshme Kombëtare për Zhvillim 2030, Programin e Reformave në Ekonomi 2022- 2024, Planin Kombëtar për Zbatimin e MSA-së dhe strategjitë sektoriale. Në pjesën e dytë është korniza makro-fiskale bazuar në parametrat e përgjithshëm të zhvillimit ekonomik. Në pjesën e tretë dhe të katërt janë paraqitur parashikimet fiskale të cilat përcaktojnë kufijtë e përgjithshëm të shpenzimeve, mbi bazën e të cilave përgatitet më vonë Buxheti Qendror dhe ai Komunal.

PJESA E PARË

1. DEKLARATA E PRIORITETEVE AFATMESME TË QEVERISË 2023-2025

Objektivat e përgjithshme dhe korniza fiskale

Korniza Afatmesme e Shpenzimeve 2023-2025 paraqet dokumentin kryesor mbi bazën e të cilit do të hartohet buxheti vjetor për vitin vijues 2023. Qëllimi kryesor i përcaktimit të prioriteteve është që të bëhet ndërlidhja, duke u bazuar në analizën gjithëpërfshirëse të mjedisit makroekonomik në vend dhe planifikimeve buxhetore për vitet vijuese, për një perspektivë trevjeçare në përputhje me objektivat strategjike të Qeverisë.

Qeveria e Kosovës ndërmoi një sërë masash për t'iu ardhur në ndihmë bizneseve dhe grupeve të cenueshme të shoqërisë, që u prekën më së shumti nga pandemia Covid-19. Këto masa rezultuan si përgjigje adekuate ndaj krizës së shkaktuar nga pandemia, efektet pozitive të të cilave u reflektuan në treguesit makroekonomikë. Duke marrë parasysh strukturën aktuale ekonomike të Kosovës dhe pengesat e shumta ndaj rritjes ekonomike, është i domosdoshëm orientimi i reformave strukturore të cilat kanë për qëllim vazhdimin e rimëkëmbjes ekonomike. Rrjedhimisht, Prioritetet e Qeverisë për periudhën e ardhshme trevjeçare do të fokusohen në ri-orientimin e ekonomisë drejt prodhimit dhe eksportit, rritjes së punësimit të dinjitetshëm për të gjithë dhe një zhvillimi të qëndrueshëm, që mbron ambientin duke e ruajtur atë edhe për gjeneratat e ardhshme, si dhe orientimi drejt transformimit digjital.

Në terma afatgjatë reformat janë të nevojshme në sektorin e ekonomisë, drejtësisë, shëndetësisë dhe arsimit në përgjithësi. Objektivat strategjike të Qeverisë janë përcaktuar nëpërmjet Programit të Qeverisë, Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe strategjive sektoriale, si dhe dokumenteve që rrjedhin nga procesi i integritimit evropian, siç është Programi për Reforma në Ekonomi dhe Programi Kombëtar për Zbatimin e MSA-së.

Korniza Afatmesme e Shpenzimeve 2023-2025 përmbledh këto prioritete kyçe të Qeverisë së Kosovës në Deklaratën e Prioriteteve Afatmesme dhe pastaj në kapitujt përkatës, që mbulojnë të gjithë sektorët buxhetorë, duke përshkruar qasjen se si do të sigurohen fondet për zbatimin e tyre nga buxheti i Kosovës, asistencat financiare apo huat nga partnerët zhvillimorë.

Dy kapitujt e parë të Deklaratës së Prioriteteve Afatmesme paraqesin kornizën e përgjithshme fiskale për tri vitet e ardhshme dhe parimet themelore mbi të cilat bazohet ajo. Kapitulli i tretë paraqet një përmbledhje të prioriteteve të Qeverisë bazuar në dokumentet kryesore planifikuese, i paraqitur sipas strukturës së sektorëve të definuar në Strategjinë Kombëtare për Zhvillim¹.

¹ Strategjia Kombëtare për Zhvillim 2016-2021 ka skaduar në fund të vitit 2021, ndërkohë Qeveria e Kosovës është në proces të hartimit të Strategjisë së ardhshme që mbulon periudhën deri në vitin 2030. Drafti i objektivave dhe treguesve është duke u shqyrtuar me institucionet përgjegjëse dhe hisedarët tjerë.

Prioritetet kryesore do të udhëzojnë të gjitha organizatat buxhetore në përgatitjen e propozimeve të tyre buxhetore për vitin 2023. Sipas këtyre prioritetëve, organizatat buxhetore mund të përfshijnë propozime për finalizimin ose racionalizimin e programeve ekzistuese në mënyrë që të sigurohen fondet për ato programe që paraqesin prioritet të lartë.

1.1. Korniza e përgjithshme fiskale për prioritizim

Programi i Qeverisë 2021-2025, Strategjia Kombëtare për Zhvillim 2030, Programi për Reforma në Ekonomi 2022-2024, si dhe Programi Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit, janë dokumentet kryesore që përcaktojnë orientimin dhe zhvillimin e politikave qeveritare dhe sigurojnë bazën për përcaktimin e prioritetëve të politikave të përfshira në Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve 2023-2025.

Zbatimi i prioritetëve të këtyre dokumenteve do të përbëjë pjesën më të madhe të kornizës buxhetore që qeveria do të ndërmarrë me qëllim të ndërtimit të sistemit të qëndrueshëm të financave publike në përputhje me standardet më të larta ndërkombëtare, të cilat sigurojnë rritje dhe zhvillim ekonomik dhe mirëqenie më të mirë për të gjithë qytetarët. Kjo do të arrihet nëpërmjet ri-dizajnit të politikave fiskale, menaxhimit të financave publike dhe sistemit financiar që sigurojnë llogaridhënie.

Për të arritur këto, Qeveria do të fokusohet në krijimin e një mjedisi sa më të favorshëm biznesor dhe fiskal, përmirësimin e politikave tregtare dhe energjetike, integrimin në ekonominë globale, vazhdimin e projekteve ekzistuese për modernizimin e infrastrukturës, dhe përkrahjen e vazhdueshme të bujqësisë dhe zhvillimit rural. Sistemi i përshtatshëm tatimor dhe mjedisi i favorshëm biznesor janë shtyllat më të rëndësishme për zhvillimin e qëndrueshëm të sektorit privat në vend. Prandaj, ri-dizajnimi i politikave aktuale fiskale dhe zbatimi i politikave të reja, rishikimi i formatit të tatimit për bizneset e vogla dhe të mesme, ndryshimi i formës së deklarimit të tatimit në të ardhura personale dhe vendosja e obligimit për deklarimin vjetor të tatimit në të ardhura personale do të bëhen në kuadër të sigurimit të rritjes së qëndrueshme ekonomike.

Me qëllim të formalizimit të ekonomisë, do të fuqizohen kapacitetet e inspektorëve tatimorë, aftësitë hetimore dhe të inteligjencës financiare, si dhe do të sigurohet koordinim më i mirë ndërmjet institucioneve përgjegjëse për parandalimin dhe ndalimin e punës së padeklaruar që do të mundësojnë rritjen e të ardhurave tatimore dhe formalizmin e punësimit.

1.2. Parimet themelore

Realizimi i prioritetëve qeveritare do të çojë drejt zbatimit të politikave të përcaktuara sektoriale, të cilat duhet të respektojnë kufijtë e shpenzimeve.

Procesi i përgatitjes së parashikimit të shpenzimeve (kufijve buxhetorë) për periudhën 2023-2025, është parakusht për rritje të qëndrueshme ekonomike, përmirësim të mjedisit brenda të cilit zhvillohen aktivitetet e shtuara të sektorit privat, nxitje të punësimit të qëndrueshëm si dhe mirëqenie më të mirë për të gjithë qytetarët. E gjithë kjo do të udhëhiqet nga parimet e mëposhtme:

- Përputhje me politikat prioritare të Qeverisë, Strategjinë Kombëtare për Zhvillim (SKZH), Programin e Reformave Ekonomike (PRE) 2022-2024, Programin Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit si dhe Programin e Qeverisë 2021-2025.
- Alokimin e shpenzimeve të cilat janë më efektive në realizimin e objektivave të politikave të Qeverisë;
- Rritje të cilësisë dhe besueshmërisë në procesin buxhetor si dhe ndërlidhje më të mirë ndërmjet politikave dhe buxhetit.
- Ekzekutim më të lartë të shpenzimeve në krahasim me planifikimin e tyre, me theks të veçantë në shpenzimet kapitale, duke realizuar synimet specifike prioritare.
- Ndërlidhjen me financimin e jashtëm të ofruar nëpërmjet IPA dhe kanaleve të tjera.

1.3. Fushat prioritare

Prioritetet e mëposhtme për Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve 2023-2025 janë paraqitur në mënyrë specifike dhe rrjedhin nga drafti i Strategjisë Kombëtare për Zhvillim 2030 dhe janë ndërlidhur me masat e paraqitura në Programin për Reforma në Ekonomi 2022-24, si dhe Programin për Zbatimin e MSA-së. E strukturuar sipas shtyllave të SKZH 2030, kjo pjesë mbulon 16 sektorët e politikave publike, të cilat janë prioritzuar për periudhën e ardhshme buxhetore. Gjithashtu, këto priorite janë bazuar në dokumente të tjera strategjike sektoriale, duke iu mundësuar organizatave buxhetore një masë të fleksibilitetit për të përcaktuar strukturën më të përshtatshme dhe nivelet më adekuate të financimit për të arritur këto qëllime.

Gjatë përgatitjes dhe dorëzimit të kërkesave të tyre buxhetore për vitin 2023 me parashikimet për periudhën afatmesme (2023-2025), nga organizatat buxhetore pritet të tregojnë se si plani i tyre buxhetor i përgjigjet prioritetëve të Qeverisë të paraqitura më poshtë. Kundrejt prioritetëve të dhëna, organizatat buxhetore inkurajohen që të përmirësojnë efikasitetin në shpenzime përmes rialokimit brenda kufijve ekzistues.

1.3.1 Zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik

Për këtë periudhë afatmesme, për të mundësuar një zhvillim të qëndrueshëm ekonomik Qeveria do të fokusohet për një ekonomi digjitale, qarkore dhe ndërkombëtarisht konkurruese, infrastrukturë të cilësisë së lartë, të qëndrueshme dhe të integruar, si dhe ambient i pastër dhe shfrytëzim më i mirë i burimeve natyrore.

Sektorët buxhetorë: mbështetje për bizneset dhe industrinë; arsimi dhe shkenca; financat publike; politika e jashtme; transporti dhe komunikimi; tnergjia; mjedisi dhe planifikimi hapësinor; bujqësia.

Çështjet horizontale: agjenda digjitale, diaspora, mjedisi- agjenda e gjelbër

Ekonomi inovative, qarkore dhe konkurruese ndërkombëtarisht

Synohet krijimi i një mjedisi të përshtatshëm për biznese, që në thelb ka shtrirje horizontale ku shteti përmes mekanizmave në dispozicion të ketë një rol më aktiv në formësimin e një ekonomie konkurruese drejt aktiviteteve prodhuese dhe shërbyese me vlerë të shtuar. Inovacioni si përcaktues i rëndësishëm i konkurrencës dhe rritjes ekonomike dhe ekonomia qarkore si model për zhvillim të

qëndrueshëm, do të kenë vëmendje të veçantë në trajektoren e re ekonomike. Kjo do të mundësohet duke përkrahur inovacionin dhe digjitalizimin e NVM-ve, duke rritur dhe diversifikuar bazën industriale dhe modernizimin e industrisë minerare, duke përmirësuar produktivitetin, diversitetin dhe qëndrueshmërinë në bujqësi dhe duke forcuar lidhjet (në mënyrë formale) ndërmjet fermerëve, përpunuesve dhe tregtarëve. Paralelisht me këto synime do të synohet edhe ngritja e shkathësive dhe kompetencave të fuqisë punëtore duke përmirësuar produktivitetin e tyre.

Investimet e huaja direkte gjithashtu do të jenë një synim parësor duke rritur investimet të orientuara drejt eksportit dhe duke forcuar dhe zgjeruar promovimin e eksportit, pasi që kërkesa e përgjithshme është e kufizuar për shkak të tregut të vogël të brendshëm dhe zgjerimi drejt tregjeve të eksporteve do të çojë drejt një zhvillimi të qëndrueshëm ekonomik. Krahas inovacionit dhe digjitalizimit, ne synojmë të zbatojmë edhe specializimin e mençur.

Infrastrukturë e qëndrueshme, e integruar dhe me cilësi të lartë

Ngritja dhe përmirësimi i infrastrukturës ekonomike është qëllim parësor strategjik për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik. Me theks të veçantë, Qeveria përgjatë periudhës së ardhshme të financimit do të fokusohet në përmirësimin e furnizimit të qëndrueshëm dhe të përbalueshëm me energji, mundësimin e investimeve në burimet e ripërtërishme të energjisë dhe masat për eficiency të energjisë. Infrastruktura rrugore dhe hekurudhore do të përmirësohet për të mundësuar lidhje më të mira në rajonet e Kosovës dhe për industrinë, si dhe integrimin e tyre në sistemin ndërkombëtar të transportit multi-modal. Gjithashtu, synohet të përmirësohet cilësia, përbalueshmëria e shërbimeve dhe siguria në transport duke zvogëluar aksidentet me fatalitet dhe vendosjen e një sistemi inteligjent në transport.

Investimet në infrastrukturën e TIK përbëjnë një parakusht të rëndësishëm për transformimin dixhital të vendit duke zhvilluar rrjetet dhe shërbimet e komunikimit elektronik brezgjërë me cilësi të lartë dhe integrimin ndërkombëtar të tyre. Gjithashtu, Qeveria do të adresojë politikat dhe kanalizimin e investimeve të ardhshme për sektorin e ujërave, me theks të veçantë në ndërtimin e akumuluesve të ujit, zgjerimin dhe përmirësimin e sistemeve të ujitjes dhe rritjen e eficiency së përdorim të ujit.

Infrastruktura në përgjithësi do të jetë e cilësisë së lartë, e qëndrueshme, e përshtatshme për ndryshime dhe e integruar që të përmirësojë bashkëpunimin, si në rrafshin e brendshëm ashtu edhe atë ndërkombëtar.

Ambient i pastër dhe shfrytëzim më i mirë i burimeve natyrore

Krijimi dhe mirëmbajtja e një ambienti të pastër, që në thelb ka parandalimin e ndotjes së tokës, ujit dhe ajrit, si dhe përgjithësisht mbrojtjen e biosferës, për një jetë më cilësore tash dhe në të ardhmen, do të jetë synim dhe, në të njëjtën kohë, parim që do të shoqërojë zhvillimin e vendit, përfshi këtu edhe planifikimin dhe zhvillimin e përgjegjshëm territorial. Kjo do të arrihet duke promovuar ekonominë qarkore që ka për qëllim rritjen e pjesëmarrjes së riciklimit dhe menaxhimit të mbeturinave, transportit miqësor ndaj ambientit që do të zvogëlojë emetimin e gazrave serë dhe menaxhimin e qëndrueshëm për shfrytëzim më të mirë të pyjeve dhe mbrojtjes së biodiversitetit.

Gjithashtu, potenciali i burimeve natyrore, sidomos atyre minerare, do të mbështetet përmes mekanizmave të ndryshëm me qëllim të shfrytëzimit më efektiv dhe njëkohësisht të qëndrueshëm të këtij potenciali.

3.1.2 Zhvillimi i barabartë njerëzor

Qeveria synon për këtë periudhë afatmesme të rris nivelin e zhvillimit njerëzor duke ofruar cilësi dhe qasje në arsim, mundësi më të mira për punësim nëpërmjet një tregu më gjithëpërfshirës, mirëqenie më të mirë dhe shërbime shëndetësore cilësore, shoqëri aktive dhe kreative, si dhe promovim dhe zhvillim më të madh të kulturës.

Sektorët buxhetorë: arsimi dhe shkenca; tregu i punës dhe punësimi; mbrojtja sociale; shëndetësia; kultura dhe rekreacioni
Çështjet horizontale: të drejtat e njeriut dhe mundësitë e barabarta; agjenda digjitale, diaspora dhe migrimit; mjedisi- agjenda e gjelbër.

Arsim cilësor dhe të qasshëm

Kjo do të arrihet duke: rritur pjesëmarrjen e fëmijëve në arsim dhe kujdes në fëmijërinë e hershme; përmirësuar qasjen në shërbimet arsimore, veçanërisht për fëmijët nga familjet me të ardhura të ulëta, pakicat kombëtare dhe nga zonat rurale; rritur investimet në kërkim dhe zhvillim shkencor; cilësi, integritet dhe konkurrueshmëri më e madhe në arsimin e lartë; dixhitalizim të shërbimeve arsimore për cilësi dhe qasje më të mirë.

Përmbushja e këtyre prioriteteve do të do kontribuojë në përmirësimin e renditjes së Kosovës në testin PISA, si dhe në Indeksin e Arsimit në kuadër të Indeksit të Zhvillimit Njerëzor (HDI), zvogëlim të shkallës së NEET të rinjtë dhe përmirësimin e pozitës së Kosovës në skenën ndërkombëtare të arsimit.

Treg të punës gjithëpërfshirës, punësim më të lartë dhe më të mirë

Synohet nëpërmjet: rritjes së punësimin dhe zhvillimit të shkathtësive me theks të veçantë të rinjtë, gratë dhe grupet e tjera të cenueshme, si dhe nxitjes së punësimin të qëndrueshëm. Për të përmirësuar edhe më tutje tregun e punës, ne mëtojmë të ulim informalitetin e punës dhe përmirësimin e kushteve të punës, duke siguruar mbrojtje dhe promovim të të drejtave të punëtorëve si dhe zgjerimin e shërbimeve të punësimin dhe trajnimeve profesionale për të krijuar një fuqi punëtore të kualifikuar.

Këto do të ndikojnë që të kemi shkallë më të lartë të punësimin, zvogëlim të hendekut të shkathtësive, me theks të veçantë në hendekun gjinor të pjesëmarrjes në fuqinë punëtore, dhe rritje të punësimin në sektorët me produktivitet të lartë.

Shëndeti dhe mirëqenia e përmirësuar

Këto mëtohen të arrihen nëpërmjet ndryshimeve strukturore duke përmirësuar shërbimet shëndetësore në të gjitha nivelet, si dhe funksionalizimin e sistemit të integruar të informimit shëndetësor dhe skemës së sigurimit publik shëndetësor, krahas parandalimit, menaxhimit dhe kontrollimit të pandemisë COVID-19. Në anën tjetër, me fokus tek profesionistët në sektorin e

shëndetësisë, synojmë të ndalim ikjen e trurit në sektorin e shëndetësisë. Gjithashtu, për të siguruar mirëqenie më të mirë, synimi ynë është edhe rregullimi më i mirë i skemave të mbrojtjes sociale si dhe ofrimi i shërbimeve sociale cilësore, sigurimi i strehimit të denjë dhe të përballueshëm dhe cilësi më e mirë e ajrit dhe ushqimit.

Këto do të ndikojnë që të kemi cilësi më të mirë të jetës duke rritur jetëgjatësinë dhe ulur nivelin e varfërisë, si dhe strehim të denjë dhe të përballueshëm.

Shoqëri aktive, kreative dhe kulturë e promovuar

Si sektorë të cilët kanë shërbyer si ambasadorë të Kosovës në skenën ndërkombëtare, do të mbështeten në mënyrë substanciale duke synuar të krijohet një shoqëri aktive dhe krijuese, si dhe kulturë e promovuar. Zhvillimi i kulturës dhe sportit ndihmon edhe zhvillimin socio-ekonomik e kulturor të vendit. Kjo do të arrihet duke mbrojtur dhe promovuar trashëgiminë kulturore, fuqizuar institucionet dhe komunitetin kulturor, duke u siguruar që të ketë menaxhim adekuat të infrastrukturës fizike në sport dhe kulturë, rritje dhe fuqizim të kapitalit njerëzor në sport, si dhe turizëm i qëndrueshëm kulturor dhe sportiv, përfshirje të rinjve në vendimmarrje publike si dhe edukimit artistik të tyre dhe zhvillim të kuadrove profesionale.

Përmbushja e këtyre prioriteteve do të rris kontributin e ekonomisë kreative dhe sportit në PBB, do të ndikojë që të kemi kulturë më të promovuar dhe mbrojtjen e trashëgimisë kulturore si dhe fuqizimin e rinisë në veprimtari kulturore.

3.1.3 Siguria dhe sundimi i ligjit

Prioritetet e qeverisë në fushën e sigurisë dhe sundimit të ligjit do të fokusohen në drejtim të rritjes së gatishmërisë për paqe dhe siguri, zbatimit efektiv të ligjit dhe drejtësisë efektive.

Sektorët buxhetorë: siguria dhe mbrojtja; siguria publike; drejtësia.

Çështjet horizontale: të drejtat e njeriut dhe mundësitë e barabarta; agjenda digjitale, diaspora dhe migrimi,

Gatishmëri e lartë për paqe dhe siguri

Ky prioritet adreson nevojat e mbrojtjes dhe sigurisë së vendit. Ai përfshinë fuqizimin e kapaciteteve kombëtare për mbrojtje në linjë me kërkesat e anëtarësimit në NATO. Gjithashtu, ky prioritet adreson edhe nevojën e kundërshtimit të kërcënimeve hibride si dhe fuqizimin e bashkëpunimit me partnerët Euro-Atlantikë. Për më tepër në kuadër të këtij prioriteti përfshihet edhe ngritja e kapaciteteve për menaxhim të emergjencave civile.

Përmbushja e këtij prioriteti do të rris ndikimin në shtimin e sigurisë vendore dhe kërkon rritjen e buxhetit për mbrojtje si % e PBB-së.

Zbatim efektiv i ligjit

Ky prioritet adreson nevojat e sundimit të ligjit, duke u fokusuar në sigurinë publike. Ai ngërthen forcimin e luftimit të krimin të organizuar, korrupsionit dhe terrorizmit. Përveç kësaj, adreson edhe nevojat që dalin në fushën e sigurisë në komunitet, si dhe ato çështje që ndërlidhen me migrimin e parregullt.

Përmbushja e këtij prioriteti ndikon në fuqizimin e sundimit të ligjit dhe vlerësim më të mirë për Kapitullin 24 nga Komisioni Evropian.

Drejtësi efektive

Ky prioritet adreson nevojat e sundimit të ligjit, duke u fokusuar në sistemin e drejtësisë. Ai mëton të adresojë nevojat e ofrimit të drejtësisë me kohë, sikurse edhe përmes përmirësimit të profesionalizmit, pavarësisë dhe llogaridhënies së pjesëtarëve të sistemit të drejtësisë. Për më tepër, ky prioritet përfshinë edhe çështjet e përmirësimit të qasjes në drejtësi, duke përfshirë edhe grupet e cenueshme.

Realizimi i këtij prioriteti do të ndikojë për një vlerësim më të mirë nga Komisioni Evropian për Kapitullin 23 dhe gjithashtu një vlerësim më të lartë në sektorin e sundimit të ligjit nga indekset ndërkombëtare.

3.1.4 Qeverisja e mirë

Qeveria synon të fuqizojë parimet e qeverisjes së mirë, duke zbatuar prioritetet për ngritje të efektivitetit dhe llogaridhënies së qeverisë, financave publike të qëndrueshme dhe fuqizimin e subjektivitetit ndërkombëtar.

Sektorët buxhetor: Qeveria dhe administrata publike; financat publike dhe politika e jashtme.
Çështjet horizontale: agjenda digjitale; diaspora dhe migrimit; të drejtat e njeriut dhe mundësitë e barabarta

Qeveri efektive dhe llogaridhënëse

Kjo nënkupton qeveri të aftë në planifikim të politikave të bazuar në rezultate dhe zbatim i mirëfilltë i politikave në teren, cilësi dhe profesionalizim i shërbimit civil që shoqërohet me ofrim cilësor të shërbimeve për qytetarët dhe bizneset, duke qenë të njëjtën kohë llogaridhënëse si në mes të niveleve të administratës ashtu edhe ndaj qytetarit. Në këtë qëllim strategjik përfshihet edhe rritja e performancës dhe menaxhimit financiar të ndërmarrjeve publike (të nivelit qendror) duke qenë po ashtu llogaridhënëse ndaj Qeverisë. Në fund, rritja e performancës së komunave është e përfshirë përmes matjes së performancës së tyre kundrejt qeverisjes demokratike dhe ofrimit të shërbimeve për qytetarët përmes sistemit të menaxhimit të performancës komunale i ndërtuar në MPL.

Përmbushja e këtij prioriteti ndikon në rritjen e efikasitetit të qeverisë dhe rritjen e besimit në qeveri.

Financa publike të qëndrueshme

Me këtë prioritet synohet qëndrueshmëri në planifikim, shpenzim dhe kontroll të financave publike. Së pari, synohet të arrihet një planifikim i qëndrueshëm afatgjatë buxhetor përmes KASH-it, pastaj lidhje të qëndrueshme ndërmjet politikave dhe buxhetit në mënyrë që të eliminohen rastet kur politika të mira miratohen, por si pasojë e mos adresimit të tyre më buxhet, mbesin pa u zbatuar. Po ashtu, qëllim tjetër është fuqizimi i menaxhimit të prokurimit publik duke ulur në masë të madhe kontratat me negociim të cilat eliminojnë konkurrueshmërinë. Në fund, synohet të ketë rritje të efikasitetit në auditim të brendshëm dhe të jashtëm për të siguruar kontroll adekuat të shpenzimit të parasë publike.

Të gjitha këto do të ndikojnë në uljen e borxhit publik si përqindje të PBB-së, uljen e deficitit buxhetor si përqindje të PBB-së, në përqindjen e shpenzimeve të investimeve kapitale në krahasim me planifikimin e tyre, përqindjen e buxhetit të shpenzuar për vit dhe një vlerësim më të lartë për mesataren e fushës nga raporti i monitorimit të SIGMA.

Subjektivitet i konsoliduar ndërkombëtar

Ky prioritet nënkupton konsolidimin e subjektivitetit të Kosovës në rrafshin ndërkombëtar. Me këtë synohet bashkëpunimi rajonal dhe ndërtimi i marrëdhënieve të mira fqinjësore, po ashtu krijimi dhe forcimi i marrëdhënieve me shtetet që nuk e kanë njohur shtetin e Kosovës deri tani. Po ashtu, synohet të ketë rritje të profesionalizimit dhe llogaridhënies në shërbimin diplomatik duke përfshirë angazhimin e diasporës në promovimin dhe zhvillimin e Kosovës. Ndër të tjera, ky prioritet do të arrihet nëpërmjet intervenimeve dhe arritjeve në sektorët e tjerë, konkretisht në sektorët e zhvillimit ekonomik, nëpërmjet krijimit të besueshmërisë ekonomike, besueshmërisë më të madhe në sistemin e drejtësisë vendore, forcimit ushtarak në funksion të paqes dhe sigurisë, si dhe jo më pak e rëndësishme, nëpërmjet përmirësimit të edukimit dhe mbrojtjes dhe promovimit të kulturës në funksion të forcimit të identitetit kulturor dhe rrjedhimisht shtetëror.

Përmbushja e këtyre prioritetëve do të rezultojë me rritje të numrit njohjeve të reja për Kosovën, numrit të organizatave ndërkombëtare që Kosova është pjesë e tyre, numrit të vendeve ku qytetarët e Kosovës mund të udhëtojnë pa viza, shërbim të jashtëm profesional, rritje të pjesëmarrjes së pjesëtarëve të diasporës në diplomaci dhe zhvillim ekonomik.

3.1.5 Prioritetet horizontale

Si parim, prioritetet horizontale janë paraqitura në këtë Deklaratë dhe të cilat burojnë nga Strategjia Kombëtare për Zhvillim 2030, që do të zbatohen dhe financohen nga organizata të ndryshme buxhetore në disa sektorë. Prandaj, këto prioritete duhet të planifikohen dhe përfshihen në kërkesat buxhetore nga organizatat buxhetore përgjegjëse për zbatimin e atyre veprimeve. Secila agjendë horizontale e përcaktuar në Strategjinë Kombëtare për Zhvillim do të koordinohet nga institucioni/et përgjegjës, por veprimet konkrete do të zbatohen nga organizata të ndryshme buxhetore.

Duke u bazuar në këtë, të ndërlidhura me prioritetet sektoriale të paraqitura më lartë, gjatë periudhës 2023-25, prioritetet horizontale të cilat Qeveria e Kosovës synon të arrijë përfshijnë si në vijim:

Agjenda e Integritimit Evropian: zbatimi i obligimeve të Kosovës që dalin nga Marrëveshja për Stabilizim Asocim dhe dialogu i nivelit të lartë të shprehur përmes Agjendës për Reforma Evropiane, mbetet prioritet me rëndësi të lartë për Qeverinë e Kosovës. Përmbushja e detyrimeve të MSA-së kërkon zbatimin e një numri të madh reformash të thella juridike, politike, ekonomike dhe institucionale. Prandaj, kërkesat për financim nga organizatat buxhetore duhet të kenë parasysh prioritetet në kuadër të MSA-së dhe ERA II, të cilat përfshijnë angazhime të rëndësishme afatshkurtra dhe afatmesme. Gjithashtu, këto përpjekje duhet të ndërlidhen me Instrumentin e Para-Anëtarësimit, mbështetjen buxhetore nga korniza e BE-së për investime në Ballkanin Perëndimor si dhe partnerë të tjerë zhvillimorë. Kjo është me rëndësi për të maksimizuar përdorimin e fondeve të BE-së dhe burimeve të tjera të financimit. Po ashtu,

Agjenda digjitale e Kosovës: Qeveria e Kosovës ka vendosur prioritet të lartë agjendën digjitale, për këtë qëllim organizatat buxhetore duhet të përfshijnë në kërkesat e tyre buxhetore adresimin e objektivave si në vijim: inovacionin dhe mbështetje digjitalizimit të bizneseve; përmirësimin e mëtutjeshëm të infrastrukturës së komunikimit; sigurinë dhe integritetin e rrjetit të komunikimeve dhe shërbimeve elektronike; sigurinë kibernetike; avancimin e qeverisjes dhe shërbimeve elektronikë; digjitalizimin në arsim, shëndetësi e drejtësi.

Të drejtat e njeriut dhe mundësitë e barabarta: të gjitha veprimet e Qeverisë së Kosovës përfshijnë përpjekje për të eliminuar pabarazitë e ndryshme, të cilat veprime janë shprehur nëpërmjet Programit të Qeverisë dhe janë pasqyruar në formë të objektivave dhe treguesve në Strategjinë Kombëtare për Zhvillim. Si rrjedhojë, organizatat buxhetore duhet të parashohin adresimin e prioriteteve si në vijim: sigurimin e qasjes së barabartë në arsim, në veçanti për fëmijët nga familjet me të ardhura të ulëta, pakicat kombëtare dhe zonat rurale; investimi në kujdesin shëndetësor parandalues për të përmirësuar rezultatet në shëndetësi dhe qasjen për të gjithë; qasje më të mirë në tregun e punës, me theks të veçantë për të rinjtë, gratë dhe grupet e tjera të cenueshme; qasje të mirëfilltë në drejtësi dhe shërbime publike; shpenzime të targetuara në mbrojtje sociale për të zvogëluar pabarazitë; përmirësimin e skemave sociale që targetojnë shpërndarje efikase për të përfituar grupet me më shumë nevojë; qasje më të mirë në strehim të denjë dhe të përbalueshëm. Avancimi i perspektivës gjinore dhe mbështetja për aktivizimin ekonomik janë gjithashtu prioritete me rëndësi, duke përfshirë edhe zotimin e Qeverisë së Kosovës për luftimin e dhunës në familje dhe formave të tjera të diskriminimit. Qeveria synon po ashtu të avancojë politikën për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve.

Diaspora dhe migrimi: çështjet e diasporës dhe migrimit janë relevante për shumicën e sektorëve të politikave publike, prandaj Qeveria synon të fuqizojë angazhimin e diasporës në zhvillimin e vendit. Kjo nënkupton krijimin e lehtësirave dhe mundësive për investime në sektorë të ndryshëm, dhe angazhimin e potencialit intelektual të tyre. Ruajtja e identitetit dhe kulturës së diasporës është objektivë e rëndësishme e Qeverisë, duke synuar gjithashtu angazhimin e pjesëtarëve të diasporës për promovimin e Kosovës në hapësirat ku ata jetojnë.

Mjedisi – agjenda e gjelbër: Kosova, sikurse vendet e rajonit, është zotuar për adresimin e prioriteteve që kanë dalë nga Marrëveshja e Gjelbër e Bashkimit Evropian. Në periudhën afatgjate kjo duhet të rezultojë në mjedis më të pastër, energji të përbalueshme, transport të mençur, vende të reja të punës dhe në përgjithësi cilësi më të mirë të jetesës. Në periudhën afatmesme, Qeveria synon të adresoj problemet e shumta mjedisore duke filluar nga menaxhimi i integruar i mbeturinave, mbrojtjen e resurseve natyrore, menaxhimin e pyjeve dhe ruajtjen e biodiversitetit, reduktimin e ndotësve të ajrit duke inkurajuar mënyra më aktive të jetesës. Kjo kërkon veprime të koordinuara për reduktimin e ndotjes në industri, biznes, energji, transport, bujqësi, pylltari, banim dhe sektorë të tjerë.

PJESA E DYTË

2. KORNIZA MAKRO-FISKALE

2.1. KORNIZA MAKROEKONOMIKE

2.1.1. Ambienti i Jashtëm Ekonomik


Duke pasur parasysh se Kosova është vend me një bilanc tregtar negativ, është e rëndësishë së veçantë analizimi i zhvillimeve globale dhe efektit të tyre në ekonomi pasi ato, në një mënyrë apo tjetër, do të manifestohen edhe në Kosovë. Gjatë dy viteve të fundit, ekonomia globale ka përjetuar tri goditje të mëdha. Së pari, që nga marsi 2020 filloi pandemia COVID-19; së dyti, kriza e fundit energjetike që filloi në tremujorin e fundit të vitit 2021; dhe së fundmi, fillimi i pushtimit të Ukrainës nga Federata Ruse në fund të muajit shkurt 2022. Këto tri goditje po kontribuojnë në ngadalësimin e rritjes ekonomike globale, si dhe në rritjen e çmimeve.

Bazuar në analizat e Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMN),² lufta e fundit pritet ta ngadalësojë rimëkëmbjen nga pandemia, të ndikojë në rritjen e çmimeve dhe në kohëzgjatjen e kësaj rritje. Kjo luftë pritet ta ndikojë ekonominë globale përmes tregtisë dhe deri në një masë kanaleve financiare. Ndikimi i luftës pritet të kontribuojë në rritjen e mëtejme të çmimit të ushqimit dhe karburanteve; për më tepër, kjo rritje e çmimeve pritet të zgjatë më shumë se sa parashikimet para fillimit të luftës. Përballë këtij sfondi, është mjaft sfiduese për politikbërësit pasi ata duhet të zbatojnë politika ekonomike, të cilat në njërin anë sigurojnë vazhdimin e rimëkëmbjes ekonomike nga pandemia, dhe në anën tjetër ndikojnë deri në një masë në kontrollimin e inflacionit.

Projeksionet e fundit të FMN-së të publikuara në prill 2022, të cilat marrin parasysh zhvillimet e përmendura më lartë, sugjerojnë se rritja reale ekonomike botërore në vitin 2022 do të jetë 3.6 përqind, që përbën një rishikim për poshtë me 0.8 p.p. krahasuar me parashikimin paraprak të publikuar në janar të vitit 2022. Përderisa Bashkimi Evropian pritet të ketë një rritje ekonomike prej 2.9 përqind në vitin 2022, ekonomitë evropiane në zhvillim pritet që mesatarisht të kenë një rritje negative prej 2.9 përqind. Kjo rritje negative ekonomike pritet të shkaktohet kryesisht nga rënia drastike ekonomike në dy vendet që janë në luftë, Ukraina dhe Federata Ruse, pasi shumica e vendeve të tjera evropiane në zhvillim pritet të kenë rritje pozitive. Sa i përket parashikimeve për vitin 2023, pritet të ketë rritje ekonomike si në nivel botëror, ashtu edhe në secilin grup të ekonomive të prezantuara në Grafikon 1.

² Fondi Monetar Ndërkombëtar (2022), *Perspektiva Ekonomike Botërore* (shih [linkun](#))

Grafiku 1: Rritja ekonomike sipas grupeve të vendeve të ndryshme



Të dhënat e publikuara nga FMN, parashikojnë që inflacioni gjatë vitit 2022 do të jetë rreth 5.7 përqind në ekonomitë e avancuara, shifër kjo më e lartë për 1.8 p.p. se parashikimet në analizat e publikuara në janar 2022. Sa i përket ekonomive evropiane në zhvillim, ku bën pjesë edhe Kosova, shkalla e inflacionit pritet të arrijë në 27.1%, me inflacionin më të madh të shënuar në Turqi (60.5%) dhe Rusi (21.%). Sipas FMN-së, kjo rritje e çmimeve pritet t'i prek më së shumti ekonomitë familjare me të ardhura të ulëta, andaj ky grup duhet të merret parasysh gjatë dizajnit të politikave.

Në Tabelën 1 janë paraqitur parashikimet për çmimet e mallrave bazë për vitin 2022 dhe 2023 të publikuar nga FMN në prill të vitit 2021. Sipas këtyre parashikimeve, në vitin 2022 pritet të ketë rritje në çminimin e naftës për 64.3 përqind, çmimin e ushqimit për 20.9 përqind, dhe në çmimin e metaleve për 1.7 përqind. Për të gjitha këto kategori pritet të ketë ulje të çmimeve në vitin 2023, por me një normë më të ngadalshme se sa ajo e rritjes në vitin 2022.

Tabela 1: Parashikimi i ndryshmeve të çmimeve në tregjet ndërkombëtare³

Çmimet kryesore të mallrave bazë (në përqindje, v-m-v)	2020	2021	2022	2023
Nafta	-34.0	61.3	64.3	-14.5
Mallrat bazë pa naftën	4.7	22.2	18.3	-3.8
Ushqimi	-0.3	23.2	20.9	-7.0
Metalet	1.5	41.6	16.7	-1.5

³ Fondi Monetar Ndërkombëtar (2022), *Perspektiva Ekonomike Botërore* (shih [linkun](#))

2.1.2. Zhvillimet e Fundit Ekonomike në Kosovë

Sipas të dhënave tremujore nga Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK), BPV-ja reale gjatë vitit 2021 ka pasur rritje dyshifrore prej 10.53% krahasuar me vitin paraprak.


Të dhënat për 2021 tregojnë se **konsumi total** ka shënuar kontribut pozitiv në aktivitetin ekonomik prej 7.7 p.p., me një rritje reale vjetore prej 7.8%, që është reflektuar në rritjen e të dy nën-komponentëve, publik dhe privat me 7.6% dhe 9.1%, respektivisht. Rritja e konsumit privat i atribuohet rritjes rekorde të remitancave, rritjes së kredive të reja konsumuese, dhe stimulit fiskal në formë të subvencioneve dhe transfereve. Në anën tjetër, rritja e konsumit publik i atribuohet shpenzimeve qeveritare në kuadër të Pakos së Ringjalljes Ekonomike por edhe kthimit në normalitet të aktivitetit të administratës publike.

Investimet gjatë 2021-ës kanë shënuar rritje prej 10.3%, duke shënuar kontribut pozitiv në BPV prej 3.4 p.p., si rezultat i rritjes në investime private nxitur nga investimet e huaja direkte, kreditimi bankar, por edhe relaksimi i masave kufizuese. Gjithashtu, investimet publike shënuan një dinamikë më të shpejtë të ekzekutimit krahasuar me vitin paraprak.

Eksporti neto në terma realë është rritur rreth 1.9% në vitin 2021, pasi rritja e ndjeshme e importit të mallrave dhe shërbimeve është kompensuar pothuajse plotësisht nga rritja e eksporteve, veçanërisht e atyre të shërbimeve.

Indeksi i çmimeve të konsumit është rritur mesatarisht me 3.4% në vitin 2021, duke shënuar një trend të përsheptuar në pjesën e dytë të vitit. Kontributi kryesor pozitiv gjatë këtij viti erdhi nga kategoria “Ushqime dhe Pije Joalkoolike”, “Transporti” dhe “Komunikimi”. Rritja e ndjeshme e çmimeve në Kosovë, sidomos në gjysmën e dytë të vitit 2021, shpjegohet kryesisht nga ‘fytet e ngushta’ dhe çrregullimet në zinxhirin e furnizimit në tregun global.

Grafiku 2: Bilanci i llogarisë rrjedhëse



Deficiti i llogarisë rrjedhëse gjatë vitit 2021 u përkeqësua, duke arritur vlerën -8.6% e BPV-së, kryesisht si rezultat i zgjerimit të deficitit tregtar të mallrave (rreth 32.0% e BPV-së).


Eksporti i mallrave dhe shërbimeve shënoi rritje vjetore prej 78.2%. Krahasuar me vitin paraprak, eksporti i mallrave ishte 51.3% më i lartë, ndërsa eksporti i shërbimeve regjistroi rritje të konsiderueshme prej 96.4%. Eksporti i mallrave ka pasur trend

të vazhdueshëm të rritjes në vitet e fundit, si pasojë e zhvillimit të kapaciteteve prodhuese dhe depërtimit në tregjet e reja globale. Në vitin 2021, eksportet e mallrave drejt vendeve të CEFTA përbëjnë 36.9%, ndërsa eksportet drejt vendeve anëtare të BE-së përbëjnë rreth 31.4% e eksporteve totale. Ndërsa, nga eksportet drejt vendeve tjera përveç BE-së dhe CEFTA-ës, pjesëmarrje më të madhe kishin ato drejt SHBA-vë me 16.4% dhe Zvicrës me 7.5%. Tregtia me SHBA-të është rritur ndjeshëm në vitin e fundit, pasi në vitin 2020, vetëm 5.0% e eksporteve totale të mallrave kishin për destinacion Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Në anën tjetër, rrija e madhe e eksportit të shërbimeve i atribuohet efekti bazë për shkak të kufizimeve në udhëtime gjatë vitit 2020, por edhe ardhjes më të madhe të diasporës gjatë muajve të verës se ecuria historike e para pandemisë.

Importi i mallrave dhe shërbimeve shënoi rritje të konsiderueshme vjetore prej 41.6%. Importi i mallrave nga vendet e BE-së përbën rreth 44.3% të importeve totale, ku 29.4% dominohet nga Gjermania, pasuar nga Italia me 13.3%. Ndërsa, importet nga vendet anëtare të CEFTA përbëjnë rreth 19.1% të totalit të importeve, ato nga Turqia 12.6% dhe ato nga Kina 9.7%. Kjo rritje e importit përkon me rritjen e kërkesës agregate. Importi i shërbimeve në vitin 2021 u rrit me 44.3% krahasuar me vitin paraprak. Shpenzimet e udhëtimeve dhe të transportit janë përgjegjësit kryesor që e shpjegojnë këtë rritje, por duke e pasur parasysh gjithmonë efektin bazë – në vitin 2020, për shkak të mbylljes, nuk kishte shumë udhëtime të rezidentëve.

Bilanci i të ardhurave parësore shënoi rënie vjetore prej 1.3%, të ndikuar kryesisht nga të kategoria e kompensimit të punëtorëve. **Bilanci nga të ardhurat dytësore** kishte rritje vjetore prej 5.9%. Rol të rëndësishëm në këtë rritje kishin neto remitancat të cilat shënuan rritje prej 17.7%.

Grafiku 3: Tregu i punës




Të dhënat e fundit në dispozicion të tregut të punës të publikuara nga Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) tregojnë se shkalla e punësimit në tremujorin e parë të vitit 2021 shënoi një përmirësim të lehtë në terma vjetorë, duke arritur në 29.3%. Pjesëmarrja në fuqinë punëtore u përmirësua me 0.7 p.p., duke arritur në 39.5%. Shkalla e papunësisë u rrit me 0.8 p.p. në terma vjetorë duke arritur në 25.8%. Duhet theksuar se zgjedhjet

e përgjithshme, të cilat u mbajtën në shkurt 2021, mund të kenë kontribuar në një përmirësim të përkohshëm të treguesve të tregut të punës. Në mungesë të të dhënave të publikuara nga Anketa e Fuqisë Punëtore të ASK-së, të dhënat administrative nga ATK-ja janë shfrytëzuar për të dhënë një pamje më të plotë në lidhje me punësimin për vitin 2021. Të dhënat e fundit tregojnë një rritje në

punësim, me 10.9% krahasuar me vitin e kaluar, në përputhje me ecurinë e aktivitetit ekonomik dhe masat e qeverisë në drejtim të formalizimit të punësimit.

Në linjë me aktivitetin ekonomik, sektori bankar shënoi performancë të kënaqshme, të karakterizuar nga një rritje dy-shifrore e stokut të kredisë, me rreth 15.5%. Kreditë e ndërmarrjeve janë rritur me 14.0%, ndërsa ato të ekonomive familjare me 13.0%.

Grafiku 4: Kreditë, depozitat dhe kreditë jo-performuese



Në fund të vitit 2021 totali i depozitave arriti vlerën prej rreth 4.901 miliardë Euro, duke shënuar kështu një rritje vjetore prej 12.4%, nga të cilat depozitat e ndërmarrjeve kanë shënuar rritje për 12.3% (v-m-v), ndërsa ato të ekonomive shtëpiake kanë shënuar rritje vjetore prej 14.6%. Gjithashtu, niveli i kredisë joperformuese është përmirësuar duke arritur në 2.3% në fund të vitit 2021, nga 2.7% sa ishte në fund të vitit 2020. Norma mesatare e interesit të kredisë të reja gjatë vitit 2021 ishte 6.0%, apo rreth 0.3 p.p. më e ulët se në vitin e kaluar.

Hapësirë Informuese 1. Krahasimi i parashikimeve fillestare makroekonomike në KASH-et e mëhershme me aktualet

Për të identifikuar animet e mundshme sistematike në projeksione (qoftë për lartë apo për poshtë), në figurën e mëposhtme kemi paraqitur krahasimin ndërmjet parashikimeve të treguesve kryesorë makroekonomikë të paraqitur në KASH-et e mëhershëm dhe performancës së tyre aktuale gjatë periudhës 2014- 2021⁴.

Siç është paraqitur në figurën e mëposhtme, norma e parashikuar e rritjes së BPV-së nominale për vitet 2015, 2016, 2017 dhe 2019 është më e ulët në krahasim me të dhënat aktuale, edhe pse hendeku ndërmjet tyre është i ngushtë. Krahasimi ndërmjet nën-komponentëve të BPV-së tregon se niveli aktual i investimeve ka qenë më i lartë se niveli i tyre i projektuar (përveç në vitin 2019 kur parashikimet për rritje të investimeve ishin të mbivlerësuar). Ngjashëm ka qenë edhe realizimi i ecurisë së eksporteve, me përjashtim të vitit 2015, kur eksportet kishin rritje më të

⁴ Vlerat e BPV-së dhe komponentët përbërës janë preliminare deri në publikimin e të dhënave vjetore nga Agjencia e Statistikave të Kosovës (Shtator 2022).

ulët se që ishin parashikuar. Në anën tjetër konsumi dhe importet kishin devijime më të vogla. Në vitet 2014 dhe 2018, parashikimet për rritjen nominale të BPV-së ishin më optimiste, duke qenë më të larta se sa performanca aktuale.

Vitet 2020 dhe 2021 u karakterizuan me devijim më të lartë në mes të vlerave aktuale dhe parashikimeve (-9.6 p.p. dhe 7.92 p.p., respektivisht). Devijimi në vitin 2020 ishte për shkak të goditjes së ekonomisë nga pandemia COVID-19, ku goditjen më të madhe e pësuan eksportet me devijim negativ nga niveli i projektuar prej 35.9 p.p., investimet me 12.9p.p., importet me 14.5 p.p. dhe konsumi 3.1 p.p.. Ndërsa në vitin 2021 devijimi erdhi si rezultat i rimëkëmbjes më të shpejtë të ekonomisë se sa që pritej. Eksportet kishin devijim pozitiv prej 76.9 p.p., importet 29.2 p.p., investimet 6.9 p.p. dhe konsumi devijim prej 4.0 p.p.

Sa i përket inflacionit, dallimi midis vlerave aktuale dhe parashikimeve ka qenë historikisht qenë i ulët. Në vitin 2019 devijimi ishte 1.0 p.p. për shkak të pritjeve më të ulëta (se ato të materializuara) mbi presionet inflacioniste që tarifa e vendosur për mallrat nga Serbia dhe Bosnja dhe Hercegovina mund të kishte, në kohën kur u realizuan parashikimet fillestare për 2019-ën. Në vitin 2020, është regjistruar normë më e ulët e inflacionit se niveli i projektuar, kryesisht si rezultat i rënies së çmimit të naftës në tregjet ndërkombëtare gjatë kësaj periudhe dhe rënies së aktivitetit ekonomik. Ky nivel i ulët i inflacionit i atribuohet gjithashtu heqjes së tarifës 100% për produktet e importuara nga Serbia dhe Bosnja dhe Hercegovina.

Gjatë vitit 2021 inflacioni ishte më i lartë se që ishte planifikuar fillimisht, duke regjistruar devijim pozitiv prej 1.4 p.p. Kjo rritje e inflacionit erdhi kryesisht nga rimëkëmbja ekonomike postpandemike, si në nivel global ashtu edhe në ekonominë vendase, e cila shkaktoi çrregullime në zinxhirin global të furnizimit duke çuar kështu në rritje të theksuar të naftës dhe ushqimeve.







Duke qenë se BPV-ja nominale përdoret si variabël makroekonomike kyçe që ndikon në të hyrat buxhetore, vlerat më të ulëta aktuale të BPV-së sesa ato të parashikuara zakonisht⁵ kanë ndikim negativ në mbledhjen e të hyrave për ato vite krahasuar me parashikimet, veçanërisht për kategoritë e tatimeve në të ardhura personale dhe në të ardhura të korporatave;

Edhe pse dallimi (hendeku) në mes të konsumit të parashikuar dhe tij aktual nuk është i lartë, ai prapë çon në pritje më të larta për të hyrat e mbledhura nga TVSH e brendshme.

Këto divergjenca ndërmjet projeksioneve dhe shifrave aktuale të variablave ekonomike mund të kenë kontribuar në të hyra më të ulëta sesa ato të parashikuara, me përjashtim të vitit 2021.

Figura 1: Variablat kryesore makroekonomike 2014-2021: Projektionet për KASH ndaj realizimit (aktualeve)

⁵ Në kontekstin e Kosovës, përfitimet nga përmbushja e obligimeve për tatimet direkte dhe TVSH-në e brendshme mund të mbivendosen (përkojnë) me efektet e variablave makroekonomike që ndikojnë në të hyrat tatimore.



2.1.3. Perspektiva Makroekonomike në vitin 2022 dhe periudhën afatmesme

Pas një rritje dyshifrore prej 10.5% në vitin 2021, ekonomia e Kosovës pritet të shënojë një rritje më të moderuar, kryesisht si rezultat i tronditjeve në zinxhirin e furnizimit në tregjet globale dhe pasojave të luftës në Ukrainë.

Informacioni i disponueshëm për tremujorin e parë të vitit 2022, edhe pse i limituar, tregon se rritja ekonomike mbetet në territor pozitiv, por me rreziqet të shtuara kryesisht nga ambienti i jashtëm. Ashtu, siç tregon edhe Tabela 2, gjatë tre muajve të parë të vitit 2022, importi i mallrave në sasi ka shënuar rënie në terma vjetorë, duke sinjalizuar kështu ngadalësimin në aktivitetin ekonomik, ndërkohë që importi i mallrave në vlerë ka shënuar rritje të ndjeshme, për shkak të rritjes së çmimeve të importit. Edhe pse në muajin dhjetor 2021, një prej eksportuesve më të mëdhenj të Kosovës (NewCo Ferronickel) ka ndaluar prodhimin si pasojë e krizës energjetike, eksporti i mallrave të tjerë ka kompensuar boshllëkun e krijuar nga NewCo Ferronikel, duke vazhduar rritjen e kënaqshme të dy viteve të fundit (si në sasi ashtu edhe në vlerë).

Të hyrat buxhetore (mbledhur nga ATK dhe Dogana) kanë vazhduar të shënojnë rritje të theksuar, si rezultat i formalizimit të ekonomisë dhe rritjes së shpejtë të inflacionit gjatë këtyre muajve. Ndërkohë, shpenzimet kapitale shfaqin një dinamikë më të ulët ekzekutimi se në vitin paraardhës.

Trendi i rritjes së çmimeve vazhdoi edhe në tremujorin e parë të vitit 2022, duke arritur kulmin në muajin mars, me rreth 10.0%, çka reflekton kryesisht dryshimin e çmimeve në kategorinë e ushqimeve dhe transportit. Ky trend u përshpejtua nga lufta në Ukrainë dhe vendosja e sanksioneve të vendeve perëndimore ndaj Rusisë.

Tabela 2: Disa Indikatorë Ekonomikë

<i>Indikator, v-m-v, % nëse nuk ceket ndryshe</i>	<i>Janar '22</i>	<i>Shkurt '22</i>	<i>Mars '22</i>
Importi i Mallrave (Sasi)	-14.9%	-1.0%	-9.7%
Importi i Mallrave (Vlerë)	43.1%	37.6%	28.9%
Eksporti i Mallrave (Sasi)	31.0%	63.5%	63.4%
Eksporti i Mallrave (Vlerë)	56.4%	35.3%	43.5%
Të Hyrat Buxhetore	20.1%	21.9%	22.5%
Të Hyrat ATK	26.7%	41.6%	32.5%
Të Hyrat Dogana	16.0%	16.6%	12.2%
Shpenzimet Kapitale (<i>diferenca mln EUR</i>)	(0.9)	(18.9)	(9.9)
IHÇK	7.1	7.5	10.0

Sipas projeksioneve të fundit të azhurnuara nga MFPT- ja, ekonomia e Kosovës gjatë vitit 2022 pritet që të shënojë rritje nominale prej 12.0% ndërsa në terma realë me rreth 5.7%. Ky vlerësim përbën një rishikim për poshtë nga vlerësimet tona fillestare, duke reflektuar presionet e rritura inflacioniste nga lufta në Ukrainë, ndërkohë që rreziqet e lidhura me pandeminë janë ulur ndjeshëm. Rritja reale prej 5.7% në vitin 2022 pritet të vijë kryesisht si rezultat i eksporteve neto

dhe sektorit publik, veçanërisht shpenzimeve kapitale. Ndërkohë, ndikimi negativ i presioneve të larta inflacioniste në të ardhurat e disponueshme dhe në besimin e konsumatorëve pritet të çojë në një kontribut negativ të konsumit privat në rritjen reale të BPV-së. Ngjashëm, investimet private pritet të frenohen si rezultat i rritjes së pasigurisë kombinuar me rritjen e çmimeve në tregjet ndërkombëtare.

Presionet e larta inflacioniste që karakterizojnë pjesën e dytë të vitit 2021 dhe fillimin e vitit 2022 priten të vazhdojnë edhe në muajt në vijim, nxitur nga rritja në çmimet e ushqimeve dhe naftës në tregjet ndërkombëtare, ndërkohë që në pjesën e dytë të vitit pritet normalizimi i kësaj tendence rritëse, duke shënuar një vlerë mesatare prej 6.6% për gjithë vitin 2022.


Në periudhën afatmesme (2023-2025), ekonomia e Kosovës pritet të shënojë rritje reale që qëndron mbi mesataren historike të para-pandemisë, duke u luhatur rreth vlerës 6.5% në terma realë.

Konsumit privat pritet të ketë kontributin më të lartë në BPV. Kjo rritje pritet të vijë kryesisht si rezultat i një zgjerimi më të madh të kreditimit, nxitur edhe nga rritja e kapitalizimit të Fondit Kosovar për Garanci Kreditore. Po ashtu, prurjet e remitancave priten të vazhdojnë të mbetet një burim i rëndësishëm i financimit të konsumit privat. Ndërkohë, investimet private në periudhën afatmesme priten të shënojë rritje, si rezultat i rritjes së kreditimit por edhe rritjes së eksportit të mallrave, i cili nxit investimet private.

Rritja e fondeve koncesionare nga Institucionet Ndërkombëtare Financiare dhe adresimi i kostove të shpronësimeve, i cili mund të ndihmojë në absorbimin e këtyre fondeve përmes projekteve investive, do të ndikojnë në rritjen e investimeve publike në periudhën afatmesme. Ndërsa, konsumi publik pritet që të vazhdojë uljen, për shkak të përfundimit të shpenzimeve të Pakos së Ringjalljes Ekonomike gjatë vitit aktual (2022). Reformat e mëtejshme për të nxitur konkurrueshmërinë do të ndihmonin në ruajtjen e momentumit pozitiv në ecurinë e eksportit të mallrave në afatin e mesëm. Ndërkohë, që importi i mallrave do të vazhdojë të rritet duke qenë në linjë me ecurinë e kërkesës agregate, veçanërisht me pritjet e ekzekutimit të investimeve publike, të cilat kanë përmbajtje të lartë të importit.

Inflacioni, në periudhën afatmesme, pritet të kthehet në normalitet, nën supozimin që nuk do të ketë valë të reja të pandemisë dhe çrregullimeve të mëtejshme në zinxhirin global të furnizimit, me një vlerë mesatare prej 1.8%.

Grafiku 5: BPV-ja sipas komponentëve



2.2 KORNIZA FISKALE 2023-2025

2.2.1. Të Hyrat Dhe Shpenzimet Qeveritare

2.2.1.1 Të hyrat dhe shpenzimet në vitin 2022

Në tremujorin e parë të vitit 2022, situata dhe perspektiva ekonomike në Kosovë u ndikua nga zhvillimet globale në nivelin e çmimeve, si pasojë e çrregullimeve në zinxhirin global të furnizimit dhe së fundmi prej luftës në Ukrainë. Sipas Ligjit të Rishikuar të Buxhetit për vitin 2022, vlerësimet e MFPT-së për vitin 2022 tregojnë që të hyrat buxhetore do të shënojnë një rritje vjetore prej 10.4%, të shtyra kryesisht nga rritja ekonomike dheulja e informalitetit.

Në anën tjetër, shpenzimet buxhetore në vitin 2022 priten të kenë një rritje prej rreth 26.1% krahasuar me vitin e kaluar, kryesisht si rezultat i pritjeve për një dinamikë më të shpejtë të realizimit të shpenzimeve kapitale.

Gjatë tre mujorit të parë të vitit 2022, vihet re rritje e theksuar e të hyrave totale krahasuar me vitin e kaluar, me rreth 19.3% (më e mirë se ç'pritej). Kjo rritje është e reflektuar në të gjitha kategoritë e të hyrave, si tek tatimore (20.3%) po ashtu edhe tek jo tatimore (12.0%).

Shpenzimet buxhetore kanë shënuar rënie krahasuar me tremujorin e parë të vitit të kaluar, me rreth 11.7%, kryesisht si rezultat i shpenzimeve më të ulta në kategorinë e shpenzimeve kapitale dhe subvencioneve dhe transfereve.

Hapësirë Informuese 2. Krahasimi i parashikimit makroekonomik për KASH-in 2023-2025 me institucionet e tjera

Tabelat në vijim paraqesin projeksionet e normës së rritjes së BPV-së reale (nëse është në dispozicion) në mesin e institucioneve të ndryshme⁶ për periudhën afatmesme. Një krahasim i tillë mundëson gjykimin se a janë projeksionet makroekonomike të MFPT -së në përputhje me ato të institucioneve të tjera (vendore dhe ndërkombëtare).

Të gjitha institucionet kanë pritur përshpejtim të rritjes ekonomike në vitin 2021, si rezultat i heqjes së masave kufizuese, stimulit fiskal të dhënë nga Qeveria dhe mbështetjes së jashtëzakonshme nga diaspora. Të dhënat e MFPT-së, BQK-së dhe BERZH-it për 2021 reflektojnë të dhënat të ASK-së, ndërsa të dhënat e institucioneve të tjera janë ende vlerësime, për shkak të mungesës së disponueshmërisë së të dhënave nga ASK-ja në kohën e përgatitjes së parashikimeve nga ana e tyre ose për shkak të gjyimit të tyre për vlerësim ndryshe të rritjes ekonomike që pritet të publikohet në llogaritë kombëtare vjetore nga ASK-ja në shtator 2022.

Siç tregon Tabela 1, projeksionet e MFPT –së për vitin 2022 dhe për periudhën afatmesme janë më të larta se mesatarja e vlerësimeve të institucioneve të tjera, kryesisht si rezultat i pritjeve për një dinamikë më të shpejtë të ekzekutimit të shpenzimeve kapitale. Devijimi më i madh ndërmjet projeksioneve është me Fondin Monetar Ndërkombëtar (FMN), kryesisht për shkak të presioneve më të larta inflacioniste të shkaktuara nga kriza në Ukrainë, të pritura nga kjo e fundit.

Sa i përket BPV-së nominale, projeksionet e MFPT-së janë mjaft të ngjashme me ato të FMN-së në vitin 2022, ndërkohë që në periudhën afatmesme hendeku ndërmjet vlerësimeve të këtyre dy institucioneve thellohet.

Viti	2020	2021	2022	2023	2024	2025
MFPT (Prill'2022)	-5.3%	10.5%	5.7%	7.1%	6.2%	6.1%
Banka Qendrore e Kosovës	-5.3%	10.5%	3.3%	n/a	n/a	n/a
Banka Botërore (Prill 2022)	-5.3%	9.1%	3.9%	4.3%	4.2%	n.a
FMN (Prill 2022)	-5.3%	9.5%	2.8%	3.9%	4.1%	3.9%
BERZH (Mars 2022)	-5.3%	10.5%	4.0%	4.0%	n/a	n/a
Mesatarja e të tjerëve	-5.3%	9.9%	3.5%	4.1%	4.2%	3.9%

Viti	2020	2021	2022	2023	2024	2025
MFPT	6,772	7,817	8,754.5	9,621.3	10,407.8	11,156.4
FMN	6,772	7,637	8,568	9,212	9,815	10,400

Viti	2020	2021	2022	2023	2024	2025
MFPT	0.2%	3.3%	6.6%	2.5%	1.8%	1.2%

⁶ Projeksionet e institucioneve të tjera janë marrë nga përditësimet e tyre të fundit dhe jo të gjitha prej tyre mbulojnë të njëjtin horizont të parashikimit. Kllapat në tabela paraqesin datën e përditësimit të fundit për secilin institucion.

Banka Botërore	0.2%	3.4%	5.4%	1.6%	2.2%	n/a
FMN	0.2%	3.3%	9.5%	3.3%	2.3%	2.0%
Mesatarja e të tjerëve	0.2%	3.4%	7.4%	2.5%	2.3%	2.0%

2.2.1.2. Parashikimi i të hyrave për periudhën 2023-2025

Të hyrat buxhetore për periudhën afatmesme priten të rriten me shume se rritja historike, bazuar në projeksionet makroekonomike. Gjithsesi, duhet theksuar që ekzistojnë pasiguri, që burojnë nga situata e krijuar nga zhvillimet në ekonominë globale pas ndikimit të pushtimit rus në Ukrainë, gjë që ndikon në rishikimin e të hyrave në periudhën afatmesme.


Në bazë të projeksioneve të fundit, **të hyrat e përgjithshme buxhetore** pritet të rriten mesatarisht me 8.0% gjatë periudhës afat-mesme.

Të hyrat nga tatimet indirekte vazhdojnë të kenë pjesëmarrjen më të lartë në të hyrat e përgjithshme dhe pritet të rriten rreth 8% në periudhën afatmesme. TVSH-ja pritet të rritet mesatarisht me 9%, e shtyrë nga rritja e importit të mallrave dhe e konsumit të përgjithshëm. Të hyrat nga akciza parashihen të kenë rritje mesatare prej 5.0% në periudhën afatmesme, ndërsa të hyrat nga detyrimi doganor priten të rriten mesatarisht me 9% në të njëjtën periudhë, bazuar në rritjen e importeve, por duke marrë parasysh zvogëlimin e efektit negativ të MSA.

Krahas kësaj, **të hyrat nga tatimet direkte** pritet të rriten mesatarisht po ashtu rreth 8% në periudhën afatmesme. Ky projeksion merr parasysh edhe efektin negativ në të hyrat që pritet të vijë nga rritja e pragut të pagës së pa tatueshme (deri në 250 Euro që përkon me nivelin e pagës minimale).

Të hyrat jo-tatimore parashihet të kenë një rritje prej 7.0% në periudhën afatmesme. Parashikimi pasqyron një zbatim më dinamik të procesit të pagesave që lidhen me të hyrat jo tatimore.

Grafiku 6: Struktura e të hyrave në të hyrat e të përgjithshme



Hapësirë Informuese 3. Krahasimi i parashikimeve buxhetore dhe aktualeve për vitin 2021

Tabela 1 në Aneks 2 mundëson krahasimin e performancës së zërave buxhetorë kryesorë sipas realizimit të tyre krahasuar me buxhet dhe KASH (atë fillestar dhe më të fundit) për vitin 2021.

Sa i përket shpenzimeve, vrojtimi kryesor është se shpenzimet rrjedhëse në vitin 2021 të paraqitura në KASH të rishikuar (2021- 2023) janë të nënvlerësuara, kryesisht për shkak të rritjes së paparashikuar të shpenzimeve në kuadër të Pakos së Ringjalljes Ekonomike, veçanërisht në kategorinë ‘subvencione dhe transfere’. Ngjashëm është edhe krahasimi i vlerave të buxhetit fillestar për vitin 2021 me vlerat e realizuara, por në magnitudë më të vogël. Realizimi më i madh i shpenzimeve krahasuar me projeksionet vjen kryesisht si rezultat i ridizajnit të shpeshtë të masave të ndërmarra në kuadër të pandemisë për t’i përgjigjur dinamikës së zhvillimeve ekonomike gjatë këtij viti por edhe ndërrimit të qeverisë gjatë periudhës së përgatitjes së KASH 2021- 2023 (fillestar dhe i rishikuar) dhe Buxhet 2021.

Shpenzimet kapitale janë nën projeksionet e tyre si në KASH ashtu edhe në Buxhetin vjetor për dy arsye kryesore:

- 1) mos ekzekutimit të klauzolës së investimeve për shkak të vështirësive në funksionimin efikas të njësive implementuese;
- 2) mos ekzekutimit të projekteve kapitale të financuara nga buxheti i rregullt, pjesërisht si rezultat i mos-funksionimit të Bordit të Organit Shqyrtues të Prokurimit;
- 3) mungesës së investimeve të financuara përmes të ardhurave të likuidimit;

Në vitin 2021 kishte diferencë pozitive ndërmjet të hyrave të realizuara dhe projeksioneve të të hyrave si në KASH-in e fundit (2021-2023) ashtu edhe në Buxhetin vjetor 2021. Performanca e të hyrave ishte më e mirë se sa ajo e planifikuar, kryesisht si rezultat i rikuperimit të aktivitetit ekonomik mbi pritshmëritë tona fillestare, presioneve të rritura inflacioniste në fund të vitit 2021 dhe formalizimit të ekonomisë nxitur kryesisht nga masat e Pakos së Ringjalljes Ekonomike.


2.2.1.3. Parashikimi i shpenzimeve për periudhën 2023-2025

Shpenzimet buxhetore në periudhën afatmesme priten të rriten më pak se rritja historike që u shënuar para pandemisë. Ecuria e tyre në periudhën afatmesme pritet të jetë në respektim të Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe të kompensojë deficitin e tejkaluar mbi rregullën fiskale në 2020.

Përgjatë periudhës afatmesme 2023-2025, shpenzimet parashikohen të mbajnë një pjesëmarrje prej rreth mesatarisht 29.8% të BPV-së. Prej tyre, shpenzimet rrjedhëse pritet të jenë rreth 20.6% të BPV-së, ndërsa shpenzimet kapitale do të kenë një pjesëmarrje prej 8.6%. Një pjesë e shpenzimeve kapitale planifikohet të financohet nga huamarrja e jashtme përmes klauzolës së investimeve, e cila i mundëson Qeverisë të financojë projekte me interes publik dhe që ndikojnë në uljen e pengesave zhvillimore (infrastrukturore) të vendit.

Gjatë periudhës 2023-2025, është planifikuar që shpenzimet mesatarisht të rriten për 3.4%. Në Grafikon 7 është paraqitur struktura e shpenzimeve të përgjithshme qeveritare përgjatë periudhës afat-mesme e cila është planifikuar si në vijim:

Grafiku 7: Struktura e shpenzimeve buxhetore



Shpenzimet rrjedhëse në periudhën afatmesme planifikohen të rriten me prej 0.1%. Kategoria e shpenzimeve për **paga dhe shtesa** planifikohet të rritet me një mesatare prej rreth 2.6% përgjatë periudhës së ardhshme afat-mesme. Kategoria e **mallrave dhe shërbimeve** pritet të mbajë nivelin e njëjtë të shpenzimit edhe gjatë periudhës afatmesme. **Subvencioneve dhe transferet**, planifikohet të kenë ulje mesatare prej 3.6% përgjatë periudhës 2023-2025. Shpenzimet në këtë kategori pritet të jenë 9.1% në raport me BPV-së gjatë periudhës afatmesme.

Shpenzimet kapitale - përbëjnë një pjesë të konsiderueshme të shpenzimeve të përgjithshme dhe pritet të përfaqësojnë rreth 29.0% të shpenzimeve totale në periudhën afatmesme. Gjatë kësaj periudhe, pritet implementimi i projekteve kapitale bazuar në një listë prioritetesh që përmban projekte me ndikim në përmirësimin e rrjetit të transportit, përmirësimin e rrjetit të energjisë elektrike dhe përmirësimin e kushteve në arsim, sistemin social dhe atë shëndetësor. Kjo kategori e shpenzimeve gjatë vitit 2023 pritet të shënojë rritje prej 12.6% në krahasim me vitin 2022. Ndërsa në vitet 2024-2025 planifikohet të vazhdojë me trend më të ulët të rritjes. Pjesa më e madhe e investimeve kapitale gjatë periudhës së ardhshme afatmesme pritet të jetë nga financimi i buxhetit të rregullt, mirëpo një numër i madh i projekteve në sektorë të ndryshëm planifikohet të financohet nga huazimi i jashtëm përmes klauzolës së investimeve (Kutia e klauzolës së investimeve në aneks).

Hapësirë Informuese 4. Devijimet kryesore ndërmjet KASH-ve 2022- 2024 dhe 2023- 2025 për vitet 2023 dhe 2024

Tabelat 2 dhe 3 në Aneks 2 identifikojnë dhe shpjegojnë ndryshimet në të hyra dhe shpenzime mes KASH 2022-2024 dhe KASH 2023-2025. Tabela 2 paraqet devijimet në parashikimet për vitin 2023 ndërsa tabela 3 paraqet devijimet për vitin 2024.

Sa i përket të hyrave, kemi devijime të ngjashme në të dy vitet dhe vjen kryesisht nga të hyrat tatimore indirekte si Akcizë, TVSH kufitare dhe TVSH vendore duke mos përjashtuar edhe tatimet direkte dhe të hyrat jo tatimore. Devijimin në të hyrat nga tatimet indirekte u shkaktuan nga tre faktorë kryesorë: (i) rritja reale ekonomike në vitin 2021, duke rritur nivelin e të hyrave në këto kategori në vitin 2021, nivel ky që përdoret si efekt bazë për parashikimin e të hyrave në vitet vijuese; (ii) rritja e presioneve infacioniste në vitin 2022 të shkaktuara nga çrregullimet në ekonominë globale si pasojë e luftës në Ukrainë; (iii) vazhdimi i zgjerimit të bazë tatimore si rezultat i formalizimit të ekonomisë;

Shpenzimet buxhetore gjithashtu në të dy vitet 2023 dhe 2024 janë më të larta në krahasim me ato të planifikuara në KASH-in e kaluar. Këto devijime janë për disa arsye: (i) rritja e nivelit të të hyrave ka paraprirë rritjen e shpenzimeve; (ii) rritja e kategorisë së mallrave dhe shërbimeve si rezultat i vendosjes së kontigjencës për ligje të reja; (iii) rritja e mallrave dhe shërbimeve si rezultat i financimit të jashtëm-kredisë për barna dhe rritjes së rezervave shtetërore dhe rezervave të naftës; (iv) rritja në kategorinë e subvencioneve si rezultat i ndryshimeve në skemat sociale;

2.2.2. Deficiti Buxhetor Dhe Rregulla Fiskale

Si rrjedhojë e rritjes së shpenzimeve rrjedhëse, si dhe ruajtjes së pjesëmarrjes së lartë të shpenzimeve kapitale, deficiti për vitin 2023, sipas rregullës fiskale, pritet të jetë 154.3 milionë EUR, apo rreth 1.6% e BPV-së së parashikuar për këtë vit, ndërsa bilanci i shfrytëzueshëm bankar pritet të jetë 3.1 % e BPV-së.

Ndërsa deficiti për vitin 2024 pritet të jetë 91.8 milionë EUR, apo rreth 0.9% e BPV-së, për të vazhduar me suficit prej 0.5% e GDP gjatë vitit 2025. Bilanci i shfrytëzueshëm bankar pritet të jetë 3.4% e BPV-së në 2024 dhe 4.6% në 2025.

Siç shihet vlerësimet tona sugjerojnë për një kthim në kufirin bazë të deficitit, dhe për më shumë kalim në suficit brenda një periudhe afatmesme.

2.2.3. Niveli i borxhit shtetëror, zhvillimet dhe perspektive për vitet në vijim

Borxhi i përgjithshëm shtetëror në fund të vitit 2021 është 1,682.89 milionë euro, prej të cilave 1,106.14 milionë janë borxh i brendshëm, dhe 576.75 milionë janë borxh ndërkombëtar, siç është prezantuar në tabelën e mëposhtme. Portofoli i borxhit në fund të vitit 2021 përmbante dy garanci

shtetërore në vlerën 30.63 milionë euro dhe nuk kishte borxh komunal dhe as garanci komunale të emetuara.

Tabela 3: Borxhi i Përgjithshëm

<i>mln Eur</i>	2017	2018	2019	2020	2021
Borxhi Ndërkombëtar	422.15	416.43	409.10	525.80	576.75
Borxhi i Brendshëm	574.27	676.62	791.94	961.90	1,106.14
Borxhi i Përgjithshëm	996.42	1,093.05	1,201.04	1,487.69	1,682.89
Garancitë Shtetërore	44.00	43.70	42.68	31.65	30.63
Borxhi si % e BPV-së	16.37%	16.90%	17.51%	22.44%	21.92%
BPV	6,356.46	6,671.52	7,056.17	6,771.60	7,816.58

Shënim: Vlerat e BPV-së për vitet 2017-2020 janë marrë nga faqja zyrtare e Agjencionit të Statistikave të Kosovës, për vitin 2021 është marrë nga të dhënat preliminare të ASK-së.

*Raporti Borxh/BPV është rishikuar retroaktiv si rezultat i të dhënave të rishikuara të BPV nga ASK të publikuara me datë 17.09.2021 në faqen zyrtare të ASK-së.

Borxhi i brendshëm ka një pjesëmarrje prej 65.7% në portofolin e borxhit të përgjithshëm dhe përbëhet nga instrumente të borxhit me maturitet prej 12 muaj deri në 10 vite. Përmes letrave me vlerë, Qeveria e Kosovës ka huazuar fonde me kushte të favorshme, të cilat janë përdorë për mbështetje buxhetore duke kontribuar në zhvillimin e tregut të brendshëm të letrave me vlerë. Krahas emetimeve nga planifikimi i rregullt, gjatë vitit 2021 për herë të parë është emtuar edhe Bono e Diasporës në vlerë prej 10.4 milionë Euro, me maturitet 3 dhe 5 vite, në pajtueshmëri me Ligjin për Borxhin Publik dhe Programin e Borxhit Shtetëror 2022-2024. Parashihet që deri në fund të vitit 2022, borxhi i brendshëm të arrijë në 1,226.1 milionë euro apo rreth 14% e BPV-së. Nga ana tjetër, borxhi ndërkombëtar ka një pjesëmarrje prej 34.3% në portofolin e borxhit të përgjithshëm dhe përbëhet nga borxhi i trashëguar, kreditë për mbështetje buxhetore nga FMN dhe BE, si dhe kreditë për financimin e projekteve specifike nga ANZh, BERZh, BEI, BZhKE, KfW e kreditorë të tjerë me pjesëmarrje më të vogël. Deri më tani borxhi ndërkombëtar ka qenë kryesisht koncesionar ku pjesa më e madhe e kredive janë financime me kushte të buta nga institucionet financiare ndërkombëtare. Sektorët që kanë përfituar më së shumti nga huamarrja ndërkombëtare janë: infrastruktura rrugore, furnizimi me ujë, trajtimi i ujërave të zeza, arsimit, shëndetësia dhe bujqësia. Gjatë vitit 2020 dhe 2021 një pjesë e konsiderueshme e borxhit është kontraktuar për të zbutur efektet e pandemisë COVID-19. Kështu, me qëllim të adresimit të nevojave emergjente dhe pastaj të rimëkëmbjes gjatë vitit 2020 dhe 2021, Qeveria e Kosovës ka hyrë në një sërë marrëveshesh financiare me IFN-të, të orientuara kryesisht në shëndetësi dhe ekonomi. Deri në fund të vitit 2022, stoku i borxhit ndërkombëtar parashihet rreth 10% të BPV-së.

Tabela në vijim pasqyron gjendjen aktuale të portofolit të borxhit ndërkombëtar përfshirë borxhin e zotuar - të padisbursuar (që nënkupton borxhin që rrjedh nga marrëveshjet financiarë që janë ratifikuar në Kuvend, por që nuk kanë filluar të disbursohen).


Tabela 4: Borxhi ndërkombëtar përfshirë borxhin e zotuar e të padisbursuar sipas 31.03.2022

Kreditori	Borxhi i Ratifikuar Aktual (A)	Borxhi i Disbursuar (B)	Borxhi i Padisbursuar (C=A-B)	Borxhi i pakthyer (D=B-E)	Kthimi i Borxhit (E)	Borxhi i padisbursuar si % e BPV	Borxhi i disbursuar (pakthyer) % e BPV
IBRD	381.21	381.21	0.00	107.30	273.91	0.00%	1.28%
IMF	339.34	339.34	0.00	51.43	284.84	0.00%	0.61%
IDA	274.08	169.92	104.17	165.33	6.40	1.25%	1.97%
IsDB	15.32	15.32*	0.00	14.91	0.42	0.00%	0.18%
OFID	18.02	3.90	14.12	0.55	3.41	0.17%	0.01%
SFD	14.42	4.92	9.50	1.71	3.32	0.11%	0.02%
EBRD	179.90	24.60	155.30	19.75	4.85	1.85%	0.23%
EIB	173.00	7.00	166.00	7.00	0.00	1.98%	0.08%
UniCredit	24.98	23.80	1.18	23.27	0.53	0.01%	0.28%
RBI Austria	5.13	5.13	0.00	5.13	0.00	0.00%	0.06%
CEB	60.00	35.00	25.00	35.00	0.00	0.30%	0.42%
BE	100.00	100.00	0.00	100.00	0.00	0.00%	1.19%
NATIXIS Franca	66.00	0.00	66.00	0.00	0.00	0.79%	0.00%
KfW	70.93	68.43	2.50	29.93	38.50	0.03%	0.36%
Borxhi Ndërkomb-ëtar	1,722.34	1,178.55	543.78	561.29	616.18	6.47%	6.68%

Shënim: Borxhi i ratifikuar aktual nënkupton shumën e përgjithshme⁷ të të gjitha marrëveshjeve financiare ndërkombëtare për kredi, të cilat janë të ratifikuara⁸ nga Kuvendi i Republikës së Kosovës.

Niveli i borxhit të përgjithshëm i Qeverisë së Kosovës gradualisht ka filluar të rritet viteve të fundit siç vërehet edhe nga grafiku më poshtë. Kjo vihet re sidomos gjatë vitit 2020 dhe 2021 si rezultat i nevojave emergjente për financim të shkaktuara nga pandemia COVID-19. Deri në fund të vitit 2022, borxhi i përgjithshëm parashihet të arrijë në 2,112.07 milionë Eur, që paraqet rreth 24% të BPV-së.

Grafiku 8: Trendi i Borxhit të Përgjithshëm dhe si përqindje e BPV-së



⁷ Me përjashtim të projekt/kredive të cilat kanë përfunduar pa u shpenzuar në tërësi, për këto raste pjesa e pashpenzuar e zvogëlon shumën e ratifikuar të kredisë.

⁸ Me përjashtim të borxhit të trashëguar dhe marrëveshjeve me IMF (FMN-në) të cilat nuk janë të ratifikuara si marrëveshje të veçanta, por përmes Ligjit të Buxhetit.

Për shkak të kushteve të favorshme për huazim, në periudhën afat-mesme, Qeveria do të vazhdojë të orientohet lehtësisht drejt huamarrjes ndërkombëtare. Në këtë drejtim, do të vazhdojë bashkëpunimi dhe komunikimi me institucionet financiare ndërkombëtare, në veçanti me ato zhvillimore, për të prezantuar projektet me prioritet për ekonominë e vendit dhe rrjedhimisht, për ti financuar këto projekte përmes kredive me kushte preferenciale.

Financimi i deficitit të buxhetit të Kosovës do të bëhet gjithnjë në konsistencë të plotë me nivelin e deficitit të paraqitur në Ligjin e Buxhetit si dhe nevojën për financimin e bilancit bankar. Në çdo rast, MFPT do të sigurohet që shumica e cila huazohet për nevojat e Qeverisë do të jetë me kosto më të ulët të mundshme dhe gjithnjë brenda kufijve të pranueshëm të ekspozimit ndaj rreziqeve të tregut. Për të garantuar menaxhim të mirëfilltë dhe strategjik të borxhit, MFPT përgatit çdo vit Programin e Borxhit Shtetëror, që është komplementar dhe në linjë me Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve. Për sa i përket borxhit publik për periudhën që mbulon KASH, janë marrë për bazë huazimet për mbështetje buxhetore dhe ato për financimin e projekteve specifike (marrëveshjet e nënshkruara dhe ato në pritje për negociim). Për më tepër, skenari i parashikimeve ekonomike e fiskale merr për bazë edhe emetimin e letrave me vlerë, për financimin e deficitit. Dhe duke marrë parasysh edhe kthimet për periudhën afatmesme, pritet një rritje graduale e stokut të borxhit të përgjithshëm, por totali i borxhit në raport me BPV-në do të mbetet në nivele të pranuar dhe të qëndrueshme për periudhën 2023-2025.

2.3. RREZIQET AFATMESME 2023-2025

Korniza bazë e paraqitur në KASH përcillet, si çdo vit, me rreziqe, të cilat mund ta ndryshojnë pasqyrën makro fiskale negativisht, varësisht nga probabiliteti i materializimit dhe intensiteti me të cilin këto rreziqe realizohen. Për hir të planifikimit të kujdesshëm dhe në interes të transparencës, pjesa e Kornizës Makro- Fiskale do të marrë në konsideratë edhe këto rreziqe, detajet e të cilave do të ofrohen në vijim. Krahasuar me vitin e kaluar, rreziqet vazhdojnë të jenë të larta, kryesisht ato me origjinë nga ambienti i jashtëm.

Ambienti i jashtëm vazhdon të paraqesë një rrezik domethënës gjatë vitit 2022 dhe në periudhën afatmesme.

- i) Efektet e përhapjes së krizës së Ukrainës** do të ndikojnë negativisht ekonominë e Kosovës. Së pari, çmime më të larta të energjisë kombinuar me kapacitete të vjetruara të prodhimit të energjisë mund të ushtrojnë trysni të shtuar mbi financat publike, ngjashëm me atë që ndodhi në fund të vitit 2021 apo fillimin e vitit 2022. Së dyti, edhe pse marrëdhëniet tregtare me vendet e përfshira në konflikt janë neglizhente, Kosova, si një vend që importon produkte ushqimore dhe bujqësore dhe energji, është ndjeshëm e ekspozuar nga rritja e çmimeve globale të këtyre mallrave. Së treti, tejzgjatja apo ashpërsimi i mëtejshëm i luftës në Ukrainë mund të prekë vendet ku jetojnë emigrantët kosovarë, duke përkeqësuar situatën e tyre financiare, e cila më

tej mund të reflektohet në ngadalësim të remitançave, eksportit të shërbimeve të udhëtimit, apo investimet e huaja direkte.

ii) Masat për të adresuar inflacionin e lartë në Eurozonë

Një prej sfidave kryesore në të gjitha vendet pothuajse ka qenë vendimarrja e politikës monetare në mënyrë të tillë që adreson presionet inflacioniste por pa penguar hovin e rimëkëmbjes ekonomike të pritur gjatë vitit 2022 dhe në vitet pasardhëse. Është e mundshme që gjatë vitit 2022, brenda vendeve të Eurozonës (ku gjenden një pjesë e madhe e partnerëve tanë tregtarë dhe emigrantëve) të ndërmerren masa shtrënguese të kushteve monetare (rritje e normës bazë së interesit apo ngadalësimi të programit të blerjes së asetëve) për të adresuar rritjen e vazhdueshme të çmimeve. Këto masa do të ndikojnë negativisht në aktivitetin ekonomik të këtyre vendeve, gjë e cila potencialisht mund të përçohet edhe tek ekonomia jonë.

iii) Shfaqja e varianteve të reja të virusit Covid-19

Edhe pse pandemia është duke u zbehur në nivel global, ekziston ende rreziku i shfaqjeve të reja të virusit, që janë rezistente ndaj vaksinave dhe mund të kërkojnë rivendosjen e masave kufizuese. Kjo do të frenonte udhëtimin dhe transportin, duke rritur kështu më tej presionet ekzistuese inflacioniste, që do të përktheheshin në ngadalësim të rritjes ekonomike në vendet e tjera dhe në Kosovë. Megjithatë, ky rrezik është ndjeshëm më i ulët se në vitin paraardhës.

Mjedisi i brendshëm (vendor) do të vazhdojë të gjenerojë rreziqe gjatë vitit 2022 e tutje (në periudhën afatmesme 2023- 2025), edhe pse në nivel më ulët se në vitin paraprak.

i) Kriza e brendshme e energjisë e shkaktuar nga rritja e theksuar e konsumit të energjisë në kushtet e kapaciteteve të vjetëruara të prodhimit të brendshëm të energjisë mundet të çojë në përsëritjen e situatës që ndodhi në fundin e vitit 2021 dhe të rrisë ndjeshëm kërkesën për import të energjisë. Ky skenar do të ndikonte negativisht çmimet e prodhimit dhe rrjedhimisht të konsumit dhe do të kërkonte një mbështetje më të madhe financiare nga ana e qeverisë.

ii) Rreziku nga detyrimet kontigjente që rrjedhin nga kreditë e nënhuazuara dhe garancitë shtetërore

Në portofolin e borxhit shtetëror të Kosovës, burim potencial i këtij rreziku janë kreditë e garantuara të sektorit publik dhe kreditë ndërkombëtare të nën-huazuara tek kompanitë që ofrojnë shërbime esenciale publike. Kreditë e garantuara në fund të vitit 2021 janë në shumën 30.6 milionë euro dhe përbëjnë 1.8% të borxhit të përgjithshëm. Pjesa e portofolit që mund të kërkojë monitorim më të afërt janë garancia shtetërore ndaj Trafikut Urban dhe kreditë e nënhuazuara ndaj kompanive që ofrojnë shërbime publike. Analizat e rreziqeve financiare dhe ekonomike kanë ngritur shqetësimet lidhur me performancën e dobët të kompanive publike. Një devijim më i thellë i rezultateve financiare të këtyre kompanive mund shkaktojë barrë për Qeverinë në afat të mesëm si për subvencionimin e shërbimeve që ato ofrojnë ashtu edhe për marrjen përsipër të obligimeve financiare ndaj kreditorëve të jashtëm.

Për të kufizuar ndikimin e rrezikut nga detyrimet kontigjente, do të vazhdojë zbatimi i një sërë masash si: (a) monitorimi i pozitës financiare të përfituesve (b) vlerësimi fillestar i mundësisë

së materializimit të detyrimeve kontigjente ekzistuese. Varësisht nga vlerësimet për humbjet e supozuara, do të përcaktohen edhe tarifat e garancisë të aplikueshme sipas Ligjit për Borxhin Publik. Si masë për menaxhimin e këtyre rreziqeve shërben edhe përfshirja e garancive në shumën e borxhit të përgjithshëm, në kalkulimin e kufirit të borxhit ndaj BPV-së. Në plan afatmesëm si masë shtesë që duhet të ndërmerret në funksion të menaxhimit të këtyre rreziqeve është përfshirja e një pozicioni në Ligjin e Buxhetit si ndarje buxhetore për humbjet nga garancitë në rast të dështimit në shlyerjen e tyre nga huamarrësi kryesor.

iii) Nën-ekzekutimi i shpenzimeve kapitale

Një rritje e shpenzimeve kapitale publike për të trajtuar pengesat strukturore është shtyllë e strategjisë së Qeverisë për të mbështetur një mjedis që nxit rritjen ekonomike. Në vitet e fundit, pavarësisht përmirësimeve, nën-ekzekutimi i shpenzimeve kapitale tejkalonte 5.0% të shumave totale të buxhetuara.

Megjithatë, nën-ekzekutimi i projekteve kapitale mbi supozimet e skenarit bazë, sidomos për projektet e huamarrjes, llogaritet si një rrezik i mundshëm për uljen e parashikimeve të rritjes ekonomike dhe rrjedhimisht të të hyrave buxhetore. Kjo pasi që ekzekutimi i projekteve kapitale të financuara nga borxhi koncesionar, pas nënshkrimit të marrëveshjeve financiare, mbetet ende sfidues për organizatat buxhetore. Kjo vjen kryesisht si rezultat i një vendimmarrje më të nxituar për kredi, përkatësisht pa u siguruar se ekzistojnë të gjitha parakushtet, apo janë bërë përgatitjet e duhura, studimet dhe analizat e hollësishme (përfshirë analizat e tregut), që të sigurohet fillimi i menjëhershëm i implementimit të projekteve pas ratifikimit të kredive dhe që fondet nga kreditë të shfrytëzohen në mënyrë sa më efektive.

Një faktor tjetër i rëndësishëm që mund të ndikojë në aftësinë e qeverisë për të mbajtur nivelin e projektuar të shpenzimeve kapitale në horizontin afatmesëm është rritja e presioneve për transfere sociale dhe të energjisë për të adresuar pasojat socio-ekonomike të situatës aktuale të rritjes së theksuar të çmimeve.

Megjithatë, rreziku që vjen nga nën-ekzekutimi i shpenzimeve kapitale është ndjeshëm më i ulët se në projeksionet e mëparshme duke pasur parasysh alokimin në buxhet për detyrimet e shpronësimeve, që pritet të nxisë absorbimin e projekteve të financuara nga donatorët.

iv) Presioni për rritjen e shpenzimit për transfere

Performanca e mirë fiskale gjatë vitit 2021 dhe tremujorit të parë të vitit 2022 ofron mundësi të reja për shpenzime shtesë, nisma të reja subvencionuese apo nisma të tjera mbështetëse. Kujdes i shtuar nevojitet në analizimin e secilës skemë, duke u fokusuar në dy çështje specifike: kthimin ekonomik apo çështjet sociale që i ndihmon apo zgjidh ajo skemë, si dhe përpilimi i kriterëve në mënyrë që të përmirësojë targetimin. Gjithsesi, duhet pasur kujdes që, përkundër presionit për rritje të shpenzimeve rrjedhëse në kushtet e rritjes së theksuar të çmimeve, fokus i veçantë t'i jepet përsheptimit të dinamikës së ekzekutimit të investimeve kapitale për të mbështetur rimëkëmbjen dhe rritjen e mëtejshme ekonomike, duke pasur parasysh që pjesa më e madhe e

krizës së shkaktuar nga pandemia tanimë është drejt shuarjes, dhe në bazë të dhënave të aktivitetit ekonomik humbjet konsiderohen të jenë të rikuperuara.

v) Rreziku fiskal nga mbledhja e të hyrave

Një rrezik i rëndësishëm fiskal i lidhur me të hyrat tatimore është se a mund të mblidhen tatimet e arkëtueshme apo jo. Sipas raportit vjetor financiar për vitin 2021, llogaritë e arkëtueshme të pa mbledhura arrinin në 773 milionë euro, 560 prej të cilave lidheshin me nivelin e qeverisë qendrore dhe 212 milionë euro me nivelin e qeverisë lokale. Këto 773 milionë euro të llogarive të arkëtueshme të pa mbledhura paraqesin një rritje prej rreth 78 milionë euro krahasuar me vitin paraardhës. Rritja mesatare vjetore për periudhën 2018-2021 arrin në 8.2%.


vi) Rreziqet Fiskale nga Ndërmarrjet Publike

Pasqyrë e Sektorit të Ndërmarrjeve Publike

Në Republikën e Kosovës ekzistojnë dy lloje të Ndërmarrjeve Publike (NP): ato të cilat janë në pronësi të qeverisjes qendrore dhe ato në pronësi të qeverisjes lokale. Në nivelin e qeverisjes qendrore sektori i NP përfshinë 19 ndërmarrje, nga të cilat 17 mbikëqyren nga Ministria e Ekonomisë; Kuvendi mbikëqyr KOSTT-in, ndërsa Aeroporti i Gjakovës mbikëqyret nga Forca e Sigurisë së Kosovës (FSK). Rreth 80 përqind e Trepçës është në pronësi të shtetit, ndërsa 20 përqind në pronësi të punëtorëve. Këto NP funksionojnë në disa sektorë të ndryshëm, sikurse: energji, transport, furnizim me ujë, telekomunikim dhe sektori i minierave. Analiza e mëposhtme është bërë bazuar në të dhënat financiare që u përkasin 17 NP të mbikëqyrura nga Ministria e Ekonomisë.

Sektori i NP-ve është relativisht i vogël në krahasim me shtetet e Bashkimit Evropian (*shih Grafikon 9*)

Grafiku 9: Detyrimet e ndërmarrjeve publike si përqindje e BPV-së (2020) (Eurostat, 2021)



Bazuar në raportet tremujore të dorëzuara gjatë vitit 2021 nga 16 Ndërmarrjet Publike, në fund të vitit 2021 asetet e NP-ve arritën në 14.4 përqind të BPV-së, një ulje prej 2 pikë përqindjeje nga viti 2020 (niveli i njëjtë prej 14.4 përqind të BPV-së në vitin 2019), gjithashtu edhe

detyrimet tregojnë ulje, prej 6.9 përqind të BPV-së, ulje prej 0.7 pikë përqindje nga viti 2020. Të ardhurat totale të tyre kanë mbetur konstante në vlerën 4.5 për qind të BPV-së.

Në total, sektori i NP-ve gjeneroi një fitim prej 87.4 milionë euro në vitin 2021, përmirësim i dukshëm nga fitimi prej 19.0 milionë euro që ishte në vitin 2020, kryesisht si rezultat i rritjes së ndjeshme të fitimit të KEK-ut. Më shumë se gjysma e NP-ve gjeneruan fitim. Kthimi agregat në ekuitet u përmirësua nga 3 për qind në vitin 2020 në 13 për qind në vitin 2021. Likuiditeti i sektorit është përmirësuar; Në total, NP-të kanë asetë të mjaftueshme afatshkurtra për të përmbushur obligimet afatshkurtra. Mesatarisht, rreth 48 përqind e financimit të NP-ve vjen nga borxhi, rritje pak më e lartë në krahasim me vitin 2020 (47 përqind). Rritja e profitit gjatë vitit 2021 do të thotë që sektori i NP-ve tani është në pozicion të servisoj borxhin agregat nga të ardhurat e veta.

Tabela 5: Pasqyrat financiare të përmbledhura për sektorin e NP-ve (miliona euro)

	2017	2018	2019	2021 (paaudituar)	2021
Të hyrat e përgjithshme	286.5	298.7	305.8	306.1	353.9
<i>% e BPV-së</i>	4.5	4.5	4.3	4.5	4.5
EBITDA	76.7	98.4	102.9	115.1	186.3
<i>% e BPV-së</i>	1.2	1.5	1.5	1.7	2.4
Profiti Neto	-33.4	7.3	-4.9	19.0	87.4
<i>% e BPV-së</i>	-0.5	0.1	-0.1	0.3	1.1
Asetet totale	996.9	978.5	1,015.7	1,110.4	1,123.2
<i>% e BPV-së</i>	15.7	14.7	14.4	16.4	14.4
Totali i asetëve rrjedhëse	256.8	226.1	235.9	258.5	397.3
<i>% e BPV-së</i>	4.0	3.4	3.3	3.8	5.1
Detyrimet totale	517.0	513.1	529.9	516.6	539.9
<i>% e BPV-së</i>	8.1	7.7	7.5	7.6	6.9
Totali i detyrimeve rrjedhëse	116.8	123.5	166.4	183.3	165.1
<i>% e BPV-së</i>	1.8	1.9	2.4	2.7	2.1
Ekuiteti total	480.8	464.0	485.8	593.8	594.3
<i>% e BPV-së</i>	7.6	7.0	6.9	8.8	7.6

Vlerësimi i rrezikut fiskal të NP-ve

Rreziqet fiskale janë faktorë që mund të shkaktojnë devijime në rezultatet e parashikuara fiskale. NP-të mund të ndikojnë drejtpërdrejt në treguesit fiskalë, për shembull, kur ofrohen subvencione, kredi ose injeksione kapitale (ekuitet) më të larta se sa pritej; ka një qartësim të detyrimeve kontingjente (të mundshme); ose të hyrave nga tatimet dhe dividendët më të ulëta se sa pritej. NP-të gjithashtu mund të kenë ndikim indirekt në treguesit fiskalë përmes ndikimit të aktiviteteve të tyre në rritjen ekonomike. Materializimi i rreziqeve në nivel të kompanive ka më shumë gjasa të shkaktojë rreziqe fiskale kur NP-të nuk janë të kapitalizuara mjaftueshëm, janë në humbje dhe kanë nivel të ulët të likuiditetit.


Përveç mbështetjes së paplanifikuar fiskale për NP-të gjatë periudhës së pandemisë, rreziqe të tjera fiskale të lidhura me NP-të janë materializuar. Borxhet tatimore të papaguara të NP-ve janë

akumuluar. Ka edhe dividenda të papaguara nga NP-të për qeverinë. Infrastruktura dhe pajisjet e NP-ve janë të vjetëruara dhe të zhvlerësuara. Ato duhet të zëvendësohen, megjithatë disa NP nuk janë në gjendje t'i përballojnë këto investime. Për NP-të si kompanitë hekurudhore dhe Posta e Kosovës, tarifat që ata kanë vendosur, të cilat janë të rregulluara, janë të pamjaftueshme për të mbuluar shpenzimet e tyre. Disa NP, veçanërisht Telekom i Kosovës, po përjeton vështirësi aq të rënda financiare sa që mund të nevojitet mbështetja e qeverisë për të siguruar mbijetesën e tyre.

Vlerësimi i rrezikut fiskal për 16 NP është përpiluar në bazë të raporteve tremujore të dorëzuara nga këto NP gjatë vitit 2021. Për vitin 2020, vlerësimi i rrezikut fiskal është bazuar në rezultatet vjetore të audituara (pasqyrat financiare të paaudituar) për vitin 2020. Për secilën kompani, janë kalkuluar gjashtë treguesit kryesorë financiarë: i) raporti i mbulimit të kostos; ii) kthimi në ekuitet; iii) raporti aktual, iv) ditët e llogarive të arkëtueshme; v) raporti i borxhit ndaj aseteve; dhe vi) raportin e borxhit ndaj EBITDA (firimi para interesit, taksave, zhvlerësimit dhe amortizimit). Këta tregues janë përzgjedhur pasi ofrojnë një tregues të përgjithshëm të profitabilitetit, likuiditetit dhe solvencës të secilës NP. Secilit raport i është caktuar vlerësimi i rrezikut, bazuar në normat ndërkombëtare. Vlerësimi i përgjithshëm i rrezikut është llogaritur si mesatarja aritmetike e vlerësimeve të rrezikut për raportet individuale. Vlerësimet e rrezikut të NP-ve variojnë nga Kategoria 1 – vlerësimi më i ulët i rrezikut – deri te Kategoria 5 – vlerësimi më i lartë i rrezikut. Metodologjia do të vazhdojë të përmirësohet dhe/ose të ndryshohet bazuar në kontekstin dhe disponueshmërinë e të dhënave.

Nga 16 Ndërmarrje Publike, shtatë NP u klasifikuan nën kategorinë 4, gjashtë në kategorinë 3 dhe tre nën kategorinë 2. Në krahasim me vitin 2020 kishte përmirësim në vlerësimin e rrezikut fiskal duke, ku një NP u klasifikua nën kategorinë 5, tetë nën kategorinë 4 dhe tetë nën kategorinë 3. Vlerësimi i rrezikut tregon se, në përgjithësi, shumica e NP-ve kanë një pozicion të shëndoshë likuiditeti, por disa prej kompanive po hasin vështirësi në mbledhjen e borxheve nga debitorët e tyre. Shumë NP kanë nivele të larta borxhi kur merret parasysh aftësia e tyre (e pamjaftueshme) për të gjeneruar fitime për të përmbushur detyrimet e tyre.

Grafiku 10: Pjesëmarrja e detyrimeve totale sipas NP-ve (përqindja e BPV-së)



Për të adresuar disa nga problemet e mësipërme, Qeveria është në proces të ndryshimit të Ligjit për NP-të, i cili do të krijoj kornizën për funksionimin e sektorit të NP-ve, me qëllim të përafritimit të qeverisjes së korporatave të NP-ve me standardet e njohura ndërkombëtare, përmirësimin e performancës të NP-ve, të rrisin vlerën e aseteve të tyre dhe të ofrojnë shërbime cilësore për publikun. Ekzistojnë gjithashtu një sërë masash të mëtejshme që po shqyrtohen për të adresuar problemet ekzistuese të NP-ve, si: stabilizimi i bordeve dhe menaxhimi i NP-ve përmes një procesi transparent të bazuar në merita, ndër të tjera, ristrukturimi, privatizimi apo edhe likuidimi.

vii) Detyrimet e papaguara

Neni 39 i Ligjit për MFP përcakton se detyrime të papaguara janë pagesat që kanë kaluar afatin e pagesës mbi 30 ditë. Raporti vjetor financiar i Buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2021 përfshin një aneks për detyrimet e papaguara të cilat përfshijnë zotimet financiare, llogaritë e pagueshme dhe detyrimet e papaguara, duke e bërë ndarjen e këtyre shumave në dy kategori sipas vjetërsisë: i) më pak se 30 ditë; dhe ii) më shumë se 30 ditë.

Tabela 5 paraqet detyrimet e papaguara (>30 ditë) për tre vite sipas nivelit qendror dhe lokal. Gjatë tre viteve të fundit vihet re ulje e detyrimeve të papaguara në total, me uljen më të madhe të reflektuar në vitin 2021 në 54.6 milionë Euro nga 95.9 milionë Euro në vitin 2020, kryesisht si rezultat i uljes në detyrimet e papaguara në nivelin qendror. Në vitin 2021, në nivelin qendror pjesa më e madhe e detyrimeve të papaguara (> 30 ditë) i atribuohet Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, me rreth 54.0% e të gjitha detyrimeve brenda këtij niveli, edhe pse niveli i detyrime për këtë organizatë buxhetore ka shënuar rënie të ndjeshme në tre vitet e fundit. Po ashtu, vërehet se Universiteti i Prishtinës nuk kishte asnjë detyrim të papaguar në vitin 2019, mirëpo ka filluar të ketë detyrime të papaguara në vitet 2020 dhe 2021.

Në nivelin lokal, në vitin 2021 detyrimet e papaguara kanë shënuar rritje me rreth me 5 milionë Euro krahasuar me vitin 2020, kryesisht si rezultat i rritjes së detyrimeve në komunën e Ferizajit. Në vitin 2021, komunat e Gjilanit dhe Ferizajit janë dy komunat, të cilat përbëjnë pjesën më të madhe të detyrimeve të papaguara (> 30 ditë).

Në vitin 2020, detyrimet e papaguara përbënin 2.0% të shpenzimeve aktuale të organizatave buxhetore në nivelin qendror (një ulje nga shifra 5.37% në 2020) dhe rreth 3.75% në nivelin lokal (një rritje nga 2.75% në 2020), që së bashku përbëjnë 2.42% të shpenzimeve të përgjithshme buxhetore (një ulje nga 4.73% sa ishte në 2020).

Tabela 6: Detyrimet e papaguara

	2019	2020	2021	2021/ Shpenzimi i përgjithshëm i OB-ve
Qeveria qendrore (mil Eur)	85.6	80.9	34.3	2.0%
<i>Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës</i>	<i>70.1</i>	<i>53.5</i>	<i>18.8</i>	<i>13.0%</i>
<i>Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural</i>	<i>0.7</i>	<i>10.4</i>	<i>7.6</i>	<i>10.2%</i>
<i>Universiteti i Prishtinës</i>	<i>-</i>	<i>1.9</i>	<i>2.5</i>	<i>8.8%</i>
<i>Fondi i Sigurimeve Shëndetësore</i>	<i>9.8</i>	<i>6.0</i>	<i>1.2</i>	<i>11.8%</i>

Qeveria lokale (mil Eur)	15.8	15.0	20.3	3.8%
<i>Gjilan</i>	9.8	9.8	9.5	33.7%
<i>Ferizaj</i>	0.6	0.7	5.7	16.1%
<i>Mitrovicë</i>	0.8	0.9	1.6	7.2%
<i>Prishtinë</i>	0.8	0.6	0.8	1.0%
Gjithsej (mil euro): Qendrore + Lokale	101.4	95.9	54.6	2.4%
Gjithsej pagesa/gjithsej shpenzime buxhetore %	4.9%	4.3%	2.4%	

viii) Rreziqet fiskale nga rastet gjyqësore

Një tregues i rëndësishëm i rreziqeve fiskale nga rastet gjyqësore është ecuria e pagesave vjetore të qeverisë për vendimet e gjykatave. Tabela 6 paraqet pagesat sipas vendimeve të gjykatave gjatë tri viteve të fundit, si në nivelin qendror ashtu edhe në atë lokal. Në përgjithësi, pagesat për vendimet gjyqësore nuk përbëjnë më shumë se 2.3% të shpenzimeve të përgjithshme të buxhetit, edhe pse tregojnë një trend në rritje përgjatë viteve, si në nivel lokal ashtu edhe atë qendror. Pagesat për vendimet e gjykatave në nivelin qendror kryesisht i atribuohen Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (37.4% e pagesave të nivelit qendror) dhe Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve (16.3% e pagesave të nivelit qendror). Në nivel lokal, komunat Ferizaj, Prizren, Mitrovicë dhe Prishtinë përbëjnë pjesën më të madhe të këtyre pagesave. Në vitin 2021, pagesat e bazuara në vendimet e gjykatave përbënin 1.17% të shpenzimeve aktuale të organizatave buxhetore në nivelin qendror dhe rreth 5.89% në nivelin lokal, që së bashku përbëjnë 2.30% të shpenzimeve të përgjithshme buxhetore. Për të pasur një pasqyrë më të plotë të rreziqeve fiskale që burojnë nga kostot e rasteve gjyqësore, do të duhet të dihet sa janë të mëdha kostot që do të mund të dalin nga rastet që janë në proces e sipër në gjykatë.

Tabela 7: Pagesat bazuar në vendimet gjyqësore (milion Euro)

	2019	2020	2021	2021/Shpenzimi i përgjithshëm i OB-ve
Qeveria qendrore (mil Eur)	10.5	15.3	20.0	1.2%
<i>Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës</i>	8.7%	2.9%	37.4%	5.2%
<i>Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve</i>	27.5%	21.6%	16.3%	0.5%
<i>Ministria e Punëve të Brendshme</i>	2.5%	9.5%	14.5%	1.9%
<i>Shërbimi Spitalor Klinik Universitar i Kosovës</i>	11.6%	6.9%	13.3%	2.0%
<i>Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit</i>	4.0%	6.8%	4.3%	2.6%
Qeveria lokale (mil Eur)	15.3	15.3	31.9	5.9%
<i>Ferizaj</i>	29.7%	9.5%	22.2%	20.2%
<i>Prizren</i>	4.3%	17.6%	15.6%	10.0%
<i>Mitrovicë</i>	9.7%	12.0%	13.6%	19.4%
<i>Prishtinë</i>	8.0%	14.1%	7.3%	2.9%
<i>Gjakovë</i>	5.5%	1.5%	6.3%	7.4%
Gjithsej (mil euro): Qendrore + Lokale	25.8	30.7	51.9	2.3%
Gjithsej pagesa/gjithsej shpenzime buxhetore, %	1.2%	1.4%	2.3%	

ANEKS 1

Tabela 1. Parashikimet Fiskale

Përshkrimi	2019	2020	2021	2022 Rishiki	2023 Proj.	2024 Proj.	2025 Proj.
në miliona Euro							
1. GJITHSEJ TË HYRAT BUXHETORE [1]	1,888.2	1,722.2	2,200.9	2,430.4	2,676.6	2,864.0	3,047.7
1.1 Të Hyra Tatimore	1,662.0	1,507.0	1,947.9	2,168.9	2,392.2	2,561.5	2,735.2
Tatimet Direkte	292.3	267.2	342.2	392.6	435.5	467.3	499.0
Tatimi në të ardhurat e korporatave	94.6	85.3	113.9	136.2	164.8	176.9	188.9
Tatimi në të ardhura personale	165.6	158.0	189.5	212.7	223.2	241.4	259.4
Tatimi në pronë	27.3	22.7	36.3	41.0	44.6	45.9	47.4
Të tjera	4.8	1.3	2.4	2.7	2.9	3.1	3.3
Tatimet Indirekte	1,415.3	1,272.7	1,664.7	1,837.8	2,028.9	2,171.6	2,318.9
Tatimi mbi Vlerën e Shtuar	845.6	770.1	1,038.2	1,176.0	1,326.3	1,427.7	1,531.5
Vendore:	239.2	222.4	291.7	360.0	388.7	414.1	440.9
Kufitare:	606.4	547.8	746.5	816.0	937.6	1,013.6	1,090.5
Detyrimi Doganor	130.3	101.6	124.6	134.3	148.1	161.1	174.3
Akvizë	435.5	398.1	501.3	524.9	551.6	579.7	609.8
Të tjera	3.8	2.9	0.6	2.6	2.9	3.1	3.3
Rimbursimet tatimore	-45.5	-33.0	-58.9	-61.5	-72.3	-77.4	-82.7
1.2 Të Hyrat Jo-Tatimore	214.6	181.2	236.1	239.1	261.9	280.0	290.0
Taksa, ngarkesa dhe të tjera	171.5	146.2	186.8	188.5	209.4	225.8	236.1
<i>Taksa, ngarkesa dhe të tjera - Niveli Qendror</i>	121.4	103.5	129.6	142.1	155.4	169.1	176.6
<i>Taksa, ngarkesa dhe të tjera - Niveli Lokal</i>	50.0	42.7	57.3	46.4	54.0	56.7	59.5
Taksa koncesionare	11.1	2.7	17.0	17.0	19.0	21.0	21.0
Renta Minerare	29.4	29.4	19.2	30.2	30.2	30.1	30.1
Te hyrat nga dividenda	0.00	0.00	10.0	0.0	0.0	0.0	0.0
Të hyrat nga interesi	2.7	3.0	3.1	3.4	3.4	3.1	2.8
1.3 Grante	19.6	43.1	16.8	22.5	22.5	22.5	22.5
Grante për mbështetje buxhetore	11.5	34.0	0.0	10.5	10.5	10.5	10.5
Grante e përcaktuara të donatorëve	8.1	9.0	16.8	12.0	12.0	12.0	12.0
2. GJITHSEJ SHPENZIMET BUXHETORE[1]	2,093.4	2,234.9	2,299.3	2,898.2	2,974.8	3,113.3	3,203.1
2.1 Shpenzimet Rrjedhëse	1,538.8	1,827.7	1,837.6	2,140.8	2,123.2	2,132.3	2,146.1
Paga dhe shtesa	615.9	660.8	667.3	670.9	695.3	718.7	724.1
Mallra dhe Shërbime	295.6	299.2	327.7	403.8	475.7	468.2	482.6
Subvencione dhe transfere	627.3	867.8	842.6	1,045.0	947.4	940.5	934.7
Rezerva rrjedhëse	0.0	0.0	0.0	21.0	4.8	4.8	4.8
2.2 Shpenzimet Kapitale	531.2	379.7	419.8	704.4	792.8	916.7	986.8
Financimi nga: Buxheti i rregullt	391.9	261.2	399.8	570.1	650.1	760.3	773.3
Klauzola e investimeve	7.5	47.1	20.0	113.2	142.7	156.4	213.5
Fondet e likuidimit (AKP)	131.9	71.5	0.0	21.0	0.0	0.0	0.0
2.3 Interesi për Borxhin Publik	23.5	27.5	32.2	41.1	46.8	52.3	58.2
2.4 Grantet e Përcaktuara të Donatorve	6.9	9.2	9.7	12.0	12.0	12.0	12.0
3. Bilanci buxhetor (1-2)	-205.3	-512.7	-104.2	-466.5	-297.0	-248.3	-154.4
4. Shpenzimet e përjashtuara nga kufiri i rr. fiskale:	172.02	148.62	53.9	134.2	142.7	156.4	213.5
Shpenzimet nga pranimet e dedikuara nga AKP	2.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
Shpenzimet nga të hyrat komunale të bartura	30.7	30.1	33.8	0.0	0.0	0.0	0.0
Fondet e likuidimit nga AKP-ja	131.9	71.5	0.0	21.0	0.0	0.0	0.0
Shpenzimet e financuara nga klauzola e investimeve	7.5	47.1	20.0	113.2	142.7	156.4	213.5
5. BILANCI BUXHETOR, sipas kufirit të rr. fiskale (3+4)	-33.3	-364.1	-50.3	-332.3	-154.3	-91.8	59.1

A. Nevoja për financim	-205.3	-512.7	-104.2	-466.5	-297.0	-248.3	-154.4
B. Financimi i jashtëm (neto)	-11.0	139.5	53.4	359.9	241.3	185.7	190.4
C. Financimi i brendshëm (neto)	259.6	240.8	122.7	52.5	99.8	118.8	121.7
D. Ndryshimi në bilancin e pashpërndarë bankar (A+B+C)	43.4	-132.5	71.8	-54.1	44.1	56.2	157.7
E. Stoku i bilancit bankar (NETO)	362.0	235.5	312.7	258.7	302.8	359.0	516.7
F. Fondet me Qëllime Specifike (gjendja në fundvit)	96.3	94.5	129.5	129.5	129.5	129.5	129.5
G. Stoku i bilancit bankar në fundvit (BRUTO)	458.3	330.0	442.2	388.1	432.2	488.5	646.2
Memo 1:							
Te hyrat e arketuara nga ATK	504.3	466.9	597.7	711.6	779.6	835.5	892.5
Te hyrat e arketuara nga Dogana e Kosoves	1,179.6	1,050.4	1,376.7	1,477.8	1,640.2	1,757.5	1,878.0
Kthime tatimore	-45.5	-33.0	-58.9	-61.5	-72.3	-77.4	-82.7
Pranimet dhe daljet nga Grantet e Percaktuara te Donatoreve	8.1	9.0	16.8	12.0	12.0	12.0	12.0
BPV	7,056.2	6,771.6	7,816.6	8,754.5	9,621.3	10,407.8	11,156.4
Deficiti buxhetor (definicioni I rregullës fiskale si % e BPV-së)	-0.5%	-5.4%	-0.6%	-3.8%	-1.6%	-0.9%	0.5%
Bilanci bankar i shfrytezueshem si % e BPV-së	5.1%	3.5%	4.0%	3.0%	3.1%	3.4%	4.6%
Memo 2:							
Stoku i borxhit të brendshëm	791.9	961.9	1,106.1	1,226.1	1,356.1	1,486.1	1,616.1
Stoku i borxhit të jashtëm	409.1	525.8	576.7	925.9	1,156.2	1,331.7	1,512.8
Garancionet shtetërore	42.7	31.7	30.6	29.6	28.6	27.6	26.6
Borxhi i përgjithshëm si % e BPV-së	17.6%	22.4%	21.9%	24.9%	26.4%	27.3%	28.3%

Tabela 1.1 Financimi i Bilancit Buxhetor

Përshkrimi	2019	2020	2021	2022 Rishiki	2023 Proj.	2024 Proj.	2025 Proj.
në miliona Euro							
Te Hyrat Buxhetore	1,888.2	1,722.2	2,200.9	2,430.4	2,676.6	2,864.0	3,047.7
Shpenzimet Buxhetore	2,093.4	2,234.9	2,299.3	2,898.2	2,974.8	3,113.3	3,203.1
1. NEVOJA PËR FINANCIM	-205.3	-512.7	-104.2	-466.5	-297.0	-248.3	-154.4
2. Neto financimi nga burimet e jashtme për vitin	-11.0	139.5	53.4	359.9	241.3	185.7	190.4
2.1. Pranimet:	40.2	227.7	132.4	423.3	304.5	259.0	260.9
Financim Direkt Buxhetor - FMN, BB, BE, etj.	0.0	102.0	60.0	170.0	50.0	50.0	-
Nën-huazimet, bruto pranimet	12.1	11.2	13.5	59.9	46.1	27.2	24.3
Terheqjet nga kreditorët	4.2	3.5	5.5	49.1	35.1	17.0	15.0
Pranimet nga subjektet publike huazuese	7.9	7.7	8.0	10.8	11.0	10.2	9.3
Projekt-kreditë	28.1	114.5	58.9	193.5	208.4	181.8	236.5
06) Projekt-kreditë, klauzola e investimeve (fondi	7.5	47.1	20.0	113.2	142.7	156.4	213.5
04) Projekt-kreditë, trajtim brenda deficiti (fondi	20.6	67.4	38.8	80.3	65.6	25.4	23.1
2.2. Daljet:	51.2	88.2	79.0	63.4	63.2	73.3	70.5
Pagesa e kryegjesë së borxhit	51.2	88.2	79.0	63.4	63.2	73.3	70.5
3. Neto financimi nga burimet e brendshme për vitin	259.6	240.8	122.7	52.5	99.8	118.8	121.7
3.1. Pranimet:	526.4	455.3	322.3	361.6	396.2	415.1	389.3
Emetimet e reja të letrave me vlerë	115.3	170.0	144.2	120.0	130.0	130.0	130.0
Pranimet nga emetimet e letrave me vlerë për qëllime rifinancimi	244.6	200.0	162.0	204.8	250.3	269.1	243.3
Pranimet nga kthimi i kryegjesë së borxhit të NP-ve	10.9	11.4	11.4	11.4	11.4	11.5	11.5

Financimi i njehereshem nga likuidimi/privatizimi dhe të tjera	150.0	71.5	0.0	21.0	-	-	-
Pranimet e dedikuara nga AKP	1.0	0.0	-	-	-	-	-
Pranimet e dedikuara -tjera (ASHNA)	4.5	2.5	4.6	4.5	4.5	4.5	4.5
Ndryshimi nga stoku i fondeve me qellime specifike (kur FS2 dhe FS3 zvogelohen)	0.0	0.0	-	-	-	-	-
3.2. Daljet:	266.7	214.5	199.7	309.1	296.3	296.3	267.6
Kredidhënia për NP	0.0	0.0	-	40.0	-	-	-
Nen-huazimet, bruto daljet	17.0	11.7	14.3	59.9	46.1	27.2	24.3
Daljet per nen-huazim tek subjektet publike huazuese	8.5	3.5	5.5	49.1	35.1	17.0	15.0
Daljet per sherbim te borxhit tek kreditorët	8.5	8.2	8.8	10.8	11.0	10.2	9.3
<i>Interesi për nenhuazime</i>	2.0	1.5	1.3	1.3	1.2	1.1	1.0
Daljet nga emetimet e letrave me vlerë për qëllime rifinancimi	244.6	200.0	162.0	204.8	250.3	269.1	243.3
Daljet për anëtarim dhe rritje te kuotave në INF	-	-	-	4.5	-	-	-
Dalje për rritjen e fondeve me qellime specifike (FS2 dhe FS3 rriten)	5.1	2.8	23.4	-	-	-	-
4. NDRYSHIMI NË BILANCIN E PASHPËRNDARË BANKAR (1+2+3)	43.4	-132.5	71.8	-54.1	44.1	56.2	157.7
5. NETO BILANCI BANKAR FUNDVIT	362.0	235.5	312.7	258.7	302.8	359.0	516.7
Nga te cilat: Fondi për Likuiditet Emergjent	46.0	46.0	46.0	46.0	46.0	46.0	46.0
6. FONDET ME QELLIME SPECIFIKE, gjendja e stoqeve	96.3	94.5	129.5	129.5	129.5	129.5	129.5
Grantet e përcaktuara nga donatorët	8.9	9.8	15.8	15.8	15.8	15.8	15.8
Të hyrat vetanake të bartura - Niveli Qendror	5.7	1.8	1.4	1.4	1.4	1.4	1.4
Të hyrat vetanake të bartura - Niveli Lokal	49.5	56.0	79.4	79.4	79.4	79.4	79.4
Fondi zhvillimor në mirëbesim	6.8	7.1	7.4	7.4	7.4	7.4	7.4
Pranimet e dedikuara për bartje	0.8	0.1	0.5	0.5	0.5	0.5	0.5
Të tjera	17.5	15.9	19.8	19.8	19.8	19.8	19.8
Fondet e pashpenzuara nga huamarrja	7.0	3.9	5.1	5.1	5.1	5.1	5.1
7. BRUTO BILANCI BANKAR NE FUNDVIT	458.3	330.0	442.2	388.1	432.2	488.5	646.2
8. NDRYSHIMI NE BRUTO BILANCIN BANKAR	70.4	-128.3	112.2	-54.07	44.1	56.2	157.7
Memo:							
Stoku i borxhit të brendshëm	791.9	961.9	1106.1	1,226.1	1,356.1	1,486.1	1,616.1
Stoku i borxhit të jashtëm	409.1	525.8	576.7	925.9	1,156.2	1,331.7	1,512.8
Garancionet shtetërore	42.7	31.7	30.6	29.6	28.6	27.6	26.6
Shpenzimet e interesit si % e BPV-së	0.3%	0.4%	0.4%	0.5%	0.5%	0.5%	0.5%

Tabela 2 Indikatore kryesore ekonomike

Pershkrimi	2018	2019	2020	2021	2022 Proj.	2023 Proj.	2024 Proj.	2025 Proj.
Normat reale te rritjes (ne perqind)								
BPV	3.4%	4.8%	-5.3%	10.5%	5.7%	7.1%	6.2%	6.1%
Konsumi	4.7%	6.2%	2.4%	7.8%	0.4%	5.5%	4.3%	4.8%
Investimet	7.0%	-1.6%	-7.1%	10.3%	10.9%	8.9%	8.3%	6.2%
Eksporti	9.1%	7.6%	29.1%	78.2%	8.3%	8.2%	7.3%	7.8%
Importi	10.9%	4.5%	-6.1%	32.6%	2.2%	6.5%	5.6%	5.4%
Ndryshimet e çmimeve (në përqindje)								
IÇK	1.1%	2.7%	0.2%	3.3%	6.6%	2.5%	1.8%	1.2%

Deflatori	1.5%	1.0%	1.3%	4.9%	6.3%	2.8%	2.0%	1.1%
Bilanci i kursimeve/Investimeve(në % të BPV-së)								
Neto të ardhurat parësore nga jashtë	1.7%	2.3%	2.4%	2.1%	1.9%	1.9%	1.8%	1.8%
Neto të ardhurat dytësore nga jashtë	15.5%	19.2%	22.8%	20.9%	19.6%	18.7%	18.1%	17.7%
<i>prej të cilave: remitancat</i>	12.0%	12.1%	14.5%	14.7%	13.8%	13.2%	12.8%	12.5%
Investimet	36.3%	34.6%	33.4%	36.3%	40.2%	41.0%	42.1%	42.4%
Bilanci i llogarisë rrjedhëse	-11.0%	-5.7%	-7.0%	-8.8%	-9.6%	-10.0%	-10.1%	-9.9%
Bilanci tregtar	-41.0%	-40.3%	38.0%	-45.6%	45.2%	-44.8%	-44.7%	-44.7%
Bruto kursimet kombëtare	25.3%	28.9%	26.4%	27.4%	30.6%	31.0%	31.9%	32.5%
Kursimet private	20.8%	21.4%	24.9%	21.6%	24.7%	23.4%	23.0%	22.5%
Agregatët kryesorë (në milionë euro)								
Bruto Prodhimi Vendor (BPV)	6,672	7,056	6,772	7,817	8,755	9,621	10,408	11,156
Bruto të Ardhurat Kombëtare në Dispozicion (BAKD)	7,819	8,571	8,481	9,610	10,638	11,601	12,484	13,336
Dërgesat e emigrantëve	800	852	980	1,148	1,205	1,265	1,329	1,395
Të ardhurat private në dispozicion	6,681	7,134	7,407	8,105	8,994	9,640	10,306	10,949

Tabela 3 BPV nominale dhe komponentët e tij, në mil eur

Përshkrimi	2018	2019	2020	2021	2022 Proj.	2023 Proj.	2024 Proj.	2025 Proj.
<i>Në miliona euro</i>								
Konsumi	6,132	6,532	6,694	7,466	7,964	8,616	9,159	9,710
Konsumi privat	5,296	5,621	5,720	6,417	6,833	7,386	7,913	8,443
Konsumi publik	807	881	942	1,018	1,099	1,198	1,214	1,234
IJPSHESH	29	30	31	31	31	32	32	33
Investimet	2,421	2,438	2,260	2,835	3,518	3,944	4,380	4,734
Investimet private	1,888	1,907	1,880	2,414	2,814	3,152	3,464	3,747
Investimet publike	533	531	380	421	704	793	917	987
Neto eksportet e mallrave dhe shërbimeve	-1,882	-1,914	-2,182	-2,485	-2,727	-2,939	-3,132	-3,287
Eksportet	1,938	2,068	1,469	2,699	3,170	3,539	3,893	4,282
Eksportet e mallrave	377	393	475	753	1,032	1,186	1,305	1,436
Eksportet e shërbimeve	1,562	1,675	994	1,946	2,139	2,352	2,588	2,846
Importet	3,820	3,983	3,651	5,184	5,898	6,478	7,024	7,569
Importet e mallrave	3,114	3,233	3,048	4,320	4,985	5,493	5,962	6,423
Importet e shërbimeve	706	749	602	864	912	984	1,062	1,146
BPV	6,672	7,056	6,772	7,817	8,755	9,621	10,408	11,156
BAKD	7,819	8,571	8,481	9,610	10,638	11,601	12,484	13,336
<i>Indikatorë tjerë:</i>								
Të ardhurat e disponueshme të sektorit privat (në miliona euro)	6,681	7,134	7,407	8,105	8,994	9,640	10,306	10,949
Konsumi privat në raport me BPV-në	79%	80%	84%	82%	78%	77%	76%	76%

Investimet private në raport me BPV-në	28%	27%	28%	31%	32%	33%	33%	34%
Eksportet në raport me BPV-në	29%	29%	22%	35%	36%	37%	37%	38%
Importet në raport me BPV-në	57%	56%	54%	66%	67%	67%	67%	68%

KLAUZOLA E INVESTIMEVE

Në vitin 2012, si pjesë e programit të atëhershëm me Fondin Monetar Ndërkombëtar (FMN), Kuvendi i Kosovës kishte aprovuar amandamentet e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, përfshirë edhe rregullën fiskale. Ndër të tjera, kjo parashihte një kufizim vjetor të huamarrjes shtetërore deri në 2% të Bruto Produktit Vendor (BPV), pavarësisht kapacitetit të Qeverisë për të siguruar më shumë financim të jashtëm për projekte kapitale me rëndësi publike.

Në të njëjtën kohë, Qeveria e Kosovës kishte identifikuar nevojën për hapësirë shtesë fiskale për financim të projekteve të mëdha kapitale dhe në 2015 kishte filluar negociatat për një program të tretë me FMN-në, i cili mes tjerash, do të lejonte relaksim të rregullës fiskale të kufizimit të borxhit për projekte kapitale me rëndësi strategjike. Me fjalë të tjera, për këto projekte Qeveria do të ishte në gjendje të hynte në borxh përtej rregullës fiskale prej 2%, e cila rregull do të vlente për 10 vjet, përderisa borxhi publik të mos tejkalonte 30% të BPV-së së parashikuar. Kjo do t'i siguronte Qeverisë së Kosovës hapësirë fiskale shtesë prej afërsisht 1.8% mbi 2% të përcaktuar me rregullën fiskale. Kjo njihet si “amandamenti i klauzolës për investime” që paraqiti aprovimin e ndryshimeve të nevojshme legjislative nga Kuvendi, në janar 2016.

Qeveria e Kosovës mbetet e përkushtuar që në mënyrë të balancuar të përfshijë në buxhet projekte kapitale të implementuara përmes “klauzolës për investime”, ashtu që financimi i projekteve të tilla të bazohet në analizat për qëndrueshmërinë afatgjatë të borxhit publik.

Një kusht tjetër i paraparë me dispozitat e klauzolës për investime është që Ministria e Financave të përgatisë dy herë në vit një raport narrativ për implementimin e projekteve nën këtë dispozitë.

Është më rëndësi të theksohet se pandemia Covid-19 ka ndikuar në ngadalësimin e realizimit të projekteve të planifikuara gjatë 2020-2021. Masat e ndërmarra për të menaxhuar efektin e pandemisë në shëndetin publik, kanë shkaktuar një ngadalësim të aktivitetit ekonomik që është përcjellë me probleme të shumta për bizneset në vend dhe shtresat më të ndjeshme të shoqërisë. Për të sajuar dëmet e shkaktuara nga pandemia, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve ka hartuar Pakon e Ringjalljes Ekonomike, pjesë të së cilit do të financohen përmes Klauzolës së Investimeve.

Situata e krijuar nga pandemia ka krijuar po ashtu nevojën që të sigurohet financim shtesë për të menaxhuar situatën ekonomike dhe shëndetësore.

Projektet që janë të përfshira në klauzolën investive janë të përmbledhura shkurtimisht në vijim:

1. Financim për ri-kapitalizmin e Fondit Kosovar për Garantimin e Kredive - Në mënyre që të lehtësohet qasja në financim për bizneset vendore, në kuadër të programit për rimëkëmbjen ekonomike nga kriza e shkaktuar nga pandemia COVID-19, është paraparë edhe ri-kapitalizmi i Fondit Kosovar për Garantimin e Kredive (FKGK). Totali i financimit të ri-kapitalizmit të FKGK pritet të jetë 40 milion euro dhe është planifikuar të financohet përmes marrëveshjes së financimit mes Kosovës dhe Bankës Evropiane për Investime (BEI), e cila është nënshkruar dhe ratifikuar. Disbursimi i parë në vlerë prej 10 milion euro pritet të ndodh në tremujorin e tretë të 2022.

2. Instrumenti për Financim të Sektorit Publik për Reagim Emergjent ndaj COVID-19 - Ky projekt është në kuadër të programit për rimëkëmbjen ekonomike sa i përket sektorit shëndetësor me Bankën Zhvillimore të Këshillit të Evropës. Vlera totale e kredisë është 35 milionë euro, ndërsa norma e interesit është e subvencionuar nga Banka Zhvillimore e Këshillit të Evropës (CEB) deri në 1 milion euro. Marrëveshja financiare është ratifikuar nga Kuvendi i Kosovës dhe ka hyrë në fuqi. Disbursimi i parë prej 17.8 milionë euro ka ndodhur në fund të 2020, ndërsa pjesa tjetër është disbursuar në prill të 2021. Kjo marrëveshje është amendamentuar me financim shtesë prej 25 milion euro, ky amendament është në fuqi dhe një pjesë e shumës është përdorur për financimin e blerjes së vaksinave për mbrojtje nga COVID-19, si dhe shpenzimeve tjera të ndërlidhura me COVID-19. Deri më tani, prill 2022, janë disbursuar gjithsej rreth 35 milion euro nga kjo kredi.

3. Projekti Emergjent për COVID-19 për Kosovën (dhe amendamenti i financimit shtesë) – Projekti bazë është negociuar dhe ratifikuar më 2020. Qëllimi kryesor i projektit është të mbështesë Qeverinë e Kosovës në luftën kundër pandemisë së COVID-19. Komponentët kryesorë të projektit kanë të bëjnë me rimbursimin e shpenzimeve të transfereve sociale që janë bërë në vitin 2020, si dhe për blerjen e pajisjeve mjekësore. Vlera totale e projektit bazë është 46 milionë euro, si dhe 2 milionë euro grant të dhëna nga BB. Amendamenti i financimit shtesë ka rritur shumën e projektit edhe për 15 milion euro. Deri më tani janë disbursuar rreth 49.12 milion euro. Një pjesë e prokurimit të pajisjeve mjekësore është duke u kryer nga UNOPS. Pjesa tjetër pritet të disbursohet gjatë fundit të vitit 2022 dhe fillimit të vitit 2023.

4. Kredia e likuiditetit të urgjencës së infrastrukturës vitale - Për shkak të pandemisë COVID-19, ofruesit e shërbimeve vitale infrastrukturore në Republikën e Kosovës janë përballur në vazhdimësi me rënie të hyrave. Në mungesë të likuiditetit apo ndonjë përkrahje shtesë qeveritare, këto ndërmarrje janë në rrezik të theksuar të kolapsit financiar. Me qëllim të shmangies së këtij rreziku, Qeveria e Kosovës ka negociuar këtë marrëveshje për kredi emergjente për infrastrukturë vitale me Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim. Vlera e kredisë është 30,000,000 EUR me kohëzgjatje prej 3 vjet. Marrëveshja financiare është nënshkruar dhe ratifikuar në fund të vitit 2020. Disbursimi i parë prej 10.3 milion euro është bërë në tremujorin e dytë të vitit 2021, ndërsa pjesa tjetër pritet të bëhet në deri në qershor të vitit 2022.

5. Projekti i Fuqizimit të Sektorit Financiar - Ky projekt ka Fondin Kosovar për Garanci Kreditorë (FKGK) si institucion implementues, dhe qëllimi i projektit është përmirësimi i qasjes

në financa për ndërmarrjet mikro, të vogla, dhe të mesme, duke forcuar kapacitetin financiar dhe teknik të FKGK-së. Marrëveshja financiare është lidhur me AZhN/Bankën Botërore dhe ka vlerën prej 22.3 milion euro. Nga këto 21.5 milion janë destinuar për të rritur kapitalin e FKGK-së dhe 0.8 milion për përforsimin institucional të FKGK-së. Me aprovimin e Ligjit për Rimëkëmbje Ekonomike është mundësuar që FKGK të mbulojë më shumë se 50% të garancionit të kredive për investime të caktuara dhe të mbulojë tarifatat përkatëse për biznese. Asistenca teknike e paraparë në projekt është duke punuar në vazhdimësi me FKGK për të arritur synimet e përcaktuara në projekt. Deri më tani është disbursuar e gjithë shuma e projektit.

6. Rehabilitimi i Linjës Hekurudhore 10 - Institucioni zbatues i këtij projekti është Ndërmarrja Publike “Infrakos” Prishtinë. Fillimisht, kostoja totale e projektit është vlerësuar të jetë rreth 194.5 milionë euro, ku gjysmën e financojnë BERZH dhe BEI, ndërsa gjysmën tjetër të këtij projekti e financojnë Bashkimi Evropian. Marrëveshjet financiare me BERZH dhe BEI janë nënshkruar dhe ratifikuar. Për sa i përket kontributit të BE-së, tashmë janë nënshkruar dhe ratifikuar marrëveshja e parë dhe e dytë e grantit. Por, për shkak të ndryshimeve në çmimin e tregut dhe nevojës për ekspertë shtesë, vlera totale e projektit pritet të rritet në 255 milionë euro. Si një projekt me prioritet të lartë për BE-në, barazia me institucionet financiare ndërkombëtare (BERZH dhe EIB) do të ruhet për të kërkuar fonde shtesë për këtë projekt. Paralelisht një aplikim për grant do të dorëzohet në WBIF. Punimet civile për fazën 1 kanë filluar në fillim të vitit 2019, ndërsa për fazën 2 punimet kanë filluar në tremujorin e parë të 2022. Projektimi i detajuar për fazën 3 pritet të zhvillohet gjatë 2022. Disbursimi i parë nga kreditë dhe marrëveshja e donacionit është realizuar gjatë vitit 2019 dhe për shkak të vonësive në implementim në nëntor të këtij viti është nënshkruar marrëveshja e amendamentimit me BEI dhe është bërë zgjatja e afatit të kredisë deri në vitin 2022.

7. Rehabilitimi i Ibër-Lepencit - Shuma e financuar nga huamarrja për këtë projekt është 22 milion EUR, prej të cilave 7 milion janë kredi direkte tek ME dhe 15 milion janë të nën-huazuara tek Ibër-Lepenci që njëkohësisht është organizata implementuese e projektit. Marrëveshja financiare mes Republikës së Kosovës dhe Bankës Botërore është ratifikuar në vitin 2017 ndërsa disbursimi i parë është bërë në janar 2018. Deri në muajin nëntor 2021 është disbursuar 21% e shumës së përgjithshme të kredisë. ME së bashku me Bankën Botërore kanë ri-strukturuar një pjesë të projektit dhe një pjesë e fondeve janë transferuar tek kredia për Financimin e Politikave Zhvillimore për Financa Publike dhe Rritje të Qëndrueshme.

8. Rehabilitimi i Rrugëve Rajonale - Institucioni implementues për këtë projekt është Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës. Marrëveshja financiare është ratifikuar dhe ka vlerën prej 29 milion EUR, me financim nga BERZH. Punët në terren kanë filluar në Maj të 2019-ës dhe të gjitha kontratat janë të nënshkruara. Në fund të vitit 2020 është nënshkruar marrëveshja për vazhdim të grantit për mbulimin e shërbimeve shtesë të konsulentit si mbështetje për njësinë implementuese të projektit deri në vlerën 450,000 EUR. Deri në prill të vitit 2022 janë disbursuar gjithëj 3.6 milion euro nga projekti në fjalë.

9. Ndërtimi i Autostradës N9 Prishtinë - Pejë (SEETO Route 6 A) segmenti Kijevë - Klinë deri në Zahaq - Institucioni implementues për këtë projekt është Ministria e Mjedisit,

Planifikimit Hapësinorë dhe Infrastrukturës (MMPHI). Kosto e projektit është 193 milion EUR. Marrëveshja e Kredisë me BERZH është nënshkruar në 2017 dhe BEI në pjesën e dytë të vitit 2018. Në janar 2019, marrëveshja prej 1 milion EUR është nënshkruar mes Republikës së Kosovës dhe BEI si pjesë e Iniciativës ERI për mbështetje gjatë implementimit. Pritet që të përfitohet një grant prej 100,000 eurosh nga BERZH për financimin e rrugës dhe studimin institucional. Procesi për përzgjedhjen e mbikëqyrësit të punimeve ka përfunduar dhe është lansuar tenderi për punë të vrazhda. Projekti për momentin ka hasur në probleme, dhe pritet të vazhdoj sapo të zgjidhen problemet.

10. Projekti për Konkurrueshmëri dhe Gatishmëri për Eksport - Organizata implementuese për këtë projekt është Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë (MINT). Ky projekt ka synim të përkrah certifikimin e produkteve për eksportim, ngritjen e kapaciteteve të kompanive të orientuara drejt eksportit dhe zvogëlimin e kostos për inspektimin e bizneseve. Marrëveshja në shumën 14.3 milion euro është nënshkruar në vitin 2017 me Agjencinë Ndërkombëtare për Zhvillim – Bankën Botërore, dhe disbursimi i parë është bërë në vitin 2019. Deri në prill të vitit 2022 është disbursuar 1 milion euro të shumës së përgjithshme të kredisë.

11. Financimi Shtesë për Projektin e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural - Organizata implementuese është MBPZhR. Projekti ka si synim t’i ndihmoj përfituesve në përmirësimin e produktivitetit dhe qasjes në treg të hortikulturës dhe blegtorisë kompanive Kosovare dhe përfundimin e kapacitetit institucional të MBPZhR-së. Marrëveshja për këtë projekt në shumën 20.8 milion euro është nënshkruar me Agjencinë Ndërkombëtare për Zhvillim – Bankën Botërore, në vitin 2017. Disbursimi i parë është bërë në mars të 2019-ës ndërsa deri në prill të vitit 2022 janë disbursuar 13.4 milion euro nga shuma e përgjithshme e kredisë.

12. Trajtimi i Ujërave të Zeza në Prishtinë (Ndërtimi i Impiantit për Trajtimin e Ujërave të Zeza në rajonin e Prishtinës) - Financimi i projektit është siguruar përmes marrëveshjes kornizë mes Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Republikës së Francës, e cila është ratifikuar gjatë 2017. Bazuar në marrëveshjen, projekti ka vlerën 86 milion EUR. Implementimi ka filluar në pjesën e dytë të vitit 2020, ku është hapur tenderi për dizajn. Paralelisht, është punuar që të sigurohet edhe financim nga instrumente tjera për pjesën e mbetur të projektit, ku pritet të aplikohet për fonde të IPA-së.

13. Ndërtimi i Impianteve për Trajtim të Ujërave të Zeza në Mitrovicë - Kompania rajonale e ujit të Mitrovicës është institucioni implementues për këtë projekt. Projekti është në proces të vlerësimit nga BERZH (si institucion kryesor financiar) dhe BEI, të cilët do të financojnë projektin së bashku, ndërsa do të mbështetet edhe nga një grant nga Korniza Investuese e Ballkanit Perëndimor (WBIF). Marrëveshjet me këto institucione janë nënshkruar në nëntor të vitit 2021, dhe pritet të ratifikohen në gjatë muajit prill 2022.

14. Ekonomia Digjitale në Kosovë (KODE) - Organizata implementuese e këtij projekti është MINT. Objektivi kryesor i projektit është që të përmirësoj qasjen në internet të shpejtë dhe me kualitet në rajonet e nën-zhvilluara në këtë aspekt dhe të ofroj trajnime për të rinjë në që të fuqizohen për të punuar online. Marrëveshja financiare për kredi në shumën 20.7 milion euro

është nënshkruar në vitin 2018 me kreditorin ANZh. Disbursimi i parë është bërë në Nëntor 2019 dhe deri më tani janë disbursuar 7.7 milion euro nga shuma e përgjithshme e kredisë. Implementimi i projektit është duke vazhduar me tempo të përshpejtuar.

15. Projekti i Zhvillimit të Trajtimit të Ujërave të Zeza në Gjilan - Kompania rajonale e ujit të Gjilanit është institucioni implementues për këtë projekt, i cili ka një vlerë të paraparë prej 23 milion EUR, që do të financohet prej BERZH dhe BEI. Marrëveshja financiare prej 10 milion EUR me BERZH është nënshkruar në maj të 2020-ës dhe është ratifikuar në parlament me 23 korrik 2020, ndërsa marrëveshja prej 11 milion EUR me BEI është nënshkruar në maj 2020 dhe është ratifikuar në fund të 2020. Po ashtu për investime kapitale në këtë projekt do të nënshkruhet edhe një marrëveshje e grantit në vlerë prej 2.5 milion euro. Projekti pritet të fillojë implementimin gjatë vitit 2022.

16. Projekti i Kadastrës së Patundshmërisë dhe Infrastrukturës Hapësinore (REGIP) - Institucioni zbatues i këtij projekti është Agjencia Kosovare e Kadastrës. Objektivi kryesor i projektit është që të ndihmojë në zhvillimin e tregut të tokës dhe patundshmërive dhe të rrisë sigurinë e pronësisë. Marrëveshja financiare në shumën 14.6 milion euro me kreditorin ANZh është nënshkruar në shkurt të vitit 2019. Ratifikimi i marrëveshjes është bërë në gusht 2020 dhe deri më tani prill 2022 janë disbursuar 220 mijë euro nga kjo kredi.

17. Projekti për Nxitjen dhe Levijimin e Mundësive për Sigurinë e Ujit - Është projekt i cili ka si synim ngritjen e kapaciteteve të autoriteteve vendore për menaxhimin e sigurisë së ujit dhe përmirësimin e sigurisë së ujit në bazenin e Moravës së Binçës. Projekti është në një shumë 25.1 milion euro. Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve ka kërkuar mbështetje nga Bashkimi Evropian, për financimin e një pjese të asistencës teknike të cilën e parashihet projekti në mënyrë që mjetet e huasë të fokusohen më shumë në investime kapitale. Marrëveshja e nënshkruar është ratifikuar në kuvend gjatë muajit shkurt të vitit 2022, implementimi i marrëveshjes pritet të fillojë së shpejti.

18. Projekti i Reformës së Sistemit të Ndhmës Social në Kosovë - Ky projekt ka për synim forcimin e sistemeve për ofrimin e mbrojtjes sociale dhe përmirësimin e performancës së Sistemit të Ndhmës Sociale. Projekti financohet nga AZhN/Banka Botërore, me një shumë totale prej 47 milion euro. Marrëveshja është nënshkruar dhe pritet të ratifikohet gjatë muajit prill 2022. Pjesa më e madhe e huasë është e dedikuar për linjën buxhetore Subvencione dhe Transfere, sidoqoftë janë paraparë investime për sistemet e realizimit të skemës së ndihmës sociale, të cilat pritet të fillojnë të realizohen gjatë 2022.

19. Projekti për Trajtimin e Ujërave të Zeza në Komunën e Podujevës - Komuna e Podujevës është institucioni implementues i këtij projekti. Marrëveshja financiare për kredi në shumën 5.35 milion euro është nënshkruar me UniCredit Bank Austria AG, në emër të Qeverisë së Austrisë, në vitin 2018. Disbursimi i parë për projektin është bërë në 2019 dhe projekti pritet të përmbyllet së shpejti.

20. Ndërtimi i Skemës për Furnizim me Ujë në Komunën e Ferizajt - Komuna e Ferizajt është institucioni implementues i këtij projekti. Marrëveshja financiare për kredi në shumën 5,125 milion euro është nënshkruar në nëntor të vitit 2018 me Raiffeisen Bank International, e

cila vepron në emër të Qeverisë të Austrisë. Disbursimi i parë për këtë projekt është bërë në 2019 dhe projekti pritet të përmbyllet së shpejti.

21. Ndërtimi i Skemës për Furnizim me Ujë në Komunën e Istogut - Komuna e Istogut është institucioni implementues për këtë projekt, që financohet me kredi në shumën 5,094 milion euro. Marrëveshja financiare është nënshkruar në nëntor të vitit 2018 me UniCredit Bank Austria AG, e cila vepron në emër të Qeverisë së Austrisë. Disbursimi i parë për këtë projekt është bërë në 2019 dhe projekti pritet të përmbyllet së shpejti.

22. Projekti për Trajtimin e Ujërave të Zeza në Komunën e Shtimes - Komuna e Shtimes është institucioni implementues për këtë projekt, që financohet me kredi në shumën 2,385 milion euro. Marrëveshja financiare është nënshkruar në nëntor të vitit 2018 me UniCredit Bank Austria AG, e cila vepron në emër të Qeverisë së Austrisë. Disbursimi i parë për këtë projekt është bërë në 2019 dhe projekti pritet të përfundoj së shpejti.

23. Ndërtimi i Skemës për Furnizim me Ujë në Komunën e Graçanicës - Komuna e Graçanicës është institucioni implementues për këtë projekt, që financohet me kredi në shumën 5,115 milion euro. Marrëveshja financiare është nënshkruar në nëntor të vitit 2018 me UniCredit Bank Austria AG, e cila vepron në emër të Qeverisë së Austrisë. Disbursimi i parë për këtë projekt është bërë në 2019 dhe projekti pritet të përfundoj së shpejti.

24. Projekti i Transportit Publik, Komuna e Prishtinës - Ndërmarrja Publike e Prishtinës 'Trafiku Urban' është institucioni zbatues për këtë projekt, i cili ka një kosto totale të vlerësuar prej 10 milion EUR. Projekti është financuar nga BERZH dhe implementimi i tij ka filluar në vitin 2016. Pas përfundimit të projektit, tani kredia është duke u paguar.

25. Nga Marrëveshja Kornizë për Aid Tied Loan me Qeverinë Hungareze

Këto projekte janë duke u rishikuar dhe pritet që gjatë 2022 të rivlerësohet se cilat projekte do të financohen përmes kësaj huaje. Projektet më poshtë janë indikativë:

○ *SCADA (Supervisory Component And Data Acquisition)* – Projekt i cili parasheh përmirësimin e menaxhimit dhe mbikëqyrjes së ujërave përmes sistemeve digjitale që monitorojnë dhe kontrollojnë infrastrukturën kyçe të ujërave. Si rezultat parashihet instalimi i komponentëve fizike si sensorë, pompa dhe instrumente të tjera të cilat më pas ndërlidhen me softwerin e zhvilluar nga kompania hungareze. Negociatat e Marrëveshjes së Financimit i nënshtrohen procedurave të Ligjit Nr. 05 / L-153.

○ *Impianti i trajtimit të ujërave të zeza në Komunën e Ferizajt* - Ky projekt përfshin dizajnin, ndërtimin dhe mirëmbajtjen e sistemeve të grumbullimit (Impianti i Trajtit të Ujërave të Zeza) në Komunën e Ferizajt. Ky projekt do të zbatohet nga Komuna e Ferizajt. Projekti është miratuar nga Komiteti Kombëtar i Investimeve (NIC) që do të financohet përmes Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Hungarisë për Themelimin e Programit Kuadër për Bashkëpunim Financiar (Ligji Nr. 05 / L-153). Negociatat e Marrëveshjes së Financimit i nënshtrohen procedurave të Ligjit Nr. 05 / L-153.

26. Projekti për Ambientin dhe Gjelbërimin e Tokës - Ky projekt pritet të financohet nga Banka Botërore, përkatësisht Asociacioni Ndërkombëtar për Zhvillim në vlerë prej rreth 21 milionë dollarë (17 milion euro). Qëllimi i projektit është të demonstrojë një qasje të bazuar në risk për menaxhimin e tokës së kontaminuar në zona të caktuara dhe të përmirësojë kapacitetin

institucional dhe legjislativ të vendit, për menaxhim të tokës së kontaminuar. Marrëveshja financiare pritet të nënshkruhet në vitin 2022.

27. Projekti i Eficiencës së Energjisë për Komunën e Prishtinës - Projekti synon zhvillimin e një programi të besueshëm dhe të përballeshëm për rinovimin e energjisë për ndërtesat publike komunale. Shuma e projektit pritet të jetë rreth 6 milion euro dhe do të financohet nga BERZH. Marrëveshja në mes BERZH dhe Qeverisë së Kosovës është nënshkruar në prill të vitit 2022. Huaja do të merret si hua sovrane nga niveli qendror dhe pastaj do të transferohet si nën-huazim për komunën. Komuna do të buxhetoi projektin si investim kapital për 2023, kur të përgatiten kushtet për fillimin e implementimit të projektit.

28. Projekti i Eficiencës së Energjisë për Komunën e Prizrenit - Projekti synon zhvillimin e një programi të besueshëm dhe të përballeshëm për rinovimin e energjisë për ndërtesat publike komunale. Shuma e projektit pritet të jetë 5 milion euro dhe do të financohet nga BERZH. Marrëveshja në mes BERZH dhe Qeverisë së Kosovës pritet të nënshkruhet gjatë vitit 2022. Huaja do të merret si hua sovrane nga niveli qendror dhe pastaj do të transferohet si nën-huazim për komunën. Komuna do të buxhetoi projektin si investim kapital për 2023, kur të përgatiten kushtet për fillimin e implementimit të projektit.

29. Projekti për Banim Social - Projekti synon të ofroj banim të përballeshëm për kategori të caktuara të qytetarëve. Projekti është duke u zhvilluar me përkrahjen e UN-Habitat, të cilët janë duke bërë studimin e fizibilitetit dhe koncept dokumentin për program. Projekti pritet të kushtoj në total rreth 50 milion euro dhe një pjesë e tij do të financohet nga CEB, derisa modalitetet e strukturimit të projektit si dhe implementimit të tij do të definohen nga studimi i fizibilitetit. Studimi i fizibilitetit është finalizuar gjatë muajit shkurt të këtij viti ndërsa marrëveshja financiare me CEB pritet të negociohet dhe nënshkruhet deri në fund të vitit 2022.

30. Projekti për Ngrohjen Qendrore Solar - Synimi kryesor i këtij projekti është të kontribuoj në një furnizim eficient, të besueshëm dhe miqësor ndaj ambientit të ngrohjes për shtëpitë, institucionet publike dhe bizneset në Prishtinë. Ky projekt do të financohet nga KfW dhe BERZH. Vlera e këtij projekti do të jetë rreth 64 milion euro. Qeveria gjermane ka zotuar rreth 30 milion euro në formën e grantit për këtë projekt. Ndërsa ministria ka aplikuar gjithashtu në Kornizën Investuese të Ballkanit Perëndimor për të përfutur përkrahje nga kjo kornizë. Marrëveshjet pritet të negociohen dhe nënshkruhen gjatë vitit 2022.

31. Projekti për gjeneratorin fotovoltaik diellor në KEK – Ky projekt do të ndërtoj kapacitetet për gjenerimin e energjisë elektrike nga energjia diellore në afërsi të KEK-ut. Kapaciteti i gjenerimit nga ky projekt do të jetë deri 100 MW energji elektrike të cilat do të shfrytëzohen për diversifikimin e burimeve të energjisë në Kosovë. Projekti pritet të kushtoj rreth 100 milion euro dhe do të financohet së bashku nga KfW dhe nga BEI. Po ashtu do të aplikohet për një grant investiv në Kornizën Investuese të Ballkanit Perëndimor në vlerë prej 30 milion euro. Marrëveshjet financiare pritet të nënshkruhen deri në fund të vitit 2022.

32. Zhvillimi i sektorit të energjisë VII – Përmirësimi i rrjetit të transmisionit – Ky projekt parashihet të zhvillohet për të përmirësuar sistemin e transmisionit në Kosovë. Specifikisht projekti përfshin masa për rehabilitimin, zgjerimin dhe modernizimin e rrjetit të transmisionit kosovar. Projekti financohet nga KfW dhe kap vlerën 25.5 milion euro. Shuma do të transferohet si nën-huazim tek KOSTT-i. Marrëveshja është negociuar, dhe sapo të

përmbushen kriteret e qëndrueshmërisë nga ana e KOSTT-it, pritet që marrëveshja të nënshkruhet.

33. Qytetet e Banueshme – Projekti është një projekt i financuar nga ANZh (Banka Botërore) dhe pritet të kap vlerën deri rreth 30 milion euro. Projekti ka si synim të mbështesë zhvillimin e infrastrukturës urbane të gjelbër, me karbon të ulët dhe të përshtatshme për qytetet urbane në Kosovë. Për një komponent të këtij projekti pritet të aplikohet edhe në Kornizën Investuese të Ballkanit Perëndimor në vlerë prej 10 milion euro.

34. Gjelbërimi i tokave – Ky projekt ka si synim të trajtoj tokat e kontaminuara në Kosovë duke i dekontaminuar dhe gjelbëruar ato. Toka e parë e cila pritet të trajtohet nga projekti është toka në afërsi të KEK-ut e cila është kontaminuar nga mbetjet e termocentraleve ndër vite. Kosto totale e projektit pritet të jetë rreth 50 milion euro dhe do të zhvillohet në faza, ku përfshihen studimet e fizibilitetit për tokat e identifikuar, pastaj investimet kapitale për ato toka. Projekti do të financohet nga ANZh (Banka Botërore) si dhe do të aplikohet në Kornizën Investuese të Ballkanit Perëndimor për një grant të asistencës teknike, për studim fizibilitetit për dy toka, si dhe për grant investues në vlerë prej 10 milion euro për investime në tokën në afërsi të KEK-ut.

35. Projekti për Ndërtimin e Rrugës Besi - Merdare - Ky projekt financohet nga BERZh dhe BEI, shuma totale e projektit pritet të jetë mbi 200 milionë euro. Projekti është pjesë e Planit Investues dhe Ekonomik të Ballkanit Perëndimor të hartuar nga BE-ja, dhe deri më tani ka përfituar nga grante investive dhe të asistencës teknike mbi 45 milion euro. Marrëveshjet financiare është planifikuar që të konkludohen në vitin 2022.

36. Implementimi i studimit të fizibilitetit për pajisje mjekësore për kujdesin dytësor dhe tretësor - Vlera totale e projektit është parashikuar të jetë rreth 53 milion euro. Akoma nuk kanë filluar diskutimet formale për këtë projekt. Negociatat formale pritet të zhvillohen gjatë fundit të 2022. Ky projekt pritet të financohet përmes kredive me Bankën Zhvillimore e Këshillit të Evropës dhe Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim.

37. Përfshirja e të rinjve dhe ndërmarrësja - Për shkak të pandemisë, diskutimi i projekti është shtyrë që të fillojë më vonë gjatë vitit 2022.

38. Projekti për Ujërat (Blue Economy for Sustainable Development) - ky është projekt i ri i cili do të mbulojë sektorin e ujërave në vend dhe do të diskutohet e finalizohet me Bankën Botërore këtij viti.

Ndërtimi i Qarkores së Prishtinës - Institucioni implementues për këtë projekt është Komuna e Prishtinës. Studimi i fizibilitetit për këtë projekt është në përfundim e sipër.

ANEKS 2

Tabela 1. Krahasimi i parashikimeve buxhetore, KASH-et dhe realizimi për vitin 2021

	KASH Fillestar (2019-2021)	KASH mëi fundit (2021-2023)	KASH Vjetor I Rishikuar 2021-2023	Buxheti Vjetor 2021	PRE 2021-2023	Aktualet					KASH-i i fundit në raport me Aktualet	Buxheti në raport me Aktualet	
							KASH fillestar: Aktualet	KASH më i fundit: Aktualet		Buxheti: Aktualet			
								%	mil Eur	%			mil Eur
Gjithsej Shpenzimet	2,483.0	2,276.0	2,475.1	2,454.2	2,454.2	2,263.0	-8.9%	-8.6%	-212.1	-7.8%	-191.2		
Shpenzimet rrjedhëse totale	1,613.0	1,631.0	1,781.1	1,789.6	1,789.6	1,842.6	14.2%	3.5%	61.5	3.0%	53.0		
<i>prej të cilave:</i> Shpenzimet Rrjedhëse të Rregullta	1,613.0	1,631.0	1,633.1	1,611.6	1,611.6	1,609.0	-0.3%	-1.5%	-24.1	-0.2%	-2.6		1) Nën realizim i shpenzimeve në mallra dhe shërbime prej 24 ml Eur;
<i>prej të cilave;</i> Programi Rimekembjes Ekonomike	0.0	0.0	148.0	178.0	178.0	234.0	-	58.1%	86.0	31.5%	56.0		1) Mbi realizim i subvencionëve dhe transfereve me rreth 68 mln Eur; 2) Mbi realizim i mallrave dhe shërbimeve me rreth 23 mln Eur;
Shpenzimet Kapitale	869.0	599.0	645.6	626.1	626.1	419.8	-51.7%	-35.0%	-225.8	-32.9%	-206.3		1) Mosekzekutimi i klauzolës së investimeve për shkak të pengesave në njesitë implementuese (-158.4 mln); 2) Ekzekutimi më i ulët i buxhetit të rregullt për shkak të një ngadalesimi në ekzekutim si rrjedhojë e masave kufizuese të shkaktuara nga pandemia COVID-19 (-37.4 mln);

												3) Mungesa e investimeve të financuara përmes të ardhurave të likuidimit (-30 mln) në vitin 2021;	
Gjithsej të Hyrat	2,160.0	2,007.0	1,916.9	1,887.9	1,887.9	2,184.1	1.1%	13.9%	267.2	15.7%	296.2	<p>1) Mbi performancë në të ardhurat nga TAK dhe TAP (36.2 mln) si rezultat i një aktiviteti ndjeshëm më të lartë ekonomik se niveli i pritur dhe formalizimit të ekonomisë;</p> <p>2) Mbi performancë me rreth 6.3 mln në të ardhurat nga tatimi në pronë kryesisht si rezultat i ardhjes më të madhe të diasporës dhe mbartja e pagesës nga viti 2020.</p> <p>3) Mbi performancë e TVSH-së në kufi dhe në vend, kryesisht për shkak të rritjes së aktivitetit ekonomik, importeve dhe konsumit më të lartë (164.9 mln);</p> <p>4) Të ardhura më të larta nga akciza, duke reflektuar rritjen e aktivitetit ekonomik dhe ecurinë e importeve (75.8 mln);</p> <p>5) Të ardhura më të larta jotatimore për 13.8 milionë;</p>	<p>1) Mbi performancë në të ardhurat nga TAK dhe TAP (34.1 mln) si rezultat i një aktiviteti ndjeshëm më të lartë ekonomik se niveli i pritur dhe formalizimit të ekonomisë;</p> <p>2) Mbi performancë me rreth 6.3 mln në të ardhurat nga tatimi në pronë ;</p> <p>3) Mbi performancë e TVSH-së së brendshme dhe në kufi, kryesisht për shkak të rritjes së aktivitetit ekonomik dhe rritjes së ndjeshme të importit të mallrave - nxitur edhe nga çmimet (176.0 mln)</p> <p>4) Të ardhura më të larta nga akciza duke reflektuar rritjen e aktivitetit ekonomik dhe performancën e importeve (76 mln)</p> <p>5) Të ardhura jotatimore më të larta me 36.3 milionë ;</p>
Bilanci Primar	-323.0	-269.0	-558.2	-566.3	-566.3	-78.9	-0.8	-0.9	479.3	-0.9	487.4		
Pagesa e Interesit	-19.0	46.0	48.3	38.5	38.5	30.9	-2.6	-0.4	-17.4	-0.2	-7.6		
Bilanci I Përgjithshëm	-342.0	-121.0	-343.7	-337.3	-337.3	-25.1	-0.9	-0.9	318.6	-0.9	312.2		

Tabela 2. Devijimet kryesore ndërmjet KASH-ve 2022- 2024 dhe 2023- 2025 për vitin 2023

viti 2023	KASH 2022-2024	KASH 2023-2025	Devijime		KASH i fundit ndaj KASH-it të kaluar
			%	mIn Eur	
			KASH i fundit ndaj KASH-it të kaluar		
Të Hyrat Totale Buxhetore	2,207.4	2,676.6	21.3%	469.19	
<i>nga të cilat</i>					
Akciza	487.2	551.6	13.2%	64.4	1) rritja pozitive ekonomike reale në vitin 2021 ka çuar në nivel më të lartë të të hyrave nga akciza në vitin bazë (2021) i cili përdoret për të vlerësuar të hyrat në vitet vijuese;
Detyrimi Doganor	155.1	148.1	-4.5%	-7.0	
TVSH në kufi	704.3	937.6	33.1%	233.3	1) niveli më i lartë në të hyrat nga TVSH në kufi në vitin 2021, i cili përdoret për të vlerësuar të hyrat në 2022 dhe vitet pasardhëse; 2) rritja e presioneve inflacioniste për vitin 2022 dhe në periudhën afatmesme si rezultat i luftës në Ukrainë çon në arkëtim më të lartë të TVSH-së në kufi; 3) rritja e theksuar e investimeve kapitale, të cilët kanë përmbytje të lartë importi; 4) norma efektive më e lartë e TVSH në kufi për vitin 2021, e cila përdoret për të parashikuar të hyrat në vitet vijuese.
TVSH vendore	281.3	388.7	38.2%	107.4	1) niveli më i lartë në të hyrat nga TVSH vendore në vitin 2021, i cili përdoret për të vlerësuar të hyrat në 2022 dhe vitet pasardhëse; 2) rritja e çmimeve vendore si rezultat i çmimeve të importeve dhe pritjet për vazhdim të këtyre presioneve deri në fund të vitit 2022; 3) zgjerimi i bazës tatimore si rezultat i uljes së informalitetit; 4) norma efektive më e lartë e TVSH vendore për vitin 2021, e cila përdoret për të parashikuar të hyrat në vitet vijuese.
Tatimet direkte	360.5	435.5	20.8%	75.0	1) efekti bazë për të hyrat nga TAK dhe TAP në 2022 që ka bërë që viti 2023 të ketë nivele më të larta të të hyrave nga këto dy tatime; 2) vazhdimi i zgjerimit të bazës tatimore përmes uljes së informalitetit
Të hyrat jo-tatimore	236.7	261.9	10.7%	25.2	1) të hyrat jo-tatimore janë kryesisht më të larta për shkak të një zbatimi më dinamik të procesit të legalizimit të ndërtimeve pa leje dhe përmirësimit të përmbushjes së regjistrimit të automjeteve. 2) rritja është në linjë me aktivitetin ekonomik
Shpenzimet Totale Buxhetore	2621.0	2903.9	10.8%	282.9	
<i>nga të cilat</i>					

Paga dhe Shtesa	660.1	695.3	5.3%	35.2	<p>1) në KASH 2023-2025 është parashikuar vendosja e afër 19.8 milion Euro si kontigjencë ne kategorinë Paga dhe Shtesa, në kuader të programit Kontigjenca në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve;</p> <p>2) është parashikuar rritja e kategorisë së pagave te Ministria e Shëndetësisë, këto mjete do të përdoren për pagesën e specializanteve;</p> <p>3) është rritur kategoria e pagave dhe shtesave te disa organizata për të mbuluar obligimet e papaguara dhe punët jashtë orarit.</p>
Mallra dhe Shërbime	352.9	475.7	34.8%	122.8	<p>1) rritja e kategorisë së mallrave te Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë si rezultat i planifikimit per rritje të rezervave shtetërore dhe rritje të rezervave të naftës;</p> <p>2) rritja e kategorisë së mallrave te Ministria e Shëndetësisë si rezultat i planifikimit të blerjes së barnave (burimi i financimit huamarrja);</p> <p>3) rritja e kategorisë së mallrave dhe shërbimeve te Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës si rezultat i planifikimit të rritjes së shërbimeve për mirëmbajtje të rrugëve si dhe kredia për ujërat e zeza.</p> <p>4) rritja e kategorisë së mallrave dhe shërbimeve te Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve si rezultat i planifikimit të regjistrimit të popullsisë</p>
Subvencione dhe Transfere	759.8	947.4	24.7%	187.6	<p>1) planifikimi I shpenzimeve në KASH-in aktual ka adresuar të gjitha mungesat në skemat sociale dhe është buxhetuar bazuar në nevojat për pagesa të këtyre skemave;</p> <p>2) zgjerimi i skemave sociale duke shtuar shtesat për lehona dhe shtesat për fëmijë;</p> <p>3) rritja e pensionit bazë nga 90 në 100 Euro.</p>
Shpenzimet Kapitale	787.0	792.8	0.7%	5.8	<p>1) Alokimi në Buxhet 2022 për pagesën e kostove të shpronësimeve, që do i hap rrugë ekzekutimit më të shpejtë të shpenzimeve kapitale;</p> <p>2) Funkcionalizimit të Bordit të Organit Shqyrtues të Prokurimit Publik.</p>
Interesi për Borxhin Publik	56.4	46.8	-17.0%	-9.6	<p>1) Supozimet për norma më të larta për instrumentet e Letrave me Vlere, duke pasur parasysh se gjate pandemisë ka pasur tendenca per rritjen e tyre</p>

Tabela 3. Devijimet kryesore ndërmjet KASH-ve 2022- 2024 dhe 2023- 2025 për vitin 2024

viti 2024	KASH 2022-2024	KASH 2023-2025	Devijime		KASH i fundit ndaj KASH-it të kaluar
			KASH i fundit ndaj KASH-it të kaluar		
			%	mln Eur	
Të Hyrat Totale Buxhetore	2,309.3	2,864.0	24%	554.7	KASH i fundit ndaj KASH-it të kaluar
<i>nga të cilat</i>					
Akciza	506.3	579.7	15%	73.4	1) rritja pozitive ekonomike reale në vitin 2021 ka çuar në nivel më të lartë të të hyrave nga akciza në vitin bazë (2021) i cili përdoret për të vlerësuar të hyrat në vitet vijuese;
Detyrimi Doganor	163.3	161.1	-1%	-2.2	
TVSH në kufi	741.2	1,013.6	37%	272.4	1) niveli më i lartë në të hyrat nga TVSH në kufi në vitin 2021, i cili përdoret për të vlerësuar të hyrat në 2022 dhe vitet pasardhëse; 2) rritja e presioneve inflacioniste për vitin 2022 dhe në periudhën afatmesme si rezultat i luftës në Ukrainë çon në arkëtim më të lartë të TVSH-së në kufi; 3) rritja e theksuar e investimeve kapitale, të cilët kanë përmbajtje të lartë importi; 4) norma efektive më e lartë e TVSH në kufi për vitin 2021, e cila përdoret për të parashikuar të hyrat në vitet vijuese.
TVSH vendore	291.8	414.1	42%	122.3	1) niveli më i lartë në të hyrat nga TVSH vendore në vitin 2021, i cili përdoret për të vlerësuar të hyrat në 2022 dhe vitet pasardhëse; 2) rritja e çmimeve vendore si rezultat i çmimeve të importeve dhe pritjet për vazhdim të këtyre presioneve deri në fund të vitit 2022; 3) rritja e bazës tatimore si rezultat i uljes së informalitetit; 4) norma efektive më e lartë e TVSH vendore për vitin 2021, e cila përdoret për të parashikuar të hyrat në vitet vijuese.
Tatimet Direkte	377.5	467.3	24%	89.8	1) efekti bazë si rrjedhojë e rritjes të theksuar të bazës tatimore për të hyrat nga TAK dhe TAP në 2022 që ka bërë që viti 2023 të ketë nivele më të larta të të hyrave nga këto dy tatime; 2) zgjerimi i bazës tatimore përmes uljës së informalitetit
Të hyrat jo-tatimore	249.0	280.0	12%	31.0	1) të hyrat jo-tatimore janë kryesisht më të larta për shkak të një zbatimi më dinamik të procesit të legalizimit të ndërtimeve pa leje dhe përmirësimit të përmbushjes së regjistrimit të automjeteve. 2) rritja është në linjë me aktivitetin ekonomik
Shpenzimet Totale Buxhetore	2,708.6	3,065.2	13%	356.6	
<i>nga të cilat</i>					

Paga dhe Shetesa	663.2	718.7	8%	55.5	<p>1) në KASH 2023-2025 është parashikuar vendosja e afër 19.8 milion Euro si kontigjencë në kategorinë Paga dhe Shetesa, në kuader të programit Kontigjenca në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve;</p> <p>2) është parashikuar rritja e kategorisë së pagave të Ministria e Shëndetësisë, këto mjete do të përdoren për pagesën e specializanteve;</p> <p>3) është rritur kategoria e pagave dhe shtesave të disa organizatave për të mbuluar obligimet e papaguara dhe punët jashtë orarit.</p>
Mallra dhe Shërbime	364.6	468.2	28%	103.6	<p>1) rritja e kategorisë së mallrave të Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë si rezultat i planifikimit për rritje të rezervave shtetërore dhe rritje të rezervave të naftës;</p> <p>2) rritja e kategorisë së mallrave të Ministria e Shëndetësisë si rezultat i planifikimit të blerjes së barnave (burimi i financimit huamarrja);</p> <p>3) rritja e kategorisë së mallrave dhe shërbimeve të Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës si rezultat i planifikimit të rritjes së shërbimeve për mirëmbajtje të rrugëve;</p> <p>4) rritja e kategorisë së mallrave dhe shërbimeve të Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve si rezultat i planifikimit të regjistrimit të popullsisë.</p>
Subvencione dhe Transfere	766.3	940.5	23%	174.2	<p>1) planifikimi i shpenzimeve në KASH-in aktual ka adresuar të gjitha mungesat në skemat sociale dhe është buxhetuar bazuar në nevojat për pagesa të këtyre skemave;</p> <p>2) zgjerimi i skemave sociale duke shtuar shtesat për lehona dhe shtesat për fëmijë;</p> <p>3) rritja e pensionit bazë nga 90 në 100 Euro.</p>
Shpenzimet Kapitale	849.0	916.7	8%	67.7	<p>1) Alokimi në Buxhet 2022 për pagesën e kostove të shpronësimeve, që do i hap rrugë ekzekutimit më të shpejtë të shpenzimeve kapitale;</p> <p>2) Funkcionalizimit të Bordit të Organit Shqyrtues të Prokurimit Publik.</p>
Interesi për Borxhin Publik	60.8	52.3	-14%	-8.5	<p>1) Supozimet për norma më të larta për instrumentet e Letrave me Vlere, duke pasur parasysh se gjatë pandemisë ka pasur tendencë për rritjen e tyre</p>

PJESA E TRETË

3. KORNIZA E SHPENZIMEVE SEKTORIALE 2023-2025 NË NIVEL QENDROR

Në vijim, në pjesën e tretë, do të paraqiten objektivat kryesorë sipas sektorëve të nivelit qendror. Janë paraqitur gjithsejtë 10 sektorë ku secili prej tyre ka të prezantuar trendin e financimit 2021-2022 dhe projeksionet buxhetore për periudhën e ardhshme trevjeçare 2023-2025. Në kuadër të secilit sektor janë të paraqitura edhe organizatat buxhetore sipas sektorëve përkatës.

Tabelat në pjesën e tretë paraqesin projeksionet për vitet 2023-2025 për buxhetin e përgjithshëm të Kosovës, në nivel qendror dhe sipas sektorëve. Në lidhje me projeksionet e shpenzimeve buxhetore për periudhën e ardhshme afatmesme 2023-2025, organizatat buxhetore duhet të kenë parasysh që mund të planifikojnë shpenzime brenda kufijve buxhetor të dhënë, vetëm pasi të mbulojnë detyrimet, kurse hapësirën e lirë fiskale mund ta shfrytëzojnë për prioritetet tjera.

Trendet e financimit 2021-2022 dhe vlerësimet 2023/2025 për nivelin e përgjithshëm

Buxheti i Përgjithshëm i Kosovës	Viti 2021 Shpenzimi	Viti 2022 Buxhetuar	Viti 2023 Vlerësuar	Viti 2024 Vlerësuar	Viti 2025 Vlerësuar
Total	2,217,963,033	2,735,749,613	2,962,771,219	3,101,333,048	3,191,083,775
Numri i punëtorëve	83,802	87,308	88,163	88,163	88,163
Paga dhe mëditje	666,039,073	670,946,904	695,257,941	718,726,745	724,053,551
Mallra dhe shërbime	298,386,443	372,876,251	442,544,998	434,483,899	448,347,870
Shpenzime komunale	25,085,963	30,895,773	33,172,705	33,732,705	34,232,706
Subvencione dhe transfere	847,840,904	894,520,233	947,378,381	940,532,013	934,714,728
Shpenzime kapitale	380,610,651	704,927,195	792,831,160	916,715,535	986,784,519
Rezerva	-	20,446,730	4,800,000	4,800,000	4,800,000
Interesi	-	41,136,527	46,786,034	52,342,152	58,150,401
Burimet e financimit					
Grantet qeveritare	2,106,373,188	2,379,462,848	2,595,000,244	2,755,907,780	2,782,925,280
Të hyrat vetanake	59,591,114	96,343,516	108,489,943	112,855,356	117,081,970
Financimi nga të hyrat e AKP-së	3,260,449	21,000,000	-	-	-
Te hyrat e dedikuara	4,230,730	4,499,888	5,064,073	4,438,423	4,452,553
Financimet nga huamarrjet	44,507,553	193,306,834	207,430,925	175,789,337	228,473,571
Financimi nga huamarrja - 04	28,666,323	80,588,526	64,700,263	19,364,560	15,020,134
Financimi nga Klauzola e investimeve -06	15,841,230	112,718,308	142,730,662	156,424,777	213,453,437
Grantet nga Donatorët *	1,329,506	2,316,443	1,446,175	663,502	762,361

* Grantet nga donatorët nuk janë pjesë e totalit të shpenzimeve sipas burimit të financimit

Trendet e financimit 2021-2022 dhe vlerësimet 2023/2025 për nivelin qendror

Buxheti i Nivelit Qendror	Viti 2021 Shpenzimi	Viti 2022 Buxhetuar	Viti 2023 Vlerësuar	Viti 2024 Vlerësuar	Viti 2025 Vlerësuar
Total	1,715,677,023	2,168,220,230	2,309,184,418	2,405,337,785	2,466,694,493
Numri i punëtorëve	39,498	42,904	43,071	43,071	43,071
Paga dhe mëditje	377,529,588	388,239,123	403,991,979	426,004,453	429,867,648
Mallra dhe shërbime	222,319,807	284,899,417	332,544,998	319,483,899	328,347,870
Shpenzime komunale	14,453,589	18,710,417	19,172,705	19,232,705	19,232,706
Subvencione dhe transfere	831,009,985	874,680,823	918,378,381	906,532,013	896,714,728
Shpenzime kapitale	270,364,053	554,333,923	583,510,321	676,942,564	729,581,140
Rezerva	-	6,220,000	4,800,000	4,800,000	4,800,000
Interesi		41,136,527	46,786,034	52,342,152	58,150,401
Burimet e financimit					
Grantet qeveritare	1,654,216,948	1,899,335,122	2,039,932,702	2,162,439,298	2,165,408,441
Të hyrat vetanake	9,461,343	8,941,859	9,970,684	10,328,575	10,209,526
Financimi nga të hyrat e AKP-së	3,260,449	21,000,000	-	-	-
Te hyrat e dedikuara	4,230,730	4,499,888	5,064,073	4,438,423	4,452,553
Financimet nga huamarrjet	44,507,553	193,306,834	207,430,925	175,789,337	228,473,571
Financimi nga huamarrja - 04	28,666,323	80,588,526	64,700,263	19,364,560	15,020,134
Financimi nga Klauzola e investimeve -06	15,841,230	112,718,308	142,730,662	156,424,777	213,453,437
Grantet nga Donatorët *	1,329,506	2,316,443	1,446,175	663,502	762,361

* Grantet nga donatorët nuk janë pjesë e totalit të shpenzimeve sipas burimit të financimit

Në vijim do të paraqiten secili sektorët veç e veç.

3.1. QEVERISJA E PËRGJITHSHME PUBLIKE

Synimet kryesore në kuadër të këtij sektori janë qeverisja e mirë, ngritje të efektivitetit dhe llogaridhënies, financa publike të qëndrueshme, zhvillim socio-ekonomik, avancim i proceseve integruese të vendit dhe fuqizimi i subjektivitetit ndërkombëtar.

Objektivat kryesorë gjatë periudhës së ardhshme trevjeçare 2023-2025 në kuadër të këtij sektori janë:

- Sigurimi i njohjeve të reja, forcimi i subjektivitetit ndërkombëtar të Republikës së Kosovës dhe zbatimi i kritereve në procesin e integritetit në BE dhe institucione ndërkombëtare;
- Ruajtja e qëndrueshmërisë makro-fiskale, menaxhim të përgjegjshëm të drejtë dhe transparent të fondeve publike, mbikëqyrjen e koordinimit të politikave fiskale dhe ekonomike, zhvillimi dhe përsosja e sistemit të vjeljes dhe administrimit të të hyrave tatimore dhe doganore, zvogëlimi i evazionit fiskal, ekonomisë joformale dhe shperlarjes së parasë;
- Avancimi i sistemit të prokurimit elektronik, rritjen e efijencës, efikasitetit si dhe transparencën e tenderimeve publike, trajtim të barabartë dhe vlerë për para, ngritja e cilësisë së menaxhimit të financave publike;
- Rritja e efikasitetit në auditim të brendshëm dhe të jashtëm;
- Parandalimi dhe luftimi i korrupsionit përmes mekanizmave parandalues të deklarimit të pasurisë, konfliktit të interesit dhe sinjalizimit;
- Ngritja e nivelit të cilësisë së shërbimeve publike për qytatarët dhe bizneset;

- Ndërlidhja më e qendrueshme e planifikimit të dokumenteve strategjike dhe resurseve;
- Zhvillimi i balancuar dhe rritja e bashkëpunimit ndërkomunal dhe ndërkufitar;
- Rritja e shërbimit të jashtëm profesional, rritje të pjesëmarrjes së pjesëtarëve të diasporës në diplomaci dhe zhvillim ekonomik, ruajtja e identitetit dhe kulturës së diasporës dhe angazhimi i pjesëtarëve të diasporës për promovimin e Kosovës në hapësirat ku ata jetojnë;
- Promovimi dhe mbrojtja e të drejtave të njeriut dhe sigurimi i barazisë gjinore përmes fuqizimit të gruas si dhe promovimi dhe mbrojtja e të drejtave të komuniteteve, dhe
- Siguria e ushqimit dhe ruajtja e shëndetit publik.

Sektorin e Qeverisë së Përgjithshme Publike e përbejnë: Kuvendi i Republikës së Kosovës, Zyra e Presidentit, Zyra e Kryeministrit, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve (përfshihen ndarjet buxhetore që kanë të bëjnë me ish Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale-MPMS), Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, Ministria e Zhvillimit Rajonal, Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, Agjencioni Kundër Korrupsionit, Organi Shqyrtues i Prokurimit, Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa, Agjencia për Informim dhe Privatësi, Zyra Kombëtare e Auditimit, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Gjykata Kushtetuese e Kosovës, si dhe Shpenzimet e Paparashikuara.

Trendet e financimit 2021 -2022 dhe vlerësimet 2023 -2025					
QEVERISJA E PËRGJITHSHME PUBLIKE	Viti 2021 Shpenzimi	Viti 2022 Buxhetuar	Viti 2023 Vlerësuar	Viti 2024 Vlerësuar	Viti 2025 Vlerësuar
Total	109,475,054	407,065,957	375,103,283	493,245,565	527,918,849
Nr. i punëtorëve	3,878	4,224	4,291	4,291	4,291
Pagat dhe Mëditjet	43,348,329	56,494,121	67,531,991	87,865,003	89,501,101
Mallrat dhe Shërbimet	37,875,279	71,023,952	67,399,822	52,731,618	58,239,106
Shpenzimet Komunale	1,162,403	2,210,346	2,390,346	2,390,346	2,390,347
Subvencionet dhe Transferet	18,845,245	147,923,085	128,076,672	107,214,304	87,897,086
Shpenzimet Kapitale	8,243,797	123,374,452	104,904,452	238,244,294	285,091,210
Rezerva	-	6,040,000	4,800,000	4,800,000	4,800,000
Burimet e Financimit					
Grantet qeveritare	109,414,572	321,232,171	304,269,797	401,467,679	381,758,163
Të hyrat vetanake	60,482	160,686	160,686	160,686	160,686
Të hyrat nga AKP-ja	-	21,000,000	-	-	-
Të hyrat e dedikuara	-	-	-	-	-
Financimet nga huamarrjet	-	64,673,100	70,672,800	91,617,200	146,000,000
Financimi nga huamarrja - 04	-	10,673,100	10,672,800	117,200	-
Financimi nga klauzola e investimeve - 06	-	54,000,000	60,000,000	91,500,000	146,000,000
Grantet nga donatorët*	505,032	2,301,731	1,437,463	654,790	753,649

* Grantet nga donatorët nuk janë pjesë e totalit të shpenzimeve sipas burimit të financimit

3.2 SEKTORI I MBROJTJES

Sektori i Mbrojtjes përbëhet nga shërbyesit civil të Ministrisë së Mbrojtjes (MM) dhe personeli ushtarak i Forcës të Sigurisë së Kosovës (FSK). Misioni i institucioneve në fjalë lidhet me hartimin dhe zbatimin e politikave të përgjithshme shtetërore të mbrojtjes. Kompetencat dhe funksionet e Ministrisë së Mbrojtjes janë të përcaktuara me Kushtetutën dhe ligjet në fuqi. Forca e Sigurisë së Kosovës është forcë ushtarake multietnike, profesionale, e armatosur dhe e autorizuar për të shërbyer në vend dhe jashtë vendit, në pajtim me kompetencat e dhëna kushtetuese dhe ligjore.

Bazuar në objektivat e parapara në Planin Gjithëpërfshirës të Tranzicionit (PGJT), Ministria e Mbrojtjes gjendet në vitin e katërt të tranzicionit (faza e dytë) e cila vazhdon me ngritjen e njësisve me prioritet dhe zhvillimin e aftësive të nevojshme për përmbushje të misionit kushtetues dhe ligjor.

Bashkëpunimi me partnerë do të konceptohet në funksion të kontribuimit në krijimin e një ambienti paqeje e stabiliteti në rajon dhe në botë, ri-modelimit të mënyrës së vepruarit dhe menduarit rreth çështjeve të forcimit të sigurisë, si dhe zgjerimit të kapaciteteve mbrojtëse të vendit. Bashkëpunimi Ndërkombëtar dhe Ushtarak do të synojë edhe më tutje zgjerimin e hartës së bashkëpunimit. bilateral dhe multilateral dhe kjo duhet të kthehet përfundimisht në një partneritet mbi bazën e në shërbim të rritjes dhe konsolidimit të kapaciteteve tona.

Situatës aktuale dhe zhvillimet e reja në mjedisin e sigurisë, Republika e Kosovës do t'i përgjigjet nëpërmjet politikave konkrete shtetërore të mbrojtjes dhe sigurisë, avancimit të marrëdhënieve me aleatët strategjikë dhe ndjekjes së rrugëve më të përshtatshme për arritjen e synimeve e objektivave në fushën e mbrojtjes, duke u bërë faktor paqeje e stabiliteti për rajon e më gjerë.

Ministria e Mbrojtjes dhe Forca e Sigurisë së Kosovës, bazuar në politikat e mbrojtjes së Republikës së Kosovës, Planet Zhvillimore, Programin e Qeverisë së Republikës së Kosovës; Strategjinë e Mbrojtjes, Qëllimet Strategjike dhe Objektivat Operacionalë të Ministrisë të Mbrojtjes 2021-2025, Planin Gjithëpërfshirës të Tranzicionit, Planin Afatmesëm dhe planet tjera në fuqi, me qëllim të implementimit të Planit Gjithëpërfshirës të Tranzicionit, do të zhvillojë, standardizojë dhe modernizojë aftësi dhe kapacitete për të siguruar pavarësinë e vendit, mbrojtjen e tërësisë territoriale, ndihmën ndaj popullsisë civile si dhe pjesëmarrjen në operacione ndërkombëtare.

Gjatë periudhës kohore 2023 – 2025, Ministria e Mbrojtjes dhe Forca e Sigurisë së Kosovës do të fokusohen: në harmonizimin dhe përmbushjen e objektivave të përcaktuara në dokumentet strategjike; unifikimin dhe realizimin e procesit të planifikim-programim, buxhetim dhe ekzekutimit; përmbushjen e detyrimeve të përcaktuara në Planin Gjithëpërfshirës të Tranzicionit; konsolidimin e sistemit të arsimimit dhe trajnimit; konsolidimin e sistemit për mbrojtje kibernetike si dhe rritjen e nivelit të aftësive të njësisve të FSK-së për të kontribuar në operacione brenda dhe jashtë vendit.

Objektivat strategjike të Sektorit të Mbrojtjes janë:

- Zhvillimi i kapaciteteve ushtarake në funksion të mbrojtjes së sovranitetit dhe integritetit territorial.
- Fuqizimi i mbikëqyrjes demokratike civile dhe rritja e llogaridhënies dhe transparencës.
- Zgjerimi i bashkëpunimit bilateral, anëtarësimi në organizata dhe pjesëmarrja në operacione ndërkombëtare.
- Mbajtja e kapaciteteve thelbësore në funksion të mbështetjes ushtarake autoriteteve civile.

- Plotësimi dhe avancimi i kornizës ligjore në fushën e mbrojtjes.
- Avancimi i bashkëpunimit ndërshtetëror për të arritur qasje në programet ndërshtetërore dhe ndërkombëtare për pajisjet ushtarake dhe blerjet nga fusha e sigurisë dhe mbrojtjes.

Sektorin e mbrojtjes e përben: Ministria e Mbrojtjes.

Trendet e financimit 2021 -2022 dhe vlerësimet 2023 -2025					
Mbrojtja	Viti 2021 Shpenzimi	Viti 2022 Buxhetuar	Viti 2023 Vlerësuar	Viti 2024 Vlerësuar	Viti 2025 Vlerësuar
Total	91,278,094	102,305,450	123,163,888	142,930,577	143,091,654
Numri i punëtorëve	3,695	4,879	4,879	4,879	4,879
Paga dhe mëditje	25,930,519	31,895,564	32,055,042	32,215,317	32,376,394
Mallra dhe shërbime	8,177,788	13,983,886	28,532,000	35,026,000	35,026,000
Shpenzime komunale	758,968	1,130,000	1,138,000	1,148,000	1,148,000
Subvencione dhe transfere					
Shpenzime kapitale	56,410,819	55,296,000	61,438,846	74,541,260	74,541,260
Rezerva					
Burimet e financimit					
Garantet qeveritare	91,278,094	102,305,450	123,163,888	142,930,577	143,091,654
Të hyrat vetanake					
Të hyrat nga AKP - 24			-		
Të hyrat e dedikuara					
Financimet nga huamarrjet	-	-	-	-	-
Financimi nga huamarrja - 04					
Financimi nga Klauzola e investimeve -06					
Grantet nga Donatorët *					

* Grantet nga donatorët nuk janë pjesë e totalit të shpenzimeve sipas burimit të financimit

3.3 RENDI, LIGJI DHE SIGURIA PUBLIKE

Misioni i Sektorit të Ligjit, Rendit dhe Sigurisë Publike është të përgatisë politika publike, akte ligjore dhe nënligjore dhe standarde të detyrueshme në fushën e drejtësisë në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi si dhe të sigurojë sistem të pavarur, të paanshëm profesional dhe efektiv të sistemit prokurorial dhe gjyqësor. Pjesë e këtij misioni është edhe sundimi i ligjit, siguria publike në tërë territorin e Republikës së Kosovës, si dhe avancimi dhe modernizimi i tërë administratës publike për t’iu shërbyer me efikasitet, transparencë, profesionalizëm dhe paanshmëri të gjithë qytetarëve, bizneseve dhe vetë institucioneve të Republikës së Kosovës.

Ministria e Drejtësisë si bartëse e sektorit të ligjit është zotuar të angazhohet që shteti i Kosovës të jetë shtet i së drejtës dhe sundimit të ligjit. Angazhim të veçantë Ministria e Drejtësisë do të tregojë në drejtim të formimit të një sistemi të qëndrueshëm ligjor i cili do të jetë i drejtë, i shpejtë, efikas, dhe i cili do të forcojë besimin e qytetarëve në institucionet e vendit dhe në sistemin e drejtësisë në përgjithësi.

Ministria e Drejtësisë do të udhëheq dhe zbatojë reforma në lëmin e sundimit të ligjit si dhe është duke zbatuar një varg masash në mënyrë që të ngritët efikasiteti, llogaridhënia dhe gjithë përfshirja në plotësimin e nevojave dhe prioritetëve të qytetarëve në lëmin e sundimit të ligjit. Kjo Ministri është e përkushtuar të përmbush obligimet që rrjedhin nga disa dokumente strategjike përfshirë

Programin e Qeverisë 2021-2025, Programin e Kosovës për Reforma në Ekonomi 2022-2024, Programin Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit, dhe Strategjia e Sundimit të Ligjit për vitet 2021-2026

Zbatimi i projektit të menaxhimit të lëndëve (SMIL), është në përmbyllje të fazës konsoliduese të projektit të financuar nga Ministria e Punëve të Jashtme të Norvegjisë. Si rezultat i zbatimit me sukses të fazave të mëhershme, donatori i projektit ka shprehur gatishmëri të vazhdimin të projektit edhe me një fazë tjetër. Kjo fazë quhet faza tranzitore e projektit të SMIL dhe është e fokusuar në ofrimin e asistencës për ngritjen e kapaciteteve për Këshillin Gjyqësor të Kosovës dhe Këshillin Prokurorial të Kosovës dhe për të siguruar qëndrueshmërinë e vënies në zbatim të tij në gjykata dhe prokurori.

Përveç aktiviteteve të lartpërmendura, në bashkëpunim me institucionet përkatëse të Sektorit të Sundimit të Ligjit dhe partnerët ndërkombëtare është hyrë në fazën përfundimtare të procesit të Rishikimit Funkcional të Sektorit të Sundimit të Ligjit. Ky proces ka për synim kryesor identifikimin e problemeve kryesore të cilat pengojnë funksionimin e mirëfilltë të sundimit të ligjit dhe rrjedhimisht, adresimin e tyre përmes masave të qarta dhe të mirë-menduara, të cilat do të arrijnë sigurimin e mbarëvajtjes së këtij sektori dhe ngritjen e besimit të qytetarëve në drejtësi.

Si pjesë e këtij sektori Këshilli Prokurorial i Kosovës si dhe Këshilli Gjyqësor i Kosovës si institucione kushtetuese dhe të pavarura në ushtrimin e funksioneve të veta sigurojnë që prokurorët dhe gjyqtarët të veprojnë në mënyrë të pavarur, profesionale dhe të paanshme gjatë kryerjes së të gjitha funksioneve.

Sektori i Sigurisë Publike ka implementuar me sukses politikat e saja në drejtim të përmbushjes së objektivave të parapara për vitin 2021. Parandalimi dhe luftimi i krimit, rritja dhe ruajtja e sigurisë publike, modernizimi i administratës publike si dhe forcimi i integritetit institucional kanë qenë prioritetet kryesore të Ministrisë së Punëve të Brendshme me qëllim të përmbushjes së këtyre objektivave është vazhduar dhe intensifikuar përpjekja në ngritjen e kapaciteteve në Policinë e Kosovës dhe Inspektoratin Policor përmes trajnimeve të ndryshme të specializuara dhe sigurimit të pajisjeve të avancuara për luftimin e këtyre dukurive.

Parandalimi dhe luftimi i terrorizmit, ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizmit - Policia e Kosovës vazhdon të adresojë në mënyrë strategjike, duke filluar prej bashkëpunimit në nivel lokal përmes Këshillave Komunale për Siguri në Bashkësi (KKS), Komitetet Lokale për Siguri Publike (KLSP), e deri te implementimi i strategjisë shtetërore kundër terrorizmit dhe planit të veprimit 2018-2023 dhe strategjisë kombëtare të Republikës së Kosovës për parandalimin dhe luftimin e ekonomisë joformale, pastrimin e parave, financimin e terrorizmit dhe krimeve financiare 2019-2023,

Ne lidhje me situatën aktuale Policia e Kosove është ballafaquar me shume aktivitete dhe angazhime ne zbatim të Ligjit nr. 07/L-006 për parandalimin dhe luftimin e pandemisë Covid-19 në territorin e Republikës së Kosovës. Janë angazhuar gjithsejtë 6,500 zyrtarë policorë të cilët kanë qenë të angazhuar në patrullimin parandalues në inspektimin e 20,634 qytetarëve të cilët kanë qenë në vet izolim në shtëpi; në përcjellje policore.

Ministria e Punëve të Brendshme ka zhvilluar Platformën qendrore për ofrimin e shërbimeve elektronike “eKosova” dhe Platformën e Interoperabilitetit. “eKosova” është lanuar dhe në të janë

duke u ofruar shërbime elektronike në mënyrë të centralizuar për qytetarët, bizneset dhe vetë administratën, ndërsa e dyta mundëson ndërlidhjen e sigurtë të sistemeve elektronike të institucioneve të Republikës së Kosovës dhe shkëmbimin e të dhënave ndërmjet këtyre sistemeve në kohë reale. Në Platformën e Interoperabilitetit janë integruar disa module siç janë: TAX office, Regjistri i Adresave për tu përdorur nga Agjencioni për Rexhistrimin Civil dhe Agencionin për Rexhistrimin e Bizneseve në Kosovë, certifikata e trungut familjar dhe vërtetimi i gjendjes civile.

Objektivat kryesorë strategjik të sektorit të rendit, ligjit dhe sigurisë publike janë:

- Rishikimi FunkSIONAL i Sektorit të Sundimit të Ligjit;
- Vetingu në sistemin e drejtësisë;
- Luftimi i krimit të organizuar dhe korrupsionit;
- Adresimi i krimeve kundër njerëzimit dhe vlerave të mbrojtura me të drejtë ndërkombëtar;
- Parandalimi dhe luftimi i dhunës në familje, dhunës ndaj grave dhe dhunës në baza gjinore;
- Parandalimi, lufta kundër krimit të organizuar, korrupsionit dhe terrorizmit si dhe menaxhimi efikas i migrimit dhe kontrollit kufitar;
- Ruajtja e sigurisë publike dhe përmirësimi i shërbimeve për qytetarët;
- Ngritja e vazhdueshme e kapaciteteve të inteligjencës paralajmëruese dhe parandaluese të AKI-së për të shmangur kërcënimet e sigurisë globale ndaj sigurisë kombëtare;
- Forcimi i integritetit, zhvillimi institucional dhe modernizimi i administratës publike;
- Përmirësimi i infrastrukturës kapitale të agjencive të MPB-së dhe ngritja e nivelit të cilësisë së shërbimeve publike;
- Ngritja e vetëdijes së qytetarëve për shërbimet që ofrohen nga Agjencia për Ndihmë Juridike Falas;
- Mbrojtja dhe mbikëqyrja e të drejtave dhe e lirisë themelore të njeriut përmes ndikimit të shtuar të Institucionit të Avokatit të Popullit.

Sektorin për Rend, Ligj dhe Siguri e përbëjnë: Ministria e Drejtësisë, Ministria e Punëve të Brendshme, Këshilli Prokurorial i Kosovës, Këshilli Gjyqësor i Kosovës, Agjencia Kosovare e Intelgjences, Agjencia për Ndihmë Juridike, Avokati i Popullit.

Trendet e financimit 2021 -2022 dhe vlerësimet 2023 -2025					
Rendi, Ligji dhe Siguria Publike	Viti 2021 Shpenzimi	Viti 2022 Buxhetuar	Viti 2023 Vlerësuar	Viti 2024 Vlerësuar	Viti 2025 Vlerësuar
Total	232,056,668	263,600,574	274,145,326	277,389,263	279,385,894
Numri i punëtorëve	15,505	16,526	16,526	16,526	16,526
Paga dhe mëditje	149,776,894	151,309,328	152,565,875	153,326,203	154,592,834
Mallra dhe shërbime	40,970,079	48,495,326	53,690,282	54,694,391	55,694,391
Shpenzime komunale	5,774,432	6,671,049	6,690,799	6,740,799	6,740,799
Subvencione dhe transfere	9,446,477	10,069,367	10,189,367	10,189,367	10,189,367
Shpenzime kapitale	26,088,786	47,025,504	51,009,003	52,438,503	52,168,503
Rezerva	-	30,000	-	-	-
Burimet e financimit					
Garantet qeveritare	229,497,874	261,042,495	271,587,247	274,831,184	276,827,815
Të hyrat vetanake	2,558,794	2,558,079	2,558,079	2,558,079	2,558,079
Të hyrat nga AKP-ja	-	-	-	-	-
Të hyrat e dedikuara	-	-	-	-	-
Financimet nga huamarrjet	-	-	-	-	-
Financimi nga huamarrja - 04	-	-	-	-	-
Financimi nga Klauzola e investimeve -06	-	-	-	-	-
Grantet nga Donatorët *	-	-	-	-	-

* Grantet nga donatorët nuk janë pjesë e totalit të shpenzimeve sipas burimit të financimit

3.4. ÇËSHTJET EKONOMIKE

Përmes këtij sektori synohet përmirësimi i mjedisit të të bërit biznes, përmirësimi i infrastrukturës ekonomike, orientimi drejt transformimit digjital si dhe përkrahja e bujqësisë dhe zhvillimit rural, me qëllim rritjen e zhvillimit ekonomik dhe mirëqenies së qytetarëve.

Lidhur me gjendjen aktuale të këtij sektori mund të thuhet se fusha e energjisë përcillet me sfida që duhet të adresohen me politika që kanë në fokus furnizimin e qëndrueshëm më energji me çmim të përballueshëm dhe pa e dëmtuar ambientin. Në anën tjetër industria e Teknologjisë Informative dhe Komunikuese (TIK) po shënon rritje çdo vit sidomos në eksportin e shërbimeve të teknologjisë informative. Është duke u punuar në avancimin e politikave tregtare dhe përmirësimin e infrastrukturës së cilësisë, përfshirë edhe mbrojtjen e konsumatorit, mbrojtjen e pronësisë industriale dhe avancimin e mbikëqyrjes së tregut. Po ashtu, janë realizuar projekte të infrastrukturës rrugore në lëmin e ndërtimit dhe rehabilitimit të rrugëve, mirëmbajtje e rrugëve dhe sinjalizim i rrugëve nacionale dhe rajonale. Sa i përket fushës së bujqësisë, Qeveria e Kosovës ka vazhduar me përkrahjen e vazhdueshme të bujqësisë dhe zhvillimit rural, ku ndër tjerash në fund të vitit 2021 ka miratuar Strategjinë për Bujqësi dhe Zhvillim Rural 2022-28 dokument i cili do të shërbejë si udhërrëfyes për zhvillimin e sektorit agro-rural.

Objektivat kryesorë në kuadër të sektorit për periudhën e ardhme trevjeçare janë:

- Sigurimi i furnizimit të qëndrueshëm me energji, diversifikimi i burimeve energjetike, rritja e efikasitetit të energjisë, shfrytëzimi maksimal i burimeve të ripërtëritshme të energjisë si dhe krijimi i politikave për zhvillim të qëndrueshëm të sektorit mineral;
- Krijimi i një mjedisi stabil për investime në sektorin e energjisë si dhe të mundësuarit e një kornize të duhur për zhvillim të konkurrencës dhe kushteve jo-diskriminuese të qasjes në sistemet e transimit dhe shpërndarjes;

- Përmirësimi i mjedisit të biznesit, zhvillimi i konkurrueshmërisë në sektorin privat si dhe përmirësimi i infrastrukturës së standardeve dhe cilësisë përfshirë mbrojtjen e konsumatorit;
- Zhvillimi i politikave industriale e tregtare si dhe nxitja, promovimi dhe përkrahja e investimeve të huaja;
- Zhvillimi i infrastrukturës brezgjere dhe kapitalit njerëzor në mënyrë që TIK të bëhet nxitës kryesor i rritjes ekonomike dhe punësimit si dhe rritja e konkurrueshmërisë ndërkombëtare në industrinë e TIK-ut;
- Zhvillimi i ndërmarrësisë dhe inovacionit;
- Hartimi i politikave dhe kornizës ligjore për Ndërmarrjet Publike, me qëllim rritjen e vlerës, reformimin, strukturimin dhe ngritjen e nivelit të shërbimeve publike për qytetarët;
- Rritja e konkurrencës së sektorit agro-ushqimor dhe përmirësimi i efikasitetit dhe qëndrueshmërisë së prodhimit të fermave për kultura bujqësore;
- Mënaxhimi i qëndrueshëm i resurseve natyrore (ujit, tokës dhe pyjeve);
- Mbështetja e bizneseve në zonat rurale në rritjen e punësimit dhe përmirësimin të infrastrukturës sociale;
- Integrimi i Republikës së Kosovës brenda rrjetit rajonal rrugor nëpërmjet zhvillimit të Rrugës 6 & 7 përgjatë korridoreve pan-evropiane, duke e kthyer nga një vend i izoluar në një vend tranzit për transportin e Evropës Juglindore;
- Ngritja e sigurisë dhe efikasitetit në ofrimin e shërbimeve në mënaxhimin e trafikut ajror.

Sektorin për çështje ekonomike e përbëjnë: Ministria e Industrisë Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (ndarjet që kanë të bëjnë me çështjet ekonomike-Infrastruktura), Ministria e Ekonomisë, Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Zyra Rregullative e Energjisë, Autoriteti Rregullativ për Komunikime Elektronike dhe Postare, Autoriteti Kosovar i Konkurrencës, Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave, Autoriteti i Aviacionit Civil, Agjensioni për Shërbimet e Navigacionit Ajror, Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale dhe Agjensioni Kosovar i Privatizimit.

Trendet e financimit 2021 -2022 dhe vlerësimet 2023 -2025					
Çështjet Ekonomike	Viti 2021 Shpenzimi	Viti 2022 Buxhetuar	Viti 2023 Vlerësuar	Viti 2024 Vlerësuar	Viti 2025 Vlerësuar
Total	282,915,826	286,031,366	358,008,190	306,967,782	327,062,996
Numri i punëtorëve	1,678	1,926	1,926	1,926	1,926
Paga dhe mëditje	18,645,143	18,255,753	18,355,668	18,448,457	18,540,700
Mallra dhe shërbime	21,535,012	29,581,486	53,879,378	48,908,293	52,392,519
Shpenzime komunale	528,174	1,011,830	1,064,568	1,064,568	1,064,568
Subvencione dhe transfere	132,579,767	79,604,323	92,738,706	89,019,706	90,019,706
Shpenzime kapitale	109,627,730	157,577,975	191,969,870	149,526,758	165,045,503
Rezerva	-	-	-	-	-
Burimet e financimit					
Garantet qeveritare	261,752,866	204,406,589	275,401,779	259,303,204	264,108,543
Të hyrat vetanake	145,434	183,155	183,155	183,155	183,155
Të hyrat nga AKP - 24	-	-	-	-	-
Të hyrat e dedikuara	4,230,730	4,499,888	5,064,073	4,438,423	4,452,553
Financimet nga huamarrjet	16,786,796	76,941,734	77,359,183	43,043,000	58,318,745
Financimi nga huamarrja - 04	8,058,345	33,943,426	21,364,960	1,443,000	1,200,000
Financimi nga Klauzola e investimeve -06	8,728,451	42,998,308	55,994,223	41,600,000	57,118,745
Grantet nga Donatorët *	-	-	-	-	-

* Grantet nga donatorët nuk janë pjesë e totalit të shpenzimeve sipas burimit të financimit

3.5. MJEDISI

Në kuadër të këtij sektori synohet mbrojtja dhe monitorimi i mjedisit, ujit si dhe zhvillimi e fuqizimi i planifikimit hapësinor, ndërtimit, banimit, kadastrës dhe shpronësimit në nivel nacional.

Kosova ballafaqohet me problemet e menaxhimit të ujit, të mbeturinave, ndotjes së ajrit dhe tokës. Problemet tjera të mjedisit shkaktohen nga zhvillimet e paplanifikuara hapësinore dhe ndërtimet pa leje të cilat dëmtojnë hapësirën dhe ulin mundësitë për zhvillimin e ardhshëm të vendit.

Në funksion të përmirësimit të gjendjes së mjedisit dhe parandalimit të degradimit të mëtutjeshëm, Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës ka përgaditur legjislacionin i cili është i përafuar me direktivat e BE –së si dhe ka hartuar strategji dhe plane të veprimit për secilin komponent mjedisor si: Ajri, Biodiverziteti, Ndryshimet Klimatike dhe Menaxhimi i Integruar i Mbeturinave.

Për sa i përket periudhës së ardhshme, Qeveria synon të ndërmarr veprime konkrete për përmirësimin e gjendjes aktuale. Objektivat kryesorë të sektorit të mjedisit janë:

- Kompletimi i infrastrukturës ligjore në fushën e mjedisit dhe harmonizimi i tyre me legjislacionin e BE-së dhe zbatimin e saj;
- Përmirësimi i gjendjes së mjedisit dhe monitorimi i gjendjes së tij;
- Krijimi i sistemit administrativ efikas për planifikim hapësinor, ndërtim, banim, efijencë të energjisë në ndërtesa dhe kadastrë;
- Administrimi dhe menaxhimi më i mirë i resurseve ujore dhe rehabilitimi i shtretërve të lumenjve dhe menaxhimi i mbeturinave;

- Fuqizimi i inspektoriatit mjedisor, ujërave, natyrës, planifikimit hapësinor, banimit dhe ndërtimit;
- Avancimi i politikave tarifore, ngritja e standardeve të shërbimit të ujit dhe zvogëlimi i humbjeve të ujit.

Sektorin e Mjedisit e përben pjesa e Mjedisit e cila është në kuadër të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës si dhe Autoriteti Rregullativ i Shërbimeve të Ujit.

Trendet e financimit 2021 -2022 dhe vlerësimet 2023 -2025					
Mjedisi	Viti 2020 Shpenzimi	Viti 2021 Buxhetuar	Viti 2022 Vlerësuar	Viti 2023 Vlerësuar	Viti 2024 Vlerësuar
Total	30,350,921	90,158,476	85,229,771	69,784,122	53,321,655
Numri i punëtorëve	316	329	329	329	329
Paga dhe mëditje	1,747,891	2,284,143	2,357,060	2,368,845	2,380,689
Mallra dhe shërbime	1,193,904	2,884,592	8,900,812	7,988,779	4,504,553
Shpenzime komunale	10,844	97,803	97,803	97,803	97,803
Subvencione dhe transfere	25,000	200,000	200,000	200,000	200,000
Shpenzime kapitale	27,373,283	84,691,938	73,674,096	59,128,695	46,138,610
Rezerva	-	-	-	-	-
Burimet e financimit					
Garantet qeveritare	30,254,896	77,518,476	54,246,368	40,704,985	41,216,829
Të hyrat vetanake	-	-	-	-	-
Financimi nga të hyrat e AKP-së	-	-	-	-	-
Të hyrat e dedikuara	-	-	-	-	-
Financimet nga huamarrjet	96,025	12,640,000	30,983,403	29,079,137	12,104,826
Financimi nga huamarrja - 04	96,025	800,000	6,096,964	5,854,360	1,870,134
Financimi nga Klauzola e investimeve -06	-	11,840,000	24,886,439	23,224,777	10,234,692
Grantet nga Donatorët *	-	-	-	-	-

* Grantet nga donatorët nuk janë pjesë e totalit të shpenzimeve sipas burimit të financimit

3.6 ÇËSHTJET E BANIMIT DHE KOMUNITETIT

Në kuadër të këtij sektori synohet krijimi i kushteve për kthim të qëndrueshëm të zhvendosurve, mbrojtja, integrimi dhe zhvillimi i komuniteteve që jetojnë në Kosovë, si dhe të pranoj, krahasoj të zgjidh dallimet dhe mos pajtueshmëritë në mes të dokumenteve kadastrale origjinale të para qershorit të vitit 1999 të cilat janë marrë nga autoritetet serbe, dhe të dokumenteve kadastrale aktuale në Republikën e Kosovës.

Për sa i përket këtij sektori, objektivat kryesorë për periudhën e ardhshme trevjeçare janë:

- Kthimi, riintegrimi në Kosovë dhe ndërtimi i infrastrukturës së nevojshme për funksionimin normal të të kthyerve;
- Stabilizimi i komuniteteve dhe mbyllja e qendrave kolektive në Kosovë;

- Pranimi, krahasimi dhe zgjidhja e dallimeve në mes të dokumenteve kadastrale të marra nga autoritetet e Serbisë dhe dokumenteve aktuale kadastrale në Kosovë për pronën private, komerciale dhe bashkësive fetare;
- Zbatimin e vendimeve të Komisionit të Kërkesave Pronësore të Kosovës dhe vendimeve të Gjykatës Supreme, rrënimin e strukturave të paligjshme në pronat private dhe administrimin e skemës së qirasë;
- Adresimi i informalitetit, përkatësisht njohja dhe formalizmi i të drejtave pronësore të pakontestuara dhe legjitime të bartura në mënyrë joformale para 24 mars 1999.

Këto objektiva do të arrihen përmes ndërmarrjes së veprimeve konkrete: ndërtimin e shtëpive për të kthyerit, ndërtimin e ndërtesave banesore kolektive, ndërtimin e shkollave dhe qendrave shëndetësore, ndërtimin e rrugëve dhe sistemeve të ujitjes e kanalizimit, etj.

Sektorin për çështjet e banimit dhe komuniteteve e perbejnë: Ministria për Komunitete dhe Kthim, Agjencia Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronave.

Trendet e financimit 2021 -2022 dhe vlerësimet 2023 -2025					
Çështjet e Banimit dhe Komunitetit	Viti 2021 Shpenzimi	Viti 2022 Buxhetuar	Viti 2023 Vlerësuar	Viti 2024 Vlerësuar	Viti 2025 Vlerësuar
Total	6,128,210	6,951,227	6,967,708	6,824,408	6,841,022
Numri i punëtorëve	292	321	321	321	321
Paga dhe mëditje	1,816,867	1,999,597	2,016,078	2,026,126	2,036,257
Mallra dhe shërbime	783,664	1,114,607	1,114,607	961,259	967,742
Shpenzime komunale	45,350	105,523	105,523	105,523	105,523
Subvencione dhe transfere	415,579	300,000	300,000	300,000	300,000
Shpenzimet kapitale	3,066,749	3,431,500	3,431,500	3,431,500	3,431,500
Rezerva	-	-	-	-	-
Burimet e financimit					
Garantet qeveritare	6,128,210	6,951,227	6,967,708	6,824,408	6,841,022
Të hyrat vetanake	-	-	-	-	-
Financimi nga të hyrat e AKP-së	-	-	-	-	-
Të hyrat e dedikuara	-	-	-	-	-
Financimet nga huamarrjet	-	-	-	-	-
Financimi nga huamarrja - 04	-	-	-	-	-
Financimi nga Klauzola e investimeve -06	-	-	-	-	-
Grantet nga Donatorët *	-	-	-	-	-

* Grantet nga donatorët nuk janë pjesë e totalit të shpenzimeve sipas burimit të financimit

3.7. SHËNDETËSIA

Në kuadër të këtij sektori synohet ruajtja e shëndetit, promovimi i mënyrave të shëndetshme të jetesës dhe ofrimi i shërbimeve cilësore të sigurta, me qasje të lehtë, të barabartë, pa rrezik financiar dhe kosto-efektive.

Sektori i Shëndetësisë në vitin 2021 është fokusuar tërësisht në menaxhimin e pandemisë COVID-19 me qëllim të ruajtjes së shëndetit të qytetarëve të Republikës së Kosovë, fuqizimin e kapaciteteve diagnostikuese me theks në fuqizimin e kapaciteteve e laboratorëve mikrobiologjike për testim të RT PCR si dhe kapaciteteve për ofrimin e shërbimeve cilësore shëndetësore.

Fillimisht janë siguruar sasitë e nevojshme të vaksinave përmes kontratës bilaterale me Pfizer prej 1.2 milion vaksinave, vaksinat donacion përmes COVAX për 20% të popullatës si dhe donacione tjera. Në tërësi janë siguruar mbi 2.2 milion vakcina. Gjatë vitit 2021 janë administruar 1,660,446 vakcina, ndërsa aktualisht ky numër ka arritur në 1,820,308. Procesi i vaksinimit ka vazhduar dhe po përcillet me fushata dhe kampanja publike.

Sa i përket hartimit të politikave dhe dokumenteve strategjike, Qeveria e Kosovës ka miratuar Strategjinë shtetërore për parandalim, menaxhim dhe kontrollim të pandemisë COVID-19, ku janë të përfshira edhe Planet e tjera shtesë si, Plani i veprimit për vaksinimin në masë të qytetarëve me vaksinën kundër COVID-19 i përditësuar, Plani i veprimit për shëndetin mendor gjatë dhe pas pandemisë COVID-19, Plani i veprimit për ofrimin e shërbimeve shëndetësore në rrethana fushore gjatë pandemisë për pacientët me COVID-19 në kujdesin parësor shëndetësor si dhe Plani i veprimit për zbatimin e procedurave të testimit me COVID-19.

Në Shërbimin Spitalor Klinik Univerzitar të Kosovës (SHSKUK) në periudhën e punës në vitin 2021, edhe përkunder situatës së pandemisë u ofruan 6.5 milion shërbime, 742,994 të shërbimeve ishin ditë shërimi në nivel të Kosovës, me gjithsej 145,567 pacientë të shtrirë. Janë realizuar 33,666 operime në nivel të SHSKUK-së. Shërbime ambulantore ishin 1,223,415. Ndërsa shërbime (parametra) laboratorike janë 3,789,875 për 562,349 pacientë. Numri i lindjeve në SHSKUK arrinë numrin e 19,682 lindjeve të realizuara në të gjitha njësitë e SHSKUK-së. Dializa janë realizuar 117,431, ndërsa mesatarja e ditëve të shërimit për pacient ishte 5.1 ditë. Shfrytëzimi mesatar i kapaciteteve në SHSKUK është 51%.

Ministria e Shëndetësisë ka filluar procedurat për anëtarësim në “EU Digital Green Certificate” që mundëson lëvizjen e qytetarëve në vendet e BE-së. Dy module shtesë (test negativ dhe shërim nga COVID-19) mbesin në proces të zhvillimit së bashku me modulën e vaksinimit për të qenë plotësisht në përputhje me certifikatën digjitale të BE-së.

Në kujdesin parësor shëndetësor kanë vazhduar aktivitete në fuqizimin e kapaciteteve njerëzore në kuadër të programit specialistik të Mjekësisë familjare, si dhe ngritja profesionale përmes edukimit të vazhdueshëm profesional.

Objektivat strategjikë në këtë sektor janë:

- Parandalimi, menaxhimi dhe kontrollimi i pandemisë COVID-19,
- Mbrojtja e shëndetit dhe përmirësimi i cilësisë së shërbimeve të ofruara shëndetësore,
- Riorganizimi i sektorit shëndetësor dhe

- Sigurimi i financimit të qëndrueshëm shëndetësor.

Për arritjen e këtyre objektivave, do të ndërmerren veprime të tilla si krijimi dhe funksionalizimi i sistemit elektronik për mbikëqyrje të COVID-19, ofrimi i shërbimeve të shëndetit mendor për të prekurit nga COVID 19, përmirësimi i shërbimeve shëndetësore të arritshme dhe të barabarta, plotësimi-ndryshimi i kornizës ligjore, plotësimi i kornizës ligjore për Sigurim Shëndetsor, shtrirja dhe funksionalizimi i sistemit unik dhe të integruar të informimit shëndetësor, planifikimi dhe fuqizimi i burimeve njerëzore në sektorin e shëndetësisë përmes hartimit të planit për burime njerëzore, ngritja e infrastrukturës, pajisjeve mjekësore dhe mirëmbajtja e tyre, hartimi i politikave shëndetësore, përmirësimi i shërbimeve për grupet e cenushme të shoqërisë, avancimi i konceptit të mjekësisë familjare, rrjetëzimi i mjekëve kosovarë në mërgatë dhe ndërlidhja me organizatat dhe odat e profesionistëve shëndetësorë përmes programit të shkëmbimit të profesionistëve, fuqizimi i kapaciteteve në përballje me sëmundjet kronike jo ngjitëse dhe sëmundje të rralla, rritja e bashkëpunimit regional dhe ndërkombëtar.

Sektorin e Shëndetësisë e përbejnë: Ministria e Shëndetsisë, Shërbimi Spitalor Klinik Univerzitar i Kosovës si dhe Fondi i Sigurimeve Shëndetësore .

Trendet e financimit 2021 -2022 dhe vlerësimet 2023 -2025					
Shëndetësia	Viti 2021 Shpenzimi	Viti 2022 Buxhetuar	Viti 2023 Vlerësuar	Viti 2024 Vlerësuar	Viti 2025 Vlerësuar
Total	205,850,576	198,182,842	206,017,200	207,780,180	210,003,418
Numri i punëtorëve	8,400	8,771	8,771	8,771	8,771
Paga dhe mëditje	85,577,246	72,414,131	74,276,202	74,647,584	75,020,822
Mallra dhe shërbime	81,493,910	91,371,442	91,321,929	91,353,527	91,703,527
Shpenzime komunale	3,805,518	3,853,964	3,855,764	3,855,764	3,855,764
Subvencione dhe transfere	23,357,251	10,083,805	12,313,805	10,813,805	10,813,805
Shpenzime kapitale	11,616,651	20,459,500	24,249,500	27,109,500	28,609,500
Rezerva	-	-	-	-	-
Burimet e financimit	-	-	-	-	-
Garantet qeveritare	173,660,791	164,764,069	189,101,661	204,480,180	206,703,418
Të hyrat vetanake	2,161,532	2,761,773	3,300,000	3,300,000	3,300,000
Të hyrat nga AKP - 24	3,260,449	-	-	-	-
Të hyrat e dedikuara	-	-	-	-	-
Financimet nga huamarrjet	26,767,805	30,657,000	13,615,539	-	-
Financimi nga huamarrja - 04	19,655,026	27,047,000	12,565,539	-	-
Financimi nga Klauzola e investimeve -06	7,112,779	3,610,000	1,050,000	-	-
Grantet nga Donatorët *	-	-	-	-	-

* Grantet nga donatorët nuk janë pjesë e totalit të shpenzimeve sipas burimit të financimit

3.8 REKREACIONI, KULTURA DHE RELIGJIONI

Në kuadër të këtij sektori synohet krijimi dhe zhvillimi i politikave, ambientit dhe mekanizmave të përshtatshëm për promovimin dhe rritjen e aktiviteteve sportive, kulturore dhe rinore, evidencimin, vlerësimin, mbrojtjen e trashëgimisë kulturore, promovimin dhe mbrojtjen e të drejtës së autorit dhe të drejtave të përafërta si dhe rregullimin, menaxhimin dhe mbikëqyrjen e spektrit të frekuencave të transmetimit.

Gjatë vitit 2021 edhe përkundër masave të pandemisë Kosova është prezantuar në Ekspozitën e 17 Ndërkombëtare të Arkitekturës në Bienalen e Venedikut, pjesëmarrja në Festalet Ndërkombëtare të Filmit: në Cannes, në Berlin, pjesëmarrja në panairt e librit, si dhe në festalet tjera të filmit, muzikës e ngjarjeve tjera kulturore në botë. Me rëndësi të theksohet është edhe pjesëmarrja e Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve në bashkëfinancimin me komunën e Prishtinës në “Manifesta 14”. Në kuadër të sportit Kosova ka qenë pjesëmarrëse për herë të dytë në Lojërat Olimpikë në TOKIO 2021, të cilët sportistë të xhudos morën 2 medalje të arta duke u vlerësuar sporti i xhudosë së Kosovës si storie e suksesit në botë, si dhe arritja e normave për pjesëmarrjen në Lojërat Olimpikë dimërore „Pekin 2022”. Në infrastrukturën fizike sportive dhe kulturore janë realizuar mbi 60 projekte, në trashëgimin kulturore janë ndërmarrë zbatimi i Intervenimeve Emergjente, Masave Preventive në mbi 40 objekte. Në Skema të shkathtësive, në ndërmarrësi dhe në programin e zhvillimeve profesionale janë trajnuar rreth 750 të rinj në përputhje me nevojat e tregut të punës. Janë mbështetur 20 biznese fillestare start-up dhe 60 projekte start-up me spin-off projekte. Në kuadër të thirrjes publike për subvencionim të OJQ-ve janë mbështetur mbi 30 projekte.

Objektivat kryesorë të Sektorit Rekreacioni, Kultura dhe Religjioni janë:

- Mbështetja e kulturës së pavarur, avancimi i diplomacisë kulturore dhe përkrahja e veprimtarisë botuese;
- Zhvillimin e politikave, programeve e masave që nxisin organizimin përmbajtësor, standardizimin e infrastrukturës sportive, zhvillimin e kuadrove, për pjesëmarrje dhe prezantim të suksesshëm të sportit në Kosovës dhe në arenën ndërkombëtare;
- Masivizimin e pjesëmarrjes në aktivitete sportive si përqindje e popullsisë tonë, me theks të veçant tek të rinjtë me programin shtetëror për identifikimin dhe zhvillimin e talenteve;
- Avancimi i sistemit ligjor dhe institucional i mbrojtjes së trashëgimisë në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, ligjet tjera relevante si dhe angazhimet karshi Prioriteteve të Partneritetit Evropian dhe anëtarësimit në UNESCO;
- Ruajtja dhe menaxhimi efektiv i aseteve të trashëgimisë kulturore si parakusht për zhvillim të qëndrueshëm, avancimin e programit për intervenime emergjente, mirëmbajtje e vazhdueshme dhe monitorimin e tyre;
- Edukimi, promovimi i trashëgimisë kulturore dhe ndërgjegjësimi qytetar, studimi dhe interpretimi objektiv dhe inkluziv i vlerave socio-kulturore dhe ekonomike përmes rritjes së numrit të botimeve, guidave, medimeve virtuale e digjitale;
- Krijimi, pasqyrimi, mbrojtja, klasifikimi, përpunimi, shfrytëzimi dhe ruajtja e dokumentacionit arkivor me vlerë historike e shkencore;

- Projektim, ndërtim dhe mirëmbajtje të komplekseve memoriale;
- Aktivizimi dhe mobilizimi i të rinjve për pjesëmarrje e përfaqësim aktiv, përgatitja e të rinjve për treg të punës dhe ofrimi i një mjedisi të shëndoshë dhe të sigurtë për të rinjtë;
- Rregullimi, menaxhimi dhe mbikëqyrja e spektrit të frekuencave të transmetimit;
- Digjitalizimi në RTK dhe implementimi i transmetimit tokësor televiziv digjital.

Sektorin e rekreacionit, kulturës dhe religjionit e përbejnë Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturorë, Agjencioni për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale, Komisioni i Pavarur i Mediave si dhe Radio-Televizioni i Kosovës.

Trendet e financimit 2021 -2022 dhe vlerësimet 2023 -2025					
Rekreacioni, Kultura dhe Religjioni	Viti 2021 Shpenzimi	Viti 2022 Buxhetuar	Viti 2023 Vlerësuar	Viti 2024 Vlerësuar	Viti 2025 Vlerësuar
Total	47,228,452	55,179,479	66,089,742	65,999,169	67,570,026
Numri i punëtorëve	781	860	860	860	860
Paga dhe mëditje	5,542,322	6,070,555	6,140,908	6,171,414	6,242,271
Mallra dhe shërbime	3,564,345	3,493,916	4,033,826	4,112,747	4,112,747
Shpenzime komunale	341,361	498,458	498,458	498,458	498,458
Subvencione dhe transfere	28,652,344	19,176,550	21,326,550	21,776,550	22,276,550
Shpenzimet kapitale	9,128,081	25,940,000	34,090,000	33,440,000	34,440,000
Rezerva	-	-	-	-	-
Burimet e financimit					
Grantet qeveritare	47,211,213	55,115,089	66,003,652	65,905,079	67,469,936
Të hyrat vetanake	17,239	64,390	86,090	94,090	100,090
Të hyrat nga AKP-ja	-	-	-	-	-
Të hyrat e dedikuara	-	-	-	-	-
Financimet nga huamarrjet	-	-	-	-	-
Financimi nga huamarrja - 04	-	-	-	-	-
Financimi nga klauzola e investimeve - 06	-	-	-	-	-
Grantet nga donatorët*	-	-	-	-	-

* Grantet nga donatorët nuk janë pjesë e totalit të shpenzimeve sipas burimit të financimit

3.9. ARSIMI

Në kuadër të këtij sektori synohet krijimi i një shoqërie të bazuar në dije dhe shkathtësi konkurruese, e integruar në rrjedhat evropiane, me mundësi të barabarta për avancimin e secilit individ që të përgatiten e të kontribuojnë në zhvillimin e qëndrueshëm shoqëror, ekonomik dhe politik në vend. Kosova si shoqëri demokratike ofron mundësi të barabarta për zhvillim personal të të gjithë qytetarëve, ku qasja në përfitim të dijës, hulumtimeve shkencore, drejtësisë dhe të përfitimit të shkathtësive, janë në funksion zhvillimit të përshpejtuar të shoqërisë sonë dhe aftësive konkurruese brenda dhe jashtë Kosovës në përputhje me standardet ndërkombëtare.

Sektori i arsimit ka përgjegjësi shtetërore dhe qytetare në edukimin e mirëfilltë për t'i përgatitur si qytetarë të denjë dhe të dobishëm për vendin.

Në vitin 2021 sektori arsimit është ballafaquar me vështirësi të shumta, gjendja e pandemisë ndërroi rrjedhën normale në realizimin e aktiviteteve. Gjatë kësaj periudhe i tërë fokusi ka qenë në ofrimin

e mësimi në formë fizike edhe në distancë. Megjithatë, me përkushtimin e të gjithë palëve të përfshirë dhe me ndihmën e partnerëve zhvillimorë dhe donatorëve, është arritur të menaxhohet situata e shkaktuar nga pandemia COVID-19 dhe të shënohen të arritura në të gjitha segmentet e arsimit. Ky sektor është duke kaluar nëpër një proces reformues që ka për objektiv rritjen e pjesëmarrjes dhe përmirësimin e cilësisë së arsimit. Është punuar në hartim të legjislacionit dhe janë miratuar akte të shumta ligjore e nënligjore, është mbështetur implementimi i Platformës online për nivel të edukimi, janë siguruar pajisjet e teknologjisë, Laptop, janë ndërtuar, renovuar shumë objekte arsimore. Është punuar në përmirësimin e kurrikulave dhe në hartimin e sigurimin e teksteve të reja shkollore, të cilat duhet të mbështeten nga praktika të reja të mësimdhënies e të mësimnxënies. Gjithashtu synohet mbështetja e kërkimeve shkencore dhe pjesëmarrja në të gjitha aktivitetet e arsimit në nivel kombëtar, rajonal dhe ndërkombëtar, për të arritur standardet evropiane. Qasja në përfitim të dijes, hulumtimeve shkencore, inovacionit dhe të përfitimit të shkathtësive, që janë në funksion zhvillimit të përsheptuar të shoqërisë sonë dhe aftësive konkurruese brenda dhe jashtë Kosovës në përputhje me standardet ndërkombëtare.

Gjithashtu ka pasur të arritura të theksuara edhe në fushën e akademisë, ku është punuar në një numër të konsiderueshëm të projekteve specifike, ndërsa është vazhduar bashkëpunimi me institucionet ndërkombëtarë, akademike dhe shkencore.

Ky sektor karakterizohet me zhvillime të vazhdueshme në të gjithë nën sektorët që kanë trajtuar sfida të shumta në drejtim të përmirësimit të cilësisë së arsimit. Edukimin në fëmijërinë e hershme, rritja e përfshirjes së fëmijëve në edukimin parashkollor të moshës 0-5 vjeç nëpërmjet zgjerimit të rrjetit të institucioneve në edukimin parafillor dhe parashkollor duke ndërtuar çerdhe të reja dhe adaptuar hapësirat ekzistuese për nevojat e këtij niveli arsimor. Rishqyrtimin e standardeve të edukimit në fëmijërinë e hershme dhe përmirësimin e qasjes në shërbimet arsimore, veçanërisht për fëmijët nga familjet me të ardhura të ulëta, pakicat kombëtare dhe nga zonat rurale për të rritur investimet në kërkim dhe zhvillim shkencor; cilësi, integritet dhe konkurrueshmëri më e madhe në arsimin e lartë; dixhitalizim të shërbimeve arsimore për cilësi dhe qasje më të mirë.

Objektivat kryesore të sektorit të arsimit për periudhën e ardhshme janë:

- Rritje e përfshirjes dhe qasje e barabartë në edukimin në fëmijërinë e hershme duke siguruar mjedise të sigurta mbështetëse dhe nxitëse si dhe shërbime të integruara dhe cilësore.
- Ngritja e cilësisë së arsimit parauniversitar përmes konsolidimit të mekanizmave për sigurim të cilësisë dhe ofrimit të mësimdhënies cilësore.
- Harmonizimi i arsimit dhe aftësimin profesional me zhvillimet dinamike të teknologjisë dhe tregut të punës, në funksion të mësimi gjatë gjithë jetës.
- Përmirësimi i cilësisë, integritetit dhe konkurrueshmërisë së arsimit të lartë përmes zbatimit të standardeve të larta të cilësisë, përsoshmërisë në mësimdhënie dhe kërkimit shkencor, inovacionit, ndërlidhjes me tregun e punës.
- Përdorimi i teknologjisë digjitale për përmirësimin e shërbimeve dhe të cilësisë në arsim, në përputhje me trendet e transformimit digjital.

Sektorin e Arsimit e përbejnë Ministria e Arsimit Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, Universiteti i Prishtinës, Akademia e Shkencës dhe e Arteve të Kosovës si dhe Akademia e Drejtesisë

Trendet e financimit 2021 -2022 dhe vlerësimet 2023 -2025					
Arsimi	Viti 2021 Shpenzimi	Viti 2022 Buxhetuar	Viti 2023 Vlerësuar	Viti 2024 Vlerësuar	Viti 2025 Vlerësuar
Total	92,947,711	107,060,504	113,554,351	115,310,869	116,529,531
Numri i punëtorëve	4,343	4,349	4,349	4,349	4,349
Paga dhe mëditje	41,045,996	43,049,572	43,514,819	43,732,394	43,951,056
Mallra dhe shërbime	25,551,151	20,937,400	21,285,000	21,369,943	21,369,943
Shpenzime komunale	1,816,790	2,781,959	2,981,959	2,981,959	2,981,959
Subvencione dhe transfere	6,088,344	7,144,519	8,964,519	8,964,519	8,964,519
Shpenzime kapitale	18,445,430	32,997,054	36,808,054	38,262,054	39,262,054
Rezerva	-	150,000	-	-	-
Burimet e financimit					
Garantet qeveritare	88,316,891	103,846,728	109,871,677	111,278,304	112,622,015
Të hyrat vetanake	4,517,862	3,213,776	3,682,674	4,032,565	3,907,516
Të hyrat nga AKP - 24	-	-	-	-	-
Të hyrat e dedikuara	-	-	-	-	-
Financimet nga huamarrjet	112,958	-	-	-	-
Financimi nga huamarrja - 04	112,958	-	-	-	-
Financimi nga Klauzola e investimeve -06	-	-	-	-	-
Grantet nga Donatorët *	824,474	14,712	8,712	8,712	8,712
* Grantet nga donatorët nuk janë pjesë e totalit të shpenzimeve sipas burimit të financimit					

3.10. MBROJTJA SOCIALE

Në kuadër të këtij sektori synohet zhvillimi, zbatimi, koordinimi i politikave, ligjeve e instrumenteve tjera në reformimin e politikave aktuale për të siguruar mbrojtje sociale dhe pensionale, ngritjen e kualitetit të shërbimeve sociale dhe familjare, avancimin e politikave të punës dhe zbatimi i masave aktive të tregut të punës, sigurisë në punë, dialogut social dhe inspektimin e subjekteve për zbatimin e legjislacionit të punës.

Për më tej, do të vazhdoi zbatimin e masave aktive të tregut të punës si dhe do të investohet në avancimin dhe ngritjen e kualitetit në shërbimet e punësimit dhe aftësimin profesional. Po ashtu përmes Inspektoratit të Punës do të vazhdohet mbikqyrja e zbatueshmërisë së legjislacionit që rregullon raportet juridike kontraktuale, duke përfshirë të drejtat dhe detyrimet, në mes të punëdhënësit dhe të punësuarit.

Do të vazhdoj zbatimi i marrëveshjeve ekzistuese për realizimin e të drejtës në pensione të jashtme dhe sigurime sociale si dhe koordinimi dhe avancimi i politikave tjera në fushën e sigurimeve sociale.

Po ashtu do të investohet në sisteme informative integruese dhe digjitalizimin e pagesave të skemave sociale, pensionale dhe të gjitha përfitimeve tjera, për të eliminuar dobësitë dhe identifikuar të hyrat dhe të ardhurat e pëfitueseve nga fondet publike dhe buxheti i shtetit. Kjo do të arrihet përmes krijimit të platformës së regjistrimit social dhe zbatimit të Testit të Varfërisë.

Objektivat kryesorë për periudhën e ardhshme trevjeçare janë:

- Rritja e mirëqenies sociale përmes ristrukturimit, zgjerimit në ngritjen e cilësisë së mbrojtjes dhe shërbimeve sociale e familjare, me fokus të veçantë në grupet në nevojë dhe barazinë gjinore;
- Ulja e inaktivitetit, rritja e punësimit, zhvillimi i shkathtësive në përputhje me kërkesat e tregut të punës dhe administrimi më i mirë i tregut të punës;
- Përmirësimi i kushteve të punës dhe zvogëlimi i punësimit informal përmes fuqizimit të mekanizmave të mbikëqyrjes dhe forcimit të dialogut social;
- •hvimin e sistemit të qëndrueshëm pensional në ngritjen e kapaciteteve institucionale për realizimin e rishikimit, harmonizimit dhe zbatimin e plotë të kornizës ligjore për drejtën në pensione dhe shërbime më të mira;

Sektorin e Mbrojtjes Sociale e përben pjesa e Punës dhe Transfereve e cila është në kuadër të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve.

Trendet e financimit 2021 -2022 dhe vlerësimet 2023 -2025					
Mbrojtja Sociale	Viti 2021 Shpenzimi	Viti 2022 Buxhetuar	Viti 2023 Vlerësuar	Viti 2024 Vlerësuar	Viti 2025 Vlerësuar
Total	617,445,511	610,547,828	654,118,925	666,763,699	676,819,048
Numri i punëtorëve	610	719	819	819	819
Paga dhe mëditje	4,098,382	4,466,359	5,178,336	5,203,110	5,225,526
Mallra dhe shërbime	1,174,676	2,012,810	2,387,342	2,337,342	4,337,342
Shpenzime komunale	209,749	349,485	349,485	349,485	349,485
Subvencione dhe transfere	611,599,977	600,179,174	644,268,762	658,053,762	666,053,695
Shpenzimet kapitale	362,728	3,540,000	1,935,000	820,000	853,000
Rezerva					
Burimet e financimit					
Grantet qeveritare	616,701,543	602,152,828	639,318,925	654,713,699	664,769,048
Të hyrat vetanake					
Të hyrat e dedikuara					
Të hyrat nga AKP-ja					
Financimet nga huamarrjet	743,969	8,395,000	14,800,000	12,050,000	12,050,000
Financimi nga huamarrja - 04	743,969	8,125,000	14,000,000	11,950,000	11,950,000
Financimi nga klauzola e investimeve - 06		270,000	800,000	100,000	100,000
Grantet nga donatorët*					
* Grantet nga donatorët nuk janë pjesë e totalit të shpenzimeve sipas burimit të financimit					

Në vijim janë paraqitur kufijt buxhetor për vitet 2023-2025 në nivel të organizatave buxhetore në nivel qendror.

Niveli komunal

1. Hyrje

